



KOMISIONI  
EVROPIAN

Bruksel, 8.10.2014  
COM(2014) 700 final

**KOMUNIKATË NGA KOMISIONI EVROPIAN PËR PARLAMENTIN DHE  
KËSHILLIN EVROPIAN, KOMISIONIN EKONOMIK DHE SOCIAL  
EVROPIAN DHE KOMISIONIN E RAJONEVE**

**Strategjia e Zgjerimit dhe Sfidat Kryesore 2014-15**

{ SWD(2014) 301 final }

{ SWD(2014) 302 final }

{ SWD(2014) 303 final }

{ SWD(2014) 304 final }

{ SWD(2014) 305 final }

{ SWD(2014) 306 final }

{ SWD(2014) 307 final }

## KOMPLETIMI I BAZËS PËR KREDIBILITET

### I. AGJENDA E ZGJERIMIT - ARRITJET DHE SFIDAT

Gjatë pesë viteve të fundit, Komisioni ka forcuar **kredibilitetin** e politikës së zgjerimit dhe ka përmirësuar **autoritetin e tij transformues** duke siguruar një fokus më të fuqishëm në adresimin e reformave themelore gjatë procesit të hershëm të zgjerimit. Komisioni i ka vënë theks të veçantë tri shtyllave, asaj **sundimit të ligjit, qeverisjes ekonomike dhe reformës së administratës publike**.

Në Komunikatën<sup>1</sup> e saj për strategji të zgjerimit të vitit 2012, Komisioni ka paraqitur një qasje të re për sundimin e ligjit. Në Komunikatën<sup>2</sup> e vitit 2013,<sup>2</sup> Komisioni ka përcaktuar një kornizë për forcimin e qeverisjes ekonomike, duke u bazuar në përvojën e Semestrit Evropian. Këtë vit, Komisioni ka përcaktuar ide të reja për të mbështetur reformën e administratës publike në vendet në zgjerim. Këto tri shtylla janë të ndërlidhura dhe progresi në këto fusha do të jetë kyç për të përcaktuar kohën kur vendet do të jenë plotësisht të gatshme për t'iu bashkuar BE-së.

Politika e zgjerimit të BE-së kontribuon në përfitime reciproke të paqes, sigurisë dhe prosperitetit në Evropë. Ajo përforcon fuqinë politike dhe ekonomike të BE-së dhe ka një efekt të fuqishëm transformues në vendet e interesuara. Një proces i përgatitur mirë i anëtarësimit siguron se zgjerimi nuk bëhet në kurriz të efikasitetit të Bashkimit Evropian.

Dhjetëvjetori i anëtarësimit të dhjetë shteteve anëtare në maj të vitit 2004, është një kujtesë e progresit të arritur. Me zgjerimin e BE-së rriten edhe mundësitë për kompanitë tona, investuesit financiar, konsumatorët, turistët, studentët dhe pronarët e pronave. Nga ky anëtarësim kanë përfituar vendet që i janë bashkuar BE-së dhe shtetet anëtare. Tregtia dhe investimet janë rritur. Është përmirësuar cilësia e jetës së qytetarëve pasi që standardet e BE-së mbi mjedisin, konsumatorët dhe standardet tjera zbatohen më gjerësisht tani.

Për vendet e Ballkanit Perëndimor, perspektiva e qartë e anëtarësimit në BE, e dhënë nga Shtetet Anëtare të BE-së është një faktor kyç stabilizues. Kjo mbështet progresin drejt përmbushjes së kushteve të nevojshme, duke përfshirë edhe ato të Procesit të Stabilizim-Asociimit. Marrëdhëniet e mira fqinjësore dhe bashkëpunimi rajonal gjithëpërfshirës janë thelbësore. Ka pasur progres në këtë drejtim gjatë vitit të kaluar, ndërkohë që disa çështje ende mbesin të hapura. Përpjekjet e vazhdueshme për t'i trajtuar çështjet bilaterale në mes vendeve në zgjerim dhe shteteve anëtare, përfshirë edhe ato nën patronazhin e OKB-së ku ishte relevante, dhe tejkalimi i trashëgimisë nga e kaluara janë vendimtare në pikëpamje të historisë së këtij rajoni të copëtuar kohëve të fundit nga konflikti.

Procesi i antarësimit është rigoroz, i ndërtuar mbi kushte të rrepta por të drejta, në kritere të vendosura dhe parime meritore. Kjo është thelbësore për kredibilitetin e politikës së zgjerimit, për sigurimin e nxitjeve për vendet në zgjerim që t'i ndjekin reformat e thella dhe të sigurojnë mbështetjen e qytetarëve të BE-së. Nga ana e tyre, Shtetet Anëtare, së bashku me institucionet e BE-së, duhet të udhëheqin një debat të informuar mbi ndikimin politik, ekonomik dhe social të politikave të zgjerimit.

\*\*\*

Agjenda aktuale e zgjerimit mbulon vendet e Ballkanit Perëndimor, Turqinë dhe Islandën. Ky ka qenë një vit i rëndësishëm për një numër të vendeve të Ballkanit Perëndimor:

---

<sup>1</sup> COM(2012) 600 final.

<sup>2</sup> COM(2013) 700 final.

**Mali i Zi** ka ndërmarrë hapa të mëtejshëm në negociatat e antarësimit. Janë hapur dymbëdhjetë kapituj. Ka filluar zbatimi i reformave për sundimin e ligjit. Tani nevojiten rezultate konkrete dhe do të jenë kyçe në përcaktimin e ritmit të përgjithshëm të negociatave për antarësim.

Hapja e negociatave për antarësim është një pikë ktheese në marrëdhëniet BE - **Serbi**. Tani Serbia duhet t'i arrij reformat e saj me prioritetet në një mënyrë të qëndrueshme, pasi që ritmi i negociatave do të varet nga progresi në fushat kyçe, veçanërisht në sundimin e ligjit dhe procesin e normalizimit me Kosovën\*. Duhet të krijohet një vrull i ri në dialogun mes Beogradit dhe Prishtinës në mënyrë që të trajtohen çështjet kyçe të pazgjidhura dhe të hapet një fazë të re në normalizimin e marrëdhënieve.

**Shqipërisë** iu dha statusi i kandidatit në muajin qershor, si njohje e përpjekjeve të saj të reformës dhe përparimit të bërë në përmbushjen e kushtëzimit të nevojshëm. Vendi ka nevojë për ngritjen dhe konsolidimin e vrullit të reformave dhe fokusimin e përpjekjeve të tij në trajtimin e sfidave për integrim në BE në një mënyrë të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse. Qeveria dhe opozita duhet të sigurohen që zhvillimi i debatit politik të bëhet kryesisht në parlament.

Nënshkrimi i marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit me **Kosovën** në muajin korrik është një arritje e madhe në marrëdhëniet BE-Kosovë. Tani Kosova ka nevojë t'i arrij reformat kyçe, në veçanti në sundimin e ligjit.

Procesi i antarësimit të **ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë** në BE është një rrugë pa krye. Duhet ndërmarrë veprime për të kthyer regresin, sidomos sa i përket lirisë së shprehjes dhe të medias, si dhe pavarësisë së gjyqësorit. Urgjentisht nevojitet të gjendet një zgjidhje e negociuar dhe reciprokisht e pranueshme sa i përket çështjes së emrit. Qeveria dhe opozita duhet të ndërmarrin masa për të ri-hapur dialogun politik në parlament.

**Bosnja dhe Hercegovina** mbetet në status quo në rrugën e saj drejt integritimit evropian. Pas zgjedhjeve, do të jetë thelbësore për vendin që të flasë me një zë, për të trajtuar reforma urgjente socio-ekonomike dhe të përparojë në agjendën e saj evropiane.

Ka vazhduar zbatimi i angazhimeve të caktuara për reformim nga ana e **Turqisë**, siç është pakoja e demokratizimit 2013, dhe janë ndërmarrë hapa drejt zgjidhjes së çështjes së kurdëve. Megjithatë, ka pasur edhe arsye për shqetësime serioze në lidhje me pavarësinë e gjyqësorit dhe mbrojtjen e lirive themelore. Negociatat aktive dhe të besueshme për antarësim ofrojnë kornizën më të përshtatshme për shfrytëzimin e potencialit të plotë të marrëdhënieve BE-Turqi. Hapja e negociatave për kapitujt përkatës në sundimin e ligjit dhe të drejtat themelore do të sigurojnë një udhërrëfyes për reforma në këto fusha kyçe.

Sipas vendimit të qeverisë së **Islandës**, janë pezulluar negociatat për antarësim që nga muaji maj i vitit 2013.

\*\*\*

Qasja e Komisionit për adresimin së pari të prioriteteve të reformave lidhur me sundimin e ligjit dhe të drejtat themelore, qeverisjen ekonomike dhe përmirësimin e konkurrencës ekonomike, dhe forcimin e institucioneve demokratike. Kjo përfshin administratën publike, e cila mbetet e dobët në shumicën e vendeve në zgjerim, me kapacitet të kufizuar administrativ, nivele të larta të politizimit dhe mungesës së transparencës. Fuqizimi i funksionimit të institucioneve demokratike po ashtu kërkon procese të shëndosha zgjedhore dhe funksionim të duhur të parlamentit, duke përfshirë dialogun konstruktiv dhe të qëndrueshëm në të gjithë spektrin politik. Duhet bërë më shumë për të promovuar një mjedis të përshtatshëm për organizatat e shoqërisë civile.

\* Ky përcaktim është pa paragjykim ndaj qëndrimeve për statusin, dhe është në pajtim me Rezolutën 1244 e KS të KB-së, si dhe me opinionin e GJND-së për statusin e Kosovës.

Një shoqëri e fuqishme civile rrit përgjegjshmërinë politike dhe promovon kuptim më të thellë të reformave të lidhura me anëtarësim.

Seksioni II i kësaj Komunikate fokusohet në sfidat kyçe dhe shqyrton progresin në fushat e reformës së administratës publike, qeverisjen ekonomike dhe konkurrencën, si dhe në sundim të ligjit dhe të drejtat themelore. Seksioni III merret me shumicën e çështjeve rajonale dhe bilaterale, veçanërisht në Ballkanin Perëndimor. Seksioni IV përcakton konkluzionet dhe rekomandimet mbi çështjet horizontale dhe specifike të vendit.

Në të gjitha fushat e mësipërme, Komisioni ka për qëllim të bëjë përdorimin maksimal të mekanizmave dhe forumeve ekzistuese për të shtyrë përpara reformat, qoftë përmes strukturave të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit (MSA), negociatave të anëtarësimit apo iniciativave të udhëhequra nga komisioni për vendet specifike, siç janë dialogjet e nivelit të larta ose dialogjet e strukturuar mbi sundimin e ligjit. Iniciativat e tilla u zgjeruan më tej në nëntor të vitit 2013 me krijimin e një dialogu të nivelit të lartë me Shqipërinë mbi prioritetet kyçe. Sa i përket reformës së administratës publike, Komisioni është duke prezantuar një dialog më të strukturuar dhe është duke ngritur "grupe të veçanta" së bashku me vendet në zgjerim.

Viti 2014 ka shënuar fillimin e instrumentit të ri për Asistencë të Para-Anëtarësimit (IPA II). Përmes IPA II, BE-ja do të ofrojë 11.7 miliardë euro për periudhën 2014-2020 për të mbështetur vendet në zgjerim në përgatitjen e tyre për anëtarësim, si dhe për bashkëpunim rajonal dhe ndërkufitar. IPA II më shumë përqendrohet në prioritetet për anëtarësim në BE në fushat e demokracisë dhe sundimit të ligjit, si dhe në konkurrencë dhe zhvillim, IPA II gjithashtu paraqet një qasje sektoriale, nxitje për arritjen e rezultateve, rritje të mbështetjes buxhetore dhe priorizim të projekteve. Nevojitet një qasje e koordinuar për investimet e mëdha përgjatë korridoreve kryesore të infrastrukturës. Është duke u forcuar koordinimi me institucionet financiare ndërkombëtare (IFN-të). Korniza e Investimeve të Ballkanit Perëndimor do të vazhdojë t'i mbështes investimet në rritjen e vendeve të punës dhe zhvillimi, si dhe në promovimin e ndërlidhjes në rajon.

### **Tri përfitimet strategjike të zgjerimit**

**(1) e bën Evropën një vend më të sigurt.** Nëpërmjet procesit të anëtarësimit, BE-ja promovon demokracinë dhe liritë themelore dhe konsolidon sundimin e ligjit në të gjithë vendet aspiruese, duke zvogëluar ndikimin e krimit ndërkufitar. Politika aktuale e zgjerimit është duke **fuqizuar paqen dhe stabilitetin** në Ballkanin Perëndimor, si dhe promovon rimëkëmbjen dhe pajtimin pas luftërave të viteve të 90-ta.

**(2) ndihmon në përmirësimin e cilësisë së jetesës** së njerëzve nëpërmjet integritit dhe bashkëpunimit në fusha si energjia, transporti, sundimi i ligjit, emigrimi, siguria ushqimore, mbrojtja e konsumatorit dhe mjedisit dhe ndryshimet klimatike. Zgjerimi na ndihmon të sigurohemi që standardet tona të larta të aplikohen përtej kufijve tanë, që ndikon në zvogëlimin e rrezikut të ndikimit në qytetarët e BE-së, për shembull nga ndotja e importuar.

**(3) na bën më të begatë.** Një Evropë më e madhe, është një Evropë më e fortë. Në vitin 2012, BPV-ja e BE-së ka qenë 23% e BPV-së botërore, në shumë prej 13 trilion eurove. Nga aderimi kanë përfituar vendet që kanë hyrë në BE dhe vendet anëtare. Me zgjerimin e BE-së, rriten edhe mundësitë për kompanitë tona, investitorët, konsumatorët, turistët, studentët dhe pronarët e pronave. Një treg i vetëm më i madh është më tërheqës për investitorët: Investimet e huaja direkte nga pjesa tjetër e botës në BE janë dyfishuar në përqindje të BPV-së që prej anëtarësimit në vitin 2004 (nga 15.2% e BPV-së në vitin 2004 në 30.5% të BPV-së në vitin 2012).

\*\*\*

## **II. SË PARI BAZAT - KONSOLIDIMI I REFORMËS DHE FUQIZIMI I KREDIBILITETIT**

Ky seksion identifikon sfidat kryesore dhe shqyrton progresin në fushën e reformës së administratës publike, qeverisjes ekonomike dhe konkurrencës, si dhe sundimin e ligjit dhe të drejtat themelore. Kjo përcakton ide të reja për fuqizimin e përqendrimit në reformën e administratës publike dhe përsosë më tej qasjen ndaj qeverisjes ekonomike. Në komunikatën e vitit të kaluar, theks i veçantë i është dhënë mënyrës se si fondet e para-anëtarësimit mbështesin procesin e reformave në të gjitha vendet. Këtë vit, i është kushtuar vëmendje disa praktikave të caktuara në fushat e mësipërme të cilat janë në fuqi në vendet në zgjerim dhe të cilat mund të shërbejnë si frymëzim për reforma në vende tjera.

### **a) Reforma e administratës publike**

Së bashku me sundimin e ligjit dhe qeverisjen ekonomike, reforma e administratës publike (RAP) paraqet një shtyllë të procesit të zgjerimit. Të tri "shtyllat" janë të lidhura ngushtë, dhe kanë çështje ndër-sektoriale të një rëndësie themelore për sukses në reformat politike dhe ekonomike dhe ndërtojnë një bazë për zbatimin e rregullave dhe standardeve të BE-së. Një administratë publike funksionale është e nevojshme për qeverisjen demokratike. Ajo gjithashtu në mënyrë të drejtpërdrejtë ndikon në aftësinë e qeverive për të ofruar shërbime publike dhe nxit konkurrencën dhe rritjen ekonomike.

Reforma e administratës publike synon rritjen e transparencës, përgjegjshmërisë dhe efikasitetit dhe fokusohet më shumë në nevojat e qytetarëve dhe biznesit. Menaxhimi adekuat i burimeve njerëzore, planifikimi më i mirë i politikave, koordinimi dhe zhvillimi, procedura të shëndosha administrative dhe përmirësimi i menaxhimit të financave publike, duke përfshirë administrimin dhe grumbullimin e të ardhurave është i një rëndësie themelore për funksionimin e shtetit dhe për zbatimin e reformave të nevojshme për integrim në BE. Vendet duhet të rrisin përpjekjet e tyre për të përmirësuar administratat e tyre publike në të gjitha nivelet në bazë të strategjive kombëtare. Duke njohur sfidat me të cilat përballen vendet në zgjerim, Komisioni është duke forcuar mbështetjen e tij drejt krijimit të strukturave dhe kapaciteteve të nevojshme administrative në procesin e anëtarësimit.

Komisioni do të strukturoj punën e tij mbi RAP-in me vendet në zgjerim rreth çështjeve kyçe si në vijim:

#### **Cështjet kyçe për reformën e administratës publike**

- 1. Korniza strategjike për reformën e administratës publike** — kjo përfshin angazhimin politik në procesin e reformës, duke përfshirë udhëheqësinë politike, koordinimin teknik dhe monitorimin e zbatimit.
- 2. Zhvillimi dhe koordinimi i politikave** — kjo përfshin koordinimin e duhur në qendër të qeverisë, koordinimin ndër-ministral, zhvillimin e politikave dhe analizat financiare.
- 3. Shërbimet publike dhe menaxhimi i burimeve njerëzore** — kjo përfshin organizimin dhe funksionimin e shërbimeve publike, duke përfshirë de-politizimin, rekrutimin dhe promovimin e bazuar në meritë, trajnim dhe profesionalizëm.
- 4. Përgjegjshmëria** — kjo përfshin transparencën e administratës, duke përfshirë qasjen në informata dhe mundësinë e korrigjimit administrativ dhe ligjor.
- 5. Ofrimi i shërbimeve** — kjo përfshin përmirësimin e shërbimeve për qytetarë dhe biznese, duke përfshirë procedura më të mira administrative dhe shërbime të qeverisjes elektronike.

**6. Menaxhimi i financave publike (MFP)** — kjo përfshin një angazhim për një qasje më gjithëpërfshirëse për përmirësimin e menaxhimit të financave publike dhe procesin e përgjithshëm buxhetor përmes përgatitjes dhe zbatimit të programeve shumëvjeçare të MFP dhe duke u angazhuar në një dialog për politika të MFP-së me Komisionin dhe IFN-të. Një program i besueshëm dhe relevant i MFP-së është gjithashtu kyç për mbështetjen e sektorit të buxhetit nga IPA.

Komisioni synon të integrojë më mirë reformën e administratës publike në procesin e zgjerimit. Janë themeluar "grupe të veçanta të RAP-it", ose janë në proces të themelimit me vendet e Ballkanit Perëndimor mbi modelin e nën-komisioneve të MSA-së. Grupe të veçanta janë takuar tashmë për rastin e Shqipërisë, Kosovës, ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë dhe Malit të Zi. Grupi i parë i veçantë i RAP-it me Serbinë do të takohet në muajin tetor. Grupet e veçanta do të bëhen platforma kyçe për të qarur përpara punën mbi RAP-in, e cila do të bazohet në çështjet e mësipërme kyçe. Rezultatet e grupeve të veçanta të RAP-it duhet të bazohen në Këshillin/Komisionin e MSA-së, me një diskutim më të strukturuar, më politik mbi çështjet kyçe të RAP-it.

Edhe pse nuk ka një kapitull të veçantë të *acquis*-it që mbulon administratën publike, negociatat për anëtarësim duhet gjithashtu të përdoren për të inkurajuar reformat e nevojshme. Çështjet kyçe duhet të adresohen përmes kapitujve përkatës - sidomos për prokurimin publik, kontrollin financiar, gjyqësorin dhe të drejtat themelore, tatimin dhe politikat ekonomike dhe monetare, - dhe në kontekstin e konferencave ndërqeveritare, aty ku kjo është e rëndësishme për zbatimin e *acquis*-it. Koordinimi me IFN-të, veçanërisht në fushën e MFP-së do të jetë vendimtar. Komisioni vazhdon të mbështesë Shkollën Rajonale të Administratës Publike, e cila ka një rol të rëndësishëm për shkëmbimin e përvojave në rajon mbi RAP-in, po ashtu edhe në lidhje me procesin e integritimit në BE.

*Ngritja e kapaciteteve të administratës publike në Kosovë:*

Në mënyrë që të forcojë kapacitetin profesional dhe institucional të administratës së saj publike, Kosova ka themeluar një program të profesionistëve të rinj. Me një fokus të fuqishëm mbi nevojat e integritimit evropian, ky program ofron bursa për studentët më të dalluar për të ndjekur një program të veçantë Master në Kosovë së bashku me mundësinë për të studiuar në BE. Rreth 80% e të diplomuarve janë punësuar nga autoritetet e Kosovës. Nga kjo nuk ka përfituar vetëm Ministria e Integritimit Evropian, por edhe ministritë dhe institucionet sektoriale që do të jenë përgjegjëse për zbatimin e obligimeve në kuadër të MSA-së në të ardhmen.

#### **b) Qeverisja ekonomike dhe konkurrenca**

Komisioni po forcon përkrahjen e saj për përmirësimin e qeverisjes dhe konkurrencës ekonomike në vendet në zgjerim. Ky është çelësi për adresimin e shqetësimeve të qytetarëve në një ambient vazhdimisht të vështirë ekonomik, me papunësi të lartë dhe investime të ulëta. Kjo qasje e re është veçanërisht e rëndësishme në lidhje me vendet e Ballkanit Perëndimor pasi që asnjëra prej tyre ende nuk konsiderohet të jetë një ekonomi funksionale e tregut. Kjo do të ndërtohet mbi përvojën e shteteve anëtare të BE-së në Semestrin Evropian. Do të ketë një theks të shtuar në reformat strukturore të cilat janë sektoriale për nga natyra. Nga vendet në zgjerim do të kërkohet që të dorëzojnë Programet Kombëtare për Reformën Ekonomike. Nga ana e saj BE-ja do të ofrojë më shumë udhëzime për prioritetet e reformave dhe financimet IPA të shënjestruara më mirë. Përmirësimi i qeverisjes ekonomike në vendet në zgjerim është gjithashtu e rëndësishme për ruajtjen e mbështetjes për zgjerim në Bashkimin Evropian.

Të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor përballen me sfida të mëdha strukturore ekonomike, me norma të larta të papunësisë dhe nivel të ulët të investimeve të huaja. Sfida të rëndësishme mbesin në të gjitha vendet në zgjerim në aspektin e reformës ekonomike, konkurrencës, krijimit të vendeve të punës dhe konsolidimit fiskal.

Dobësitë në sundimin e ligjit dhe në menaxhim të financave publike përkeqësojnë rrezikun nga korrupsioni, duke ndikuar negativisht në klimën e investimeve. Deri më sot, asnjë nga vendet nuk ka krijuar një agjendë vendore gjithëpërfshirëse dhe bindëse të reformave.

### **Situata makroekonomike në vendet në zgjerim**

⇒ Në vendet në zgjerim ka një imazh të përzier në drejtim të zhvillimeve socio-ekonomike. Të gjitha vendet në zgjerim kanë ruajtur në masë të madhe stabilitetin e përgjithshëm makroekonomik, por rreziqet fiskale janë rritur ndjeshëm në një numër prej tyre. Rimëkëmbja modeste po vazhdon. Parashikimi më i fundit i Komisionit është që vendet kandidatë në Ballkanin Perëndimor duhet të zhvillohen në një normë mesatare prej 1.6% në vitin 2014. Rimëkëmbja nuk është transformuar në më shumë vende pune. Papunësia ka mbetur e lartë, veçanërisht në mesin e të rinjve, dhe tani është mesatarisht 21% në Ballkanin Perëndimor, por shumë më e lartë në Bosnje dhe Hercegovinë, ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë dhe në Kosovë. Nivelet e varfërisë mbeten shumë të larta.

⇒ BE-ja është partneri kryesor tregtar për vendet e Ballkanit Perëndimor, që paraqet rreth 60% të eksporteve të rajonit. BE-ja gjithashtu është ofruesi më i madh i investimeve të huaja direkte.

⇒ Në vitin 2013, Turqia ka shënuar rritje prej 4% dhe vlerësimi i rritjes për vitin 2014 është 2.6%. Lira turke është dobësuar dhe deficit i llogarisë rrjedhëse është rritur në pothuajse 8% të BPV-së në vitin 2013. Ecuria ekonomike e Turqisë, gjatë kohës së fundit ilustron potencialin e lartë dhe disbalancet e vazhdueshme të ekonomisë së saj. BE-ja mbetet partneri kryesor tregtar i Turqisë ku më shumë se 40% e eksporteve të saj shkojnë në BE. Turqia është bërë një bazë investimi për biznesin evropian ku është shënuar rritje e integritimit në zinxhirin e furnizimit dhe të prodhimit të BE-së. Rreth 70% të investimeve të huaja direkte në Turqi vijnë nga BE-ja.

### ***Treguesit kyç ekonomik***

	BPV për kokë banori në SFB(PPS) (% e BE)	Rritja e BPV-së (%)	Inflacioni (%)	Papunësia (%)	Shkalla e punësimit, mosha 20-64 (%)	Shkalla e pjesëmarrjes, mosha 20-64 (%)	Eksporti (mallra dhe shërbime në % të BPV-së)	Borxhi i Qev. (në % të BPV-së)	Deficiti i Qev. (në % të BPV-së)
Shqipëria	30	1.4	1.9	15.6	57.2	68.0	40.2	62.0*	-3.4*
Bosnja dhe Hercegovina	29	2.5	-0.2	27.5	n/a	n/a	30.0	n/a	-2.2
ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë	35	2.9	2.8	29.0	50.3	70.4	53.9	36.0	-4.1
Kosova	n/a	3.4	1.8	30.0	n/a	n/a	17.4	n/a	n/a
Mali i Zi	42	-2.5*	1.8	19.5	52.6	65.1	44.1*	58.0	-2.3
Serbia	36	2.5	7.8	22.1	51.2	66.0	44.7	63.2	-5.0
Turqia	55	4.0	7.5	8.8	53.4	58.4	25.7	36.2*	-0.3*

Burimi: Eurostat. Referenca për vitin 2013, përveç (\*) vitit 2012.

➤ Përmirësimi i qeverisjes ekonomike

Strategjia e zgjerimit 2013-14 propozon një qasje të re për t'i ndihmuar vendet në zgjerim që të adresojnë bazat ekonomike dhe të përmbushin kriteret ekonomike. Qasja e re nënkupton një ndryshim në dialog dhe përmirësim të raportimit në mënyrë që të japë udhëzime më të qarta mbi reformat e nevojshme për të mbështetur rritjen dhe konkurrencën afatgjate.

**Sfidat kyçe ekonomike në Ballkanin Perëndimor**

⇒ Forcimi i konsolidimit fiskal duke ulur deficitet e buxhetit dhe duke i zbatuar reformat e besueshme në sektorin publik, duke përfshirë reformën e administratës publike dhe sistemeve të pensionit.

⇒ Forcimi i menaxhimit të financave publike, duke përfshirë administrimin dhe mbledhjen e të ardhurave, hartimin dhe ekzekutimin e buxhetit, kontabilitetin dhe raportimin, dhe mbikëqyrjen e jashtme.

⇒ Adresimi i barrës së lartë të kredive jo-performuese.

⇒ Ristrukturimi dhe përmirësimi i qeverisjes së ndërmarrjeve shtetërore,

⇒ Përmirësimi i mjedisit të biznesit, duke përfshirë ekonominë digjitale, dhe mbështetjen e zhvillimit të sektorit privat, reduktimin e ngarkesave para-fiskale, thjeshtimin e rregulloreve dhe rritjen e investimeve në hulumtime.

⇒ Përmirësimi i rrjeteve të energjisë dhe të transportit si dhe rritja e lidhjeve.

⇒ Krijimi i tregjeve funksionale të punës, duke përfshirë fleksibilitet të mjaftueshëm, adresimin e sektorit joformal, përmirësimin e punësimit të punëtorëve, dhe harmonizimi më i mirë i aftësive dhe arsimit me nevoja të tregut të punës.

Vendet e Ballkanit Perëndimor janë ftuar që t'i përmirësojnë politikat ekonomike dhe qeverisjen e saj nëpërmjet përgatitjes së programeve vjetore kombëtare për reformën ekonomike. Këto programe do të përbëhen nga dy pjesë. Pjesa e parë do të përbëhet nga një version i përmirësuar i Programeve ekzistuese Ekonomike të Para-Anëtarësimit (PEP) për vendet kandidatë dhe Programet Ekonomike dhe Fiskale (PEF) për kandidatët e mundshëm dhe është zgjeruar për të përfshirë edhe Kosovën. Pjesa e parë e Programeve Kombëtare të Reformës Ekonomike do të caktoj një kornizë të politikave afat-mesme makroekonomike dhe fiskale, me një fokus të shtuar në vlerësimin e qëndrueshmërisë së jashtme dhe pengesave strukturore të rritjes, si dhe masave konkrete të reformave për mbështetjen e kornizës së politikave. Pjesa e dytë e Programeve Kombëtare të Reformës Ekonomike do t'i mbuloj reformat strukturore të cilat janë sektoriale për nga natyra (siç janë transporti, energjia, arsimiti, mjedisi, hulumtimi, industria, konkurrenca, tregu i brendshëm) dhe më së shumti ka të bëjë me përmirësimin e konkurrencës dhe zhvillimin e vendeve individuale, duke përfshirë nevojat për investime në infrastrukturë. Komisioni do t'i ofroj vendeve udhëzime të qarta dhe të konsoliduara për të siguruar që këto programe janë shënjestruar tek çështjet kyçe.

Për sa i përket rritjes së përqendrimit në reformat strukturore, viti 2015 duhet të konsiderohet si faza e parë e vitit pilotues. Reformat e trajtuara në këto dokumente do të mbështeten nga asistenca e IPA-s. Për të forcuar mbikëqyrjen, procesi i vlerësimit do të rezultojë në udhëzime të politikave më të specifikuar për secilin vend. Tashmë në maj të vitit 2014, Këshilli i Përbashkët ECOFIN ka nxjerrë udhëzime më specifike për secilin prej Vendeve Kandidate.

Turqia dhe BE-ja ndajnë një interes të përbashkët në promovimin e një agjende për reforma ekonomike, si dhe për shkëmbimin e përvojave, përafrimin e pozicioneve në G20 dhe thellimin e integritimit ekonomik. Për më tepër, vlerësimi i fundit i Bashkimit Doganor BE-



Turqi ofron elemente të rëndësishme për përmirësimin e kësaj marrëveshje tregtare. Është në interesin e të dyja palëve përmirësimi i marrëdhënieve të tyre tregtare në një nivel proporcional me marrëveshjet moderne të tregtisë dhe rëndësisë strategjike të marrëdhënieve BE-Turqi. Agjenda ekonomike do të mund të adresohet në një dialog të rregullt të nivelit të lartë ekonomik BE-Turqi. Këto kontakte të intensifikuara politike mund të plotësohen nga një forum vjetor i biznesit BE-Turqi.

### **Cikli vjetor i rishikimit dhe udhëzimit të politikave ekonomike për Ballkanin Perëndimor**

**31 janar** — Dorëzimi i **Programeve Kombëtare për Reforma Ekonomike** (pjesa 1 mbi kornizën makroekonomike dhe fiskale dhe reformat mbështetëse, pjesa 2 mbi reformat strukturore të cilat janë sektoriale për nga natyra dhe konkurrenca) nga ana e shteteve tek Komisioni. Duke pasur parasysh natyrën me afat më të gjatë të reformave sipas pjesës 2, kjo do të jetë subjekti i përditësimit të thjeshtë vjetor mbi çdo RKRE pasuese.

**Shkurt** — Misionet vlerësuese të Komisionit në vendet e Ballkanit Perëndimor.

**Prill** — Takimet e vendit me Komisionin për të diskutuar Udhëzimin e Shënjestruar të Politikave

**Maj** — Konkluzionet e Këshillit ECOFIN

**Qershor/korrik** — Takime të vendeve të veçanta në nivel ministror.

**Vjeshtë** — Pakoja e zgjerimit të komisionit vlerëson progresin e mëtejshëm pasi që Këshilli ECOFIN ofron në detaje udhëzime për të ardhmen që duhet të pasqyrohen në programet që do të dorëzohen në janarin e ardhshëm.

Nevojitet asistencë e përkushtuar teknike për të ndihmuar mbështetjen e zbatimit të kësaj qasjeje. Zbatimi i udhëzimeve të politikave të vendit specifik do të duhet të mbështetet me shpejtësi nga projektet e synuara dhe konkrete të IPA-s për të përmirësuar qeverisjen ekonomike. Dokumentet strategjike shtetërore dhe shumë-shtetërore të IPA 2014-2020 reflektojnë rëndësinë e qeverisjes ekonomike dhe ndajnë fonde indikative për këtë qëllim. Janë duke u përgatitur projekte konkrete të IPA-s dhe do të prezantohen prej vitit 2015.

Rritja e konkurrencës dhe futja e masave për nxitjen e krijimit të vendeve të punës në rajon do të zbusë presionet emigruese nga vendet në zgjerim drejt BE-së. Në zgjerimet më të fundit, ish-in vendosur marrëveshjet kalimtare për fillimin e lëvizjes së plotë të lirë të punëtorëve nga Shtetet e reja Anëtare. Nevoja e mundshme dhe natyra e masave tranzicionale dhe/ose mekanizmave mbrojtës për lëvizjen e lirë të punëtorëve do të adresohet në rrjedhën e negociatave të pranimit për zgjerimet e ardhshme, duke marrë parasysh vlerësimet e ndikimit në të ardhmen.

➤ Dialogu mbi reformat e punësimit dhe ato sociale

Mbështetja e Komisionit për zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik në Ballkanin Perëndimor shkon përtej stabilizimit makroekonomik dhe arritjes së statusit të ekonomisë funksionale të tregut. Që nga fillimi i krizës, Komisioni ka insistuar se duhet të bëhet më shumë për të adresuar gjendjen e vështirë socio-ekonomike, në veçanti papunësinë e lartë.

Komisioni ka nisur tashmë një dialog të ri për programet e reformës së punësimit dhe ato sociale (PRPS-të) me Turqinë dhe Serbinë. Janë në përgatitje e sipër dialogjet me ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë dhe Malin e Zi. Situata socio-ekonomike në vendet tjera është më sfiduese dhe nevojitet mbështetje shtesë për ngritjen e kapaciteteve administrative për të lehtësuar pjesëmarrjen në procesin e ri. Këto vende do të ftohen gradualisht në dialogun e ri. Është duke u ofruar asistencë gjithëpërfshirëse teknike përmes IPA-s, përveç mbështetjes më të gjerë në fushën e punësimit dhe atë sociale. Komisioni do të inicioj një platformë për punësim dhe çështje sociale si një mjet shtesë për t'i ndihmuar

vendeve të ndajnë përvojën dhe të përgatiten për dialog të PRPS-së.

Në një ushtrim të veçantë, me synim të zvogëlimit të mungesave të aftësive dhe përmirësimit të sistemeve arsimore, Komisioni po ashtu do të vazhdojë zhvillimin e platformës për arsim dhe trajnim të Ballkanit Perëndimor.

➤ Rritja e investimeve për zhvillim dhe vende pune; rrjetet dhe bashkëpunimi rajonal

Rrjetet e transportit ndërkufitar, të energjisë dhe komunikacionit janë të pazhvilluara në Ballkanin Perëndimor. Investimet në infrastrukturë janë shumë të nevojshme për të nxitur zhvillimin ekonomik në rajon. Në funksion të madhësisë së ekonomive të Ballkanit Perëndimor, integrimi është çelësi i zgjidhjes. Bashkëpunimi rajonal ekonomik nuk është vetëm një mundësi për rritje të qëndrueshme, por edhe për bashkëpunim politik dhe marrëdhënie të mira fqinjësore. Puna është duke u zhvilluar nën mbikëqyrjen e Këshillit Rajonal për Bashkëpunim (RCC), për t'i adresuar objektivat dhe prioritetet e SEE2020. Liberalizimi i planifikuar i shërbimeve në Zonën e Tregtisë së Lirë të Evropës Qendrore (CEFTA-s), do të mbështes më tej këtë qëllim.

### **Rrjetet e energjisë dhe transportit**

Përmirësimi i ndërlidhjes të energjisë dhe transportit ndërmjet vendeve në zgjerim dhe vendeve të BE-së është një prioritet për nxitjen e rritjes së qëndrueshme ekonomike, të punës, tregtisë dhe shkëmbimit kulturor.

Në muajin maj, Komisioni ka miratuar Strategjinë Evropiane për Siguri të Energjisë<sup>3</sup> që synon forcimin e sigurisë energjetike të BE-së. Në afat të shkurtër, strategjia propozon që Komisioni t'i lansoj **stres-testet e sigurisë energjetike** për të simuluar ndërprerjen në furnizim me gaz për dimrin e ardhshëm dhe të shoh se si sistemi i energjisë mund të përballë me rreziqet e sigurisë së furnizimit. Duke pasur parasysh dimensionin pan-evropian të sigurisë energjetike, Komisioni ka ftuar të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor dhe Turqinë për të kontribuar në ushtrimin e stres-testit. Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë, Kosova, Serbia dhe Turqia kanë kontribuar në këtë ushtrim. Zhvillimi i mëtejshëm i infrastrukturës së **energjisë** trans-evropiane dhe bashkëpunimi me Komunitetin e Energjisë është thelbësor. Komuniteti i Energjisë, i cili synon të zgjerojë *acquis*-in e energjisë së BE-së për zgjerim dhe vendet fqinje, duhet të forcohen më tej në vazhden e shqetësimeve të sigurisë së furnizimit të BE-së. Kjo duhet të arrihet duke promovuar më tej reformat në sektorin e energjisë në vendet pjesëmarrëse, si dhe duke mbështetur modernizimin dhe qëndrueshmërinë e sistemit të tyre të energjisë dhe integrimin e tyre të plotë në kornizën rregullative të energjisë së BE-së.

Një fokus i veçantë i punës në të ardhmen e Komunitetit të Energjisë duhet të jetë zbatimi dhe ekzekutimi i përmirësuar i reformave për të krijuar një treg të mirëfilltë të brendshëm në nivel me shumicë dhe pakicë, veçanërisht për sa i përket veçimit të shërbimeve komunale, transparencën e çmimeve ose garantimin e qasjes së palës së tretë në rrjete. Nevoja për të garantuar qasje të palës së tretë është një nga arsytet pse Komisioni ka deklaruar se marrëveshjet ndër-qeveritare të nënshkruara në mes të Rosisë dhe një numri të vendeve të përfshira në projektin e "South Stream", duhet të ri-negociohen dhe të suspendohet ndërtimi i projektit.

Bashkëpunimi me Turqinë në aspektin e vendndodhjes dhe potencialit të tij strategjik si një qendër e energjisë duhet të zhvillohet më tej. Forcimi i bashkëpunimit energjetik BE-Turqi, si dhe progresi përkatës në negociatat e pranimit do të lehtësojë përparimin e mëtejshëm drejt ndërlidhjes dhe integrimin e tregjeve të energjisë.

Komisioni ka miratuar një listë të Projekteve me Interes të Përbashkët (PIP-të) për zhvillimin e infrastrukturës energjetike trans-evropiane. Një listë e Projekteve me Interes të Komunitetit

<sup>3</sup> COM(2014) 330 final.

të Energjisë (PIKE) është miratuar nga Këshilli Ministror i Komunitetit të Energjisë. Për t'i zbatuar këto rrjete, palët (me ndihmën e BE-së), do të duhet të tejkalojnë vështirësitë në financimin e ndërlidhjeve ndërmjet vendeve.

Traktati i ardhshëm i Komunitetit të **Transportit** do të nxis integrimin e tregjeve të transportit dhe infrastrukturës tokësore ndërsa i kanë ndihmuar vendet e Ballkanit Perëndimor që të zbatojnë standardet e transportit tokësor të BE-së. Komisioni ka shqyrtuar edhe rrjetet trans-evropiane të BE-së në fushën e transportit (TEN-T) dhe energjisë (TEN-E), me qëllim të përmirësimit të lidhjeve me vendet e mbuluara nga politika e zgjerimit dhe fqinjësisë.

Korniza e Investimeve të Ballkanit Perëndimor (WBIF), luan një rol gjithnjë e më të rëndësishëm që ndihmon përgatitjen dhe mbështetjen e atyre investimeve që janë më të nevojshme për nxitjen e zhvillimit dhe vendet e punës. Sipas WBIF-it, Komisioni, donatorët bilateralë dhe institucionet ndërkombëtare financiare janë duke përkrahur me 4 miliard euro vlerë të investimeve në vit transportin, energjinë, mjedisin, ndryshimet klimatike, duke mbështetur një ekonomi efikase të burimeve, sektori social dhe sektori privat/zhvillimi i NVM-ve, ku Komisioni është duke bashkë-financuar një platformë të NVM-ve me Ballkanin Perëndimor që synon përmirësimin e qasjes për të financuar NVM-të nëpërmjet garancive dhe kapitaleve të ndërmarrjeve. Komisioni është duke i inkurajuar vendet që të ngritin komisionet kombëtare për investime ose mekanizma të ngjashëm për koordinim që do të shpijnë në projektin e vetëm të sektorit të gazsjellësit.

*Ndërtimi i projektit të vetëm të gazsjellësit në Serbi:*

Serbia është duke krijuar një listë të projekteve prioritare të infrastrukturës së rëndësishme strategjike kombëtare dhe të BE-së në sektorët e energjisë, transportit, mjedisit dhe infrastrukturës së biznesit. Këto prioritete do të përbëheshin nga projektet e mbështetura politikisht që do të zbatoheshin deri dhe pas anëtarësimit. Lista është duke u zhvilluar me një metodologji koherente dhe objektive të përzgjedhjes, nëpërmjet një projekti të financuar nga IPA. Projektet janë duke u vlerësuar me kujdes në aspektin e hapave të mbetur përgatitorë/administrativ dhe përgjegjësi të detajuara institucionale të atribuara për të gjithë hapat në fjalë. Pasi të miratohet politikisht nga qeveria, të gjitha elementet e mësipërme, që mungonin në të kaluarën, mund të shpijnë në priorizim më të mirë të financimit të projektit, si dhe koordinim më të mirë midis IFN-ve dhe organizatave ndërkombëtare të interesuara në ofrimin e fondeve. Synimi është që vetëm projektet e gazsjellësit të financohen nga IPA dhe IFN-të.

➤ ***Sigurimi i qëndrueshmërisë së investimeve dhe menaxhimi efikas i rrezikut të fatkeqësive***

Vendet e Ballkanit Perëndimor janë të ekspozuara ndaj një game të gjerë të fatkeqësive. Vërshimet e mëdha të cilat goditën Bosnje Hercegovinën dhe Serbinë në muajin maj kanë shkaktuar përveç dhjetëra viktimave, edhe një ndikim të konsiderueshëm socio-ekonomik. Dëmi i përgjithshëm është vlerësuar të jetë rreth 2.04 miliard euro në Bosnjë dhe Hercegovinë (ekuivalenti i rreth 15% të BPV-së) dhe 1.52 miliard euro në Serbi. Përmbytjet po ashtu kanë pasur një ndikim të rëndësishëm në perspektivat e rritjes së dyja vendeve, duke ndikuar negativisht në zhvillimin e qëndrueshëm afatgjatë. Përmbytjet potencuan rëndësinë e investimeve të qëndrueshme në menaxhimin e rrezikut të fatkeqësive dhe të politikës së integruar në mënyrë efektive të DRM-së në politikat e përgjithshme ekonomike të këtyre vendeve.

## c) Sundimi i ligjit dhe të drejtat themelore

### i) *Sundimi i ligjit*

Sundimi i ligjit është një vlerë themelore mbi të cilat BE-ja është themeluar dhe është në zemër të procesit të anëtarësimit. Vendet që aspirojnë të hyjnë në Bashkim Evropian kanë nevojë të krijojnë dhe nxisin nga një fazë e hershme një funksionim të duhur të institucioneve kryesore që janë të nevojshme për sigurimin e sundimit të ligjit. Sundimi i ligjit është thelbësor për një mjedis të qëndrueshëm të biznesit, duke ofruar siguri ligjore për operatorët ekonomik, mbështetje për konsumatorët dhe nxitje të investimeve, vendeve të punës dhe zhvillimit. Ka pasur disa zhvillime pozitive gjatë vitit të kaluar në këtë fushë në vendet në zgjerim. Hapja e kapitujve 23 dhe 24 jep një kornizë të rëndësishme për Malin e Zi për të zbatuar planet e saj gjithëpërfshirëse të veprimit që mbulojnë një gamë të gjerë të sundimit të ligjit. Serbia është shumë e avancuar në zhvillimin e planeve të ngjashme të veprimit që janë në funksion deri në fillimin e negociatave të saj të anëtarësimit për këto kapituj. Në Shqipëri janë bërë përpjekje të rëndësishme për të adresuar krimin e organizuar.

Forcimi i sundimit të ligjit është një sfidë kyçe për shumicën e vendeve në procesin e zgjerimit, në veçanti në aspektin e përmirësimit të funksionimit dhe pavarësisë së gjyqësorit dhe luftës kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar. Kjo do të kërkojë vullnet të fortë politik, duke lëvizur përtej deklaratave për rezultate konkrete. Vendet kanë nevojë për të krijuar regjistar të besueshëm të hetimeve, ndjekjeve përfundimtare penale dhe dënimeve në rastet e krimit të organizuar dhe korrupsionit, me dënim adekuat dhe konfiskim të aseteve.

Në shumicën e rasteve, duhet të ndërmerren **reformat largpamëse gjyqësore** me qëllim të sigurimit të sistemeve gjyqësore të pavarura dhe efikase të afta për të siguruar gjykime të ndershme, ku gjyqtarët janë të emëruar dhe të promovuar në bazë të meritave dhe ku ata janë të paanshëm dhe përgjegjshëm. Strategjitë e reformës gjyqësore janë të vendosura në shumicën e vendeve. Megjithatë, zbatimi është në një fazë të hershme dhe mbeten sfida të shumta. Pavarësia e këshillave gjyqësore të shtetit duhet të sigurohet, të vendosen procedura më të qarta për emërimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve dhe pavarësia e gjyqësorit duhet të mbrohet për derisa siguron llogaridhënie. Cilësia dhe efikasiteti i drejtësisë mungon shpesh, me grumbullim të tepruar të rasteve në shumicën e vendeve dhe vështirësitë në zbatimin e vendimeve gjyqësore. Është i nevojshëm një ndryshim në kulturën gjyqësore drejt një rritje të fokusuar në ofrimin e shërbimit për qytetarë.

#### *Trajnimi i zyrtarëve gjyqësorë në ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë:*

Akademia e gjykatësve dhe prokurorëve është themeluar në vitin 2006 dhe është bërë funksionale në vitin 2007. Kjo ofron trajnim para-shërbimit për gjyqtarët dhe prokurorët e ardhshëm nëpërmjet programit 2-vjeçar teorik dhe praktik të trajnimit me orar të plotë, si dhe trajnim të vazhdueshëm në punë për gjyqtarët, prokurorët, personelin e gjykatës dhe nëpunësit civilë përgjatë gjithë karrierës së tyre. Trajnimi është siguruar kryesisht nga ushtrues të këtij profesioni, siç janë gjyqtarët me përvojë. 80 kandidatë për gjyqtarë dhe prokurorë kanë diplomuar tashmë nga programi i trajnimit të para-shërbimit dhe vitin e kaluar Akademia arriti të ketë mbi 7300 pjesëmarrës me mbi 270 ngjarje të trajnimit në punë. Një sistem i decentralizuar po ashtu kujdeset për pjesëmarrësit jashtë kryeqytetit, ashtu siç bëjnë modulet e të mësuarit elektronik që janë në dispozicion përmes ueb-portalit të Akademisë. Kontaktet me organizatat ndërkombëtare gjyqësore gjithashtu janë duke u promovuar, duke përfshirë edhe praktikatat jashtë vendit.

**Korrupsioni** mbetet një problem serioz në shumicën e vendeve në zgjerim. Në fushat e tilla si prokurimi publik dhe privatizimi, praktikatat korruptive vazhdojnë të devijojnë burimet e pakta nga buxhetet kombëtare, duke ndikuar negativisht në klimën e biznesit dhe investimeve, i cili ka nevojë për siguri ligjore për të përparuar. Korrupsioni gjithashtu ndikon drejtpërdrejt tek

qytetarët kur i qasen disa shërbimeve publike, siç janë shërbimet arsimore dhe shëndetësore. Mjetet për të parandaluar në mënyrë efikase korrupsionin mbeten të përdorura në nivel të ulët. Ekziston një nevojë për një zbatim më pro-aktiv, mirë të koordinuar dhe efektiv të ligjit për tu siguruar që rastet e korrupsionit, duke përfshirë edhe ato në nivel të lartë, të hetohen, ndiqen penalisht dhe të dënohen. Do të nevojiten regjistra të qëndrueshëm të rezultateve të konsiderueshme në këtë fushë.

Vendet duhet të sigurojnë një kornizë të fortë për parandalimin e korrupsionit, dhe nevojiten përpjekje shtesë në lidhje me financimin e partive politike dhe fushatave zgjedhore, menaxhimin e konfliktit të interesit, transparencën në përdorimin e fondeve publike, qasjen në informacion si dhe sekuestrimin dhe konfiskimin e aseteve. Reforma e administratës publike dhe menaxhimi i financave publike do të jenë vendimtare në këtë drejtim. Nevojiten përmirësime në mbledhjen dhe qasjen në të dhënat për të përmirësuar transparencën dhe për të ndihmuar monitorimin e zbatimit të politikave të anti-korrupsionit.

Lufta kundër **krimit të organizuar** mbetet një çështje e rëndësishme në shumicën e vendeve në zgjerim. Është duke u bërë progres, por duhet bërë më shumë për t'i siguruar organeve të zbatimit të ligjit dhe shërbimeve të prokurorisë mjete efektive ligjore dhe hetuese për luftimin dhe dënimin në mënyrë të duhur krimin të organizuar dhe sigurimin e hetimeve pro-aktive.

Luftimi i krimit të organizuar dhe korrupsionit është thelbësor për luftën kundër infiltrimit kriminal në sisteme politike, ligjore dhe ekonomike. Organet e zbatimit të ligjit, shërbimet e prokurorisë dhe gjyqësorit duhet të bëhen më elastike ndaj korrupsionit dhe të vendosen më shumë kontrolle për të zbuluar bizneset kinse ligjore dhe që krijojnë një front për aktivitete kriminale. Duhet të përmirësohet ndjeshëm kapaciteti për të kryer hetime komplekse financiare dhe të trajtohet shpëlarja e parave si dhe duhet të adresohen kërcënimet e reja, të tilla si krimi kibernetikë. Përfitimet nga krimi duhet të konfiskohen në mënyrë efikase, një sistem i zgjeruar i aseteve të konfiskuara duhet të themelohet dhe pasurimi i paligjshëm duhet të trajtohet për ta adresuar fenomenin e pasurisë së pashpjeguar.

Natyra ndër-kufitare e shumë aktiviteteve kriminale dhe grupeve të krimit të organizuar kërkon rritje të bashkëpunimit rajonal dhe ndërkombëtar, me përgjigje të përmirësuara ndaj kërkesave të Shteteve Anëtare për bashkëpunim policor dhe gjyqësor. Bashkëpunimi i mëtejshëm operacional me agjencitë relevante evropiane, në veçanti me Europolin, Eurojustin dhe Frontexin është duke vazhduar. Marrëveshjet operationale me Europolin kanë hyrë në fuqi në Serbi dhe Shqipëri dhe janë në një gjendje të avancuar të përgatitjes me Malin e Zi. Komisioni vazhdon të mbështesë një rrjet rajonal të prokurorëve dhe një sistem të koordinuar për mbrojtjen e dëshmitarëve në rajon.

#### *Zhvillimi i një analize strategjike të situatës së krimit të organizuar në Malin e Zi:*

Çdo vend që dëshiron të luftoj me sukses krimin e organizuar duhet të ketë një vlerësim koherent, gjithëpërfshirës strategjik të krimit të organizuar në territorin e tij. Kjo është e nevojshme për të gjitha palët e interesuara, madje edhe përtej komunitetit të zbatimit të ligjit për t'i kuptuar kërcënimet me të cilat përballlet vendi dhe t'i menaxhoj trendët. Mali i Zi ka botuar në pranverën e vitit 2014 vlerësimin e tij të krimeve serioze dhe të organizuara duke ofruar një pasqyrë të kërcënimeve të krimit në rajon dhe në vend që ndikojnë në situatën e sigurisë së Malit të Zi. Analiza tani shërben për t'i identifikuar prioritetet e përbashkëta për organet e zbatimit të ligjit, duke iu mundësuar atyre përgatitjen e reageimeve përkatëse dhe të zbatojnë konceptin e "policimit të bazuar në inteligjencë".

Komisioni vazhdon të bashkangjes një prioritet të lartë për të gjitha aspektet e sundimit të ligjit në vendet në zgjerim. Është duke u implementuar një qasje e re në negociatat për anëtarësim në kapitujt që mbulojnë gjyqësorin dhe të drejtat themelore dhe drejtësinë, lirinë

dhe sigurinë. Kjo kërkon krijimin e regjistrave solid mbi zbatimin e reformave që do të zhvillohen në të gjithë procesin e përgatitjes për anëtarësim. BE-ja ka vendosur standarde të përkohshme në negociatat për anëtarësim për herë të parë, me Malin e Zi në dhjetor të vitit 2013. Serbia është pajisur me udhëzime të konsiderueshme për planin gjithëpërfshirës të veprimit që është duke e përgatitur si bazë për fillimin e bisedimeve për çështje të sundimit të ligjit. Ky udhëzim dhe këto standarde do të përcaktojnë tonin për negociatat e ardhshme dhe do të punojnë me vendet e tjera në zgjerim. Çështjet e sundimit të ligjit tani janë duke u trajtuar në një fazë të hershme të procesit të anëtarësimit me të gjitha vendet në zgjerim, dhe progresi në këtë fushë është një konsideratë e rëndësishme kur të vendoset në çdo fazë të procesit të anëtarësimit në BE.

#### **Përmbledhje e qasjes së re për kapitujt 23/24**

Qasja e re që mbulon kapitujt **negociues**, siç është kapitulli 23 mbi 'gjyqësorin dhe të drejtat themelore' dhe kapitullin 24 mbi 'drejtësinë, lirinë dhe sigurinë' ofron një kornizë më të strukturuar për negociatën, që merr parasysh kohën e mjaftueshme për zbatimin adekuat të reformave:

- ▶ Kp. 23/24 duhet të hapen në fillim të procesit dhe të mbyllen në fund për t'i mundësuar kohë maksimale për krijimin e regjistrave solid me qëllim të reformave të pakthyeshme.
- ▶ BE-ja do të jap udhëzime të konsiderueshme si bazë për plane të veprimit të reformave gjithëpërfshirëse, të cilat janë të nevojshme si standarde të hapjes dhe shërbejnë si katalizator për reforma.
- ▶ Prezantimi i "standardeve të përkohshme" për të udhëhequr më tej procesin e reformave dhe për t'i mbajtur reformat në rrugën e duhur.

- ▶ Standardet përmbyllëse përcaktojnë vetëm një herë progresin substancial të bërë në tërësi, duke përfshirë edhe krijimin e regjistrave mbi zbatimin në terren.
- ▶ Masat mbrojtëse dhe korrigjuese, për shembull, përditësimi i standardeve dhe sigurimi i një bilanci të plotë në progresin e negociatave në të gjitha kapitujt, pra një mekanizëm për të ndaluar negociatat mbi kapitujt tjerë, nëse ngel progresi në kapitujt 23/24.
- ▶ Transparencë dhe përfshirje më e madhe e procesit, me konsultim të gjerë me palët e interesit që pritet nga reforma, për të siguruar mbështetjen maksimale për zbatimin e tyre.

Më gjerësisht, Komisioni është duke përdorur të gjitha instrumentet në dispozicion për të forcuar sundimin e ligjit, duke përfshirë edhe monitorimin e saj të rregullt, në veçanti nëpërmjet organeve të përbashkëta sipas Marrëveshjeve të Stabilizim-Asociimit, misioneve të vlerësimit dhe dialogjeve të strukturuar; përmes raportimit, sidomos përmes raporteve të progresit; nëpërmjet asistencës financiare, me një fokus të madh mbi sundimin e ligjit sipas IPA II; përmes ngritjes së institucioneve, TAIEX-it, binjakëzimit, dhe grupit shqyrtues, i cili i vë gjyqtarët, prokurorët dhe ekspertët tjerë në funksion të zbatimit të ligjit, menaxhmentin e kufirit dhe të migrimit nga Shtetet Anëtare në kontakt të drejtpërdrejtë me homologët e tyre. Është ngritur një grup pune për kapitullin 23 sipas agjendës pozitive me Turqinë. Për të trajtuar më mirë krimin trans-nacional, Komisioni inkurajon një bashkëpunim të intensifikuar gjyqësor dhe policor në rajon, me shtetet anëtare të BE-së, si dhe me Europolin, Eurojustin dhe Frontexin, si dhe gjithnjë e më shumë edhe me Zyrën Evropiane për Mbështetje të Azilit. Në mënyrë që të zhvillohen masat e duhura për të adresuar fenomenin e luftëtarëve të huaj, vendet në zgjerim do të duhet të ngritin kapacitetin e tyre për të parandaluar radikalizmin, duke përfshirë shkëmbimin e praktikave më të mira, dhe duke rritur bashkëpunimin me Shtetet Anëtare. Procesi i liberalizimit të vizave, me kushtet e tij të veçanta për reforma, ka ndihmuar vendet që t'i përqendrojnë më mirë përpjekjet e tyre. Vendet kanë nevojë të rrisin përpjekjet e tyre për t'i konsoliduar këto reforma. Vendet pa regjim të vizave duhet të ndërmarrin masa të menjëhershme për të adresuar çdo keqpërdorim të regjimit të liberalizimit të vizave. Nevojiten përpjekje të konsoliduara në fushat e migrimit dhe menaxhimit të kufijve. Çështjet e pazgjidhura në këto fusha do të vazhdojnë të adresohen në forumet përkatëse, siç është në kuadër të MSA-së, dhe ato të përfshira në kapitullin 24 për drejtësinë, lirinë dhe sigurinë.

## *ii) Të drejtat themelore*

Komisioni është duke e vëzhguar me kujdes situatën për sa i përket të drejtave civile, politike, sociale dhe ekonomike, si dhe të drejtave të personave që u përkasin minoriteteve në vendet në zgjerim. Të drejtat themelore janë kryesisht të përfshira në ligj, por duhet më shumë të bëhet për të siguruar se ato respektohen plotësisht në praktikë. Liria e shprehjes dhe medias mbetet një shqetësim i veçantë. Nevojitet të mbrohen më mirë të drejtat e personave që u përkasin minoriteteve dhe të trajtohet diskriminimi dhe armiqësia ndaj grupeve të cënueshme, duke përfshirë edhe diskriminimin në bazë të orientimit seksual. Punë e mëtejshme gjithashtu nevojitet në promovimin e të drejtave të grave, përfshirë edhe trajtimin e dhunës në familje. Nevojiten edhe përmirësime në lidhje me të drejtat e fëmijës. Po ashtu nevojiten përpjekje të mëtutjeshme për të mbështetur personat me aftësi të kufizuara. Sfiduese mbetin çështjet në lidhje me të drejtat tjera themelore siç është e drejta e pronës. Shpesh kërkohen masa më efektive për të lehtësuar qasjen në drejtësi.

Vendet duhet të krijojnë një kornizë më të fuqishme institucionale për mbrojtjen e të drejtave themelore. Institucionet e të drejtave të njeriut, duke përfshirë atë të avokatit të popullit, janë të themeluara, por duhet t'iu jepet një rol më i fuqishëm, proporcional me seriozitetin e çështjeve në fjalë. Shumë shpesh rekomandimet e institucioneve të tilla anashkalohen, për shkak të

përcjelljes joadekuate nga organet shtetërore. Kultura e pranimit të punës së organizatave jo-qeveritare (OJQ-ve) dhe mbrojtësve të drejtave të njeriut po ashtu duhet të përmirësohen. Në mënyrë që vendet në zgjerim të integrohen më mirë në kornizën e BE-së e dhe të mbështesin përdorimin e praktikave më të mira, Komisioni inkurajon fuqimisht vendet kandidatë për të vazhduar përgatitjet e tyre me qëllim të pjesëmarrjes si vëzhguese në punën e Agjencisë së BE-së për të Drejtat Themelore.

*Garantimi i të drejtave themelore nga Gjykata Themelore në Turqi:*

Që nga viti 2011, çdo individ i cili pretendon se ndonjë prej të drejtave dhe lirive themelore të garantuara me Kushtetutën i është shkelur nga autoritetet publike mund t'i drejtohet Gjykatës Kushtetuese, në parim, pas shtrrjes së mjeteve të zakonshme juridike. Në bazë të kësaj procedure Gjykata Kushtetuese Turke, në vitin 2014, mori vendim që:

- të mbrojtë lirinë e shprehjes dhe të internetit.
- të mbrojtë të drejtën e lirisë dhe sigurisë, si dhe të drejtën për një gjykim të drejtë dhe të hapur dhe të hapë rrugën për ri-gjykim të një numri të rasteve të profilit të lartë që kanë shkaktuar ndasi në Turqi
- të njohë gjuhën e urrejtjes mbi baza të orientimit seksual si vepër penale.

➤ Liria e shprehjes dhe medias

Korniza ligjore për lirinë e shprehjes dhe medias është kryesisht e themeluar në vendet në zgjerim me peizazhe të mëdha pluraliste të mediave. Megjithatë, situata në lidhje me lirinë e shprehjes dhe të medias në praktikë është përkeqësuar në disa vende në vitin e kaluar. Shumë sfida të rëndësishme duhet të adresohen urgjentisht, ndërhyrja e Qeverisë në lirinë e mediave mbetet një shqetësim serioz. Më shumë përpjekje nevojiten për të siguruar pavarësinë politike dhe financiare të shërbimit të transmetuesve publik, për të forcuar agjencitë rregullative dhe për të nxitur vetë-rregullimin funksional të mediave. Po ashtu duhet trajtuar presioni joformal ekonomik mbi mediat, duke përfshirë transparencën e pronësisë së mediave, duke parandaluar përqendrimin e tij të tepruar dhe rregullat transparente në prokurimin e reklamave të qeverisë. Në disa vende, është kurajuar një klimë e frikës dhe censurës me vazhdimin e dhunës dhe frikësimin ndaj gazetarëve, ku ka pasur pak sukses nga ana e autoriteteve në identifikimin dhe sanksionimin e duhur të kryesve. Nganjëherë vetë Qeveritë kontribuojnë në një atmosferë e cila i cilëson si tradhtarë gazetarët kritikë ndaj politikës së qeverisë, gjë që shpien në vetë-censurë. Edhe pse shpifja është de-kriminalizuar, ndjekjet e gazetarëve ende vazhdojnë. Nevojitet që gjyqësori të zhvillohet dhe trajnohet për të parandaluar abuzimin e pushtetit shtetëror.

Komisioni vazhdon t'i përcaktojë prioritetet e punës për lirinë e shprehjes dhe të medias në procesin e anëtarësimit në BE. Komisioni do të shqyrtojë mundësinë e mbajtjes së edicionit të tretë të konferencës Speak-Up, në vitin 2015, së bashku me Parlamentin Evropian, me palët e kryesore të interesit nga mediat, shoqëria civile dhe autoritetet kombëtare. Më vonë gjatë këtij viti, Komisioni do të ndajë për herë të parë çmim për gazetarinë hulumtuese.

➤ Mbrojtja e minoriteteve, përfshirë atë Rome

Në përgjithësi, kornizat ligjore të shtjelluara mirë dhe qartë janë të themeluara për të siguruar mbrojtjen e minoriteteve. Zbatimi në praktikë është shpesh i komplikuar, megjithatë, në veçanti aty ku ka të bëjë me konfliktet e fundit. Mbetet shumë për tu bërë në sigurimin e zbatimit të duhur të angazhimeve ligjore dhe trajtimin e vështirësive me të cilat përballen pakicat etnike. Çështje të tilla si përdorimi i gjuhëve të pakicave, qasja në arsim, dhe përfaqësimi politik shpesh kërkojnë vëmendje më të madhe. Kultura e përgjithshme e pranimit të pakicave duhet të inkurajohet dhe armiqësia sociale duhet të kundërpërgjigjet, nëpërmjet edukimit, debateve të gjera publike dhe ngritjes së ndërgjegjësimit. Nevojitet të ketë



zero-tolerancë, qasje proaktive ndaj rasteve të bazuara në gjuhën e urrejtjes etnike, diskriminim, dhunën dhe frikësimin. Është e rëndësishme të konsolidohet një kornizë koherente për luftimin e formave dhe shprehjeve të caktuara të racizmit dhe ksenofobisë në fusha të tilla si mediat audiovizuale, sport, politikë, arsim dhe internet. Në tërë Ballkanin Perëndimor dhe Turqi, gjendja e shumicës së komuniteteve romë mbetet shqetësim serioz. Romët shumë shpesh janë viktimë të racizmit, diskriminimit dhe përjashtimit social dhe jetojnë në varfëri të skajshme, duke iu munguar qasja e mjaftueshme në kujdesin shëndetësor, arsim dhe trajnim, strehim dhe punësim. Mungesa e dokumentacionit civil është gjithashtu shqetësuese. Komisioni ka mbajtur një samit të nivelit të lartë mbi Romët në prill të vitit 2014 për të tërhequr vëmendjen ndaj sfidave me të cilat përballen romët në tërë Evropën, përfshirë edhe në vendet në zgjerim. Me këtë rast është theksuar roli i veçantë i autoriteteve lokale për të siguruar përfshirjen sociale të romëve. Në vitin 2014, Komisioni ka themeluar një çmim për përfshirjen e romëve për të njohur kontributin e paçmuar të OJQ-ve në integrimin e romëve.

Komisioni është duke punuar për së afërmi me secilin vend në zgjerim për të siguruar zbatimin adekuat, përcjelljen dhe monitorimin e strategjive kombëtare romë. Mbështetja financiare nga IPA gjithashtu është duke u rritur dhe dedikuar më mirë në mbështetje të avancimit të qëndrueshëm të pesë fushave prioritare atë të arsimit, punësimin, shëndetësisë, strehimit dhe dokumentacionit civil. Komisioni ka për qëllim të rrisë bashkëpunimin strategjik me organizatat ndërkombëtare dhe donatorë të tjerë. Përfshirja e romëve duhet të bëhet një prioritet kombëtar i mbështetur nga vullneti i fortë politik në të gjitha nivelet, me marrje të përgjegjësive nga të gjithë palët e interesit.

*Mbështetja në arsimin e hershëm — Asistentët mësues në Serbi:*

Me qëllim të rritjes së përfshirjes së fëmijëve romë në sistemin arsimor dhe të promovimit të përfundimit të ciklit të shkollës fillore, që nga viti 2008 është themeluar një rrjet i mbi 170 asistentëve pedagogjik. Asistentët ofrojnë mbështetje për nxënësit nga grupet e cënueshme, shumë prej të cilëve janë romë, organizojnë mësimin dhe mbajnë kontakte me prindërit. Kjo nismë, e cila tani është e përcaktuar fuqishëm në sistemin arsimor të Serbisë, ka çuar në një rritje të konsiderueshme të shkallës së regjistrimit për klasat e ulëta, si dhe programet parashkollore.

#### ➤ Orientimi seksual dhe identiteti gjinor

Homofobia, diskriminimi dhe krimet e urrejtjes, duke përfshirë dhunën dhe frikësimin në bazë të orientimit seksual dhe identitetit gjinor janë ende të përhapura në Ballkanin Perëndimor dhe Turqi. Urgjentisht nevojitet zgjerimi i legjislacionit të anti-diskriminimit për të përfshirë orientimin seksual dhe identitetin gjinor brenda fushëveprimit të tij në Turqi dhe në ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë. Legjislacioni i krimit të urrejtjes ende duhet të hartohet në këto dy vende, Bosnje-Hercegovinë dhe Kosovë. Nevojitet trajnimi i zbatimit të ligjit, të institucioneve të avokatit të popullit, gjykatësit dhe profesionistët e medias për të rritur ndërgjegjësimin e legjislacionit të ri, për të siguruar zbatimin e duhur dhe për të kontribuar në rritjen e të kuptuarit të tij.

Nevojitet qasje zero-tolerancë ndaj gjuhës së urrejtjes, dhunës dhe frikësimit, siç është udhëheqja e fortë nga autoritetet për të ndryshuar qëndrimet shpesh armiqësore shoqërore ndaj personave të komunitetit lezbian, homoseksual, biseksual, transgjinor dhe interseksual (LGBTI). Vendet duhet të marrin masa për të luftuar stereotipet dhe dezinformatat, përfshirë sistemin arsimor. Vlerat fetare apo kulturore nuk mund të përdoren për të justifikuar format e diskriminimit. Liria e tubimit dhe shprehjes duhet të mbrohet, duke përfshirë trajtimin e duhur të paradave të krenarisë.

Në fund të vjeshtës, së bashku me Parlamentin Evropian dhe Presidencën italiane të Këshillit, Komisioni do të organizojë një konferencë të nivelit të lartë për tu informuar rreth gjendjes

aktuale dhe progresit të arritur në çështjet lidhur me LGBTI-në dhe për të ndarë praktikat më të mira.

*Përmirësimi i reagimit të policisë ndaj dhunës kundër personave të LGBTI-së në Bosnje dhe Hercegovinë:*

Incidentet e kërcënimeve dhe dhunës ndaj personave në bazë të orientimit të tyre seksual në mënyrë tipike në tërë rajonin nuk janë raportuar plotësisht. Kjo pjesërisht për shkak të indiferencës dhe madje edhe armiqësisë nga ana e policisë dhe shoqërisë në përgjithësi si dhe mungesës së besimit në reagimin e autoriteteve. Policia në Sarajevë ka emëruar zyrtarë ndërlidhës të trajnuar posaçërisht për trajtimin e rasteve të kërcënimeve dhe sulmeve homofobike. Kjo nismë është rezultat i bashkëpunimit të mirë në mes të policisë dhe OJQ-ve, dhe ka ngritur ndërgjegjësimin e policisë për nevojën e trajtimit të këtij fenomeni më seriozisht dhe reagimit në mënyrë të duhur në të gjitha rastet e krimeve të urrejtjes.

➤ Të drejtat e grave

Mbetet shumë për t'u bërë në mbështetje të të drejtave të grave dhe në sigurimin e barazisë gjinore. Diskriminimi në punësim, si dhe shkalla e ulët e pjesëmarrjes së grave në fuqinë punëtore duhet të adresohen. Stereotipet dhe rolet tradicionale gjinore ende vazhdojnë, në disa raste deri në atë masë sa që seriozisht kufizojnë mundësinë e grave për të kërkuar të drejtat e tyre, sidomos në Turqi. Në Kosovë, pengesa serioze i parandalojnë gratë në realizimin e të drejtës së tyre për ta trashëguar tokën. Shumica e vendeve të rajonit e kanë ratifikuar Konventën e Këshillit të Evropës për parandalimin dhe luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje, e cila ka hyrë në fuqi këtë vit. Zbatimi i saj është çështje kyçe, pasi që **dhuna ndaj grave** dhe siguri i mbështetjes për viktimat mbetet një sfidë në të gjitha vendet. Në Turqi, dhuna në familje e bazuar në "nder", shtypja, çështja e martesave të hershme dhe të detyruara mbeten një shqetësim serioz. Konventa përcakton një seri të veprave të karakterizuara si dhunë kundër grave të cilat duhet të penalizohen. Këto përfshijnë dhunën psikologjike, fizike dhe seksuale, duke përfshirë dhunimin, martesën e detyruar, dhe ngacmimi i vazhdueshëm.

*Programi gjithëpërfshirës për barazi gjinore në Mal të Zi:*

Politikat dhe zhvillimet legjislativë në vitet e fundit kanë krijuar një bazë të re për të adresuar qasjen e grave në të drejtat e njeriut dhe mundësitë e tyre për të kontribuar në zhvillimin politik, ekonomik dhe social. Për të siguruar zbatimin e ligjeve dhe politikave, Mali i Zi ka nisur një program gjithëpërfshirës gjinor për të përmirësuar integritetin personal të grave, progresin ekonomik dhe përfaqësimin politik. Kjo ka çuar në krijimin e ekipeve multidisiplinare për të luftuar dhunën kundër grave dhe ka kontribuar në rritjen e pjesëmarrjes së grave në parlament.

➤ Të drejtat e fëmijëve

Më shumë duhet bërë për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, sidomos për të siguruar mbrojtjen nga të gjitha format e dhunës, për të përmirësuar qasjen në drejtësi dhe sistemet e drejtësisë për të mitur, promovimin e alternativave të bazuara në komunitet dhe familje deri tek institucionalizimi i fëmijëve pa kujdes prindëror (de-institucionalizimi). Shumica e vendeve të rajonit kanë hartuar tashmë kornizat ligjore dhe planet e veprimit, por zbatimi ka mbetur prapa.

### **III. Ballafaqimi me çështjet bilaterale dhe tejkalimi i trashëgimisë së kaluarës**

Marrëdhëniet e fqinjësisë së mirë dhe bashkëpunimi rajonal janë elemente thelbësore të Procesit të Stabilizim-Asociimit.

Marrëdhëniet e fqinjësisë së mirë janë forcuar përmes bashkëpunimit intensiv dhe kontakteve në nivel bilateral, edhe në fusha të ndjeshme të tilla si krimet e luftës, kthimin e refugjatëve, përmes zbatimit të programeve rajonale të strehimit nën procesin<sup>4</sup> e Sarajevës, ndërtimit të shtëpive në proces e sipër, krimit të organizuar dhe bashkëpunimit policor.

Progresi i bërë duhet të konsolidohet. Përmbytjet të cilat prekën rëndë Bosnje-Hercegovinën dhe Serbinë në muajin maj çoi jo vetëm në një reagim të fuqishëm të BE-së duke nënvizuar solidaritetin në BE dhe përfitimet për integrim më të afërt, por edhe në bashkëpunim të mirë në mes të këtyre dy vendeve dhe tërë rajonit. Solidariteti i fuqishëm u tregua përtej vijave nacionale dhe etnike, sidomos - por jo vetëm - në nivel të njerëzve të rëndomtë. Udhëheqësit politik duhet të shfrytëzojnë mundësinë që mbi këtë vullnet të mirë të përqendrohen në bashkëpunimin e mëtejshëm rreth sfidave të përbashkëta në rrugën drejt BE-së.

Nevojiten përpjekje të mëtejshme për tejkalimin e **çështjeve bilaterale** ndërmjet vendeve në zgjerim si dhe të shteteve anëtare. Shumë çështje të pazgjidhura vazhdojnë t'i rëndojnë marrëdhëniet bilaterale në rajon, veçanërisht ato që dalin prej shpërbërjes së ish-Jugosllavisë si kontestet ndër-etnike dhe të statusit, situata e pakicave, përgjegjësia për krimet e luftës, personat e pagjetur dhe demarkacioni i kufirit. Pikëpamjet krejtësisht të kundërta mbi historinë e kohëve të fundit po ashtu i rëndojnë marrëdhëniet. Hapat fillestar në mbështetje të nismës së vërtetës dhe të pajtimit KOMRA duhet të ndiqen. Pajtimi është thelbësor për të promovuar stabilitetin dhe mbështetjen e krijimit të një mjedisi të favorshëm në Evropën jug-lindore për të tejkaluar trashëgiminë e së kaluarës, duke minimizuar rrezikun e instrumentalizimit politik të çështjeve të hapura bilaterale.

Çështjet bilaterale duhet të adresohen nga palët e përfshira sa më shpejtë që është e mundur dhe nuk duhet ta ngecin procesin e anëtarësimit, i cili duhet të themelohet bazuar në kushtëzim. Komisioni u kërkon palëve të bëjnë çdo përpjekje drejt zgjidhjes së kontesteve të pazgjidhura në përputhje me parimet dhe mjetet e përcaktuara, duke përfshirë edhe duke iu referuar çështjeve të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë, sipas nevojës, ose organeve tjera ad hoc ekzistuese për zgjidhjen e kontesteve. Konteksti i negociatave mund të krijojë nxitje politike për zgjidhjen e kontesteve. Procesi i normalizimit në mes të Serbisë dhe Kosovës duhet të vazhdojë dhe Marrëveshja e Brukselit<sup>5</sup> duhet të zbatohet. BE-ja e ka integruar kërkesën për normalizimin e marrëdhënieve, në kuadër të bisedimeve me Serbinë dhe të MSA-së me Kosovën. Sa i përket ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë, ruajtja e marrëdhënieve të mira fqinjësore mbetet thelbësore, duke përfshirë edhe zgjidhjen e negociuar dhe të pranueshme reciprokisht të çështjes së emrit, nën patronazhin e OKB-së, që duhet të gjendet pa vonesa të mëtejshme. Komisioni do të vazhdojë të ofrojë mbështetje politike dhe lehtësimin për të gjitha vendet në fjalë për të gjetur zgjidhje për çështjet bilaterale sa më shpejt që është e mundur dhe do të vazhdojë të mbështesë në mënyrë aktive përpjekjet në forume të tjera për të gjetur zgjidhje.

Marrëdhëniet e mira fqinjësore vazhdojnë të përforcohen përmes iniciativave të ndryshme të bashkëpunimit rajonal. Komisioni mbështet plotësisht punën e Procesit të Bashkëpunimit të Evropës Jug-Lindore (SEECP) dhe të Këshillit për Bashkëpunim Rajonal, duke përfshirë strategjinë Rajonale të vitit 2020. Komisioni mirëpret themelimin e Asamblesë Parlamentare Rajonale SEECP në muajin maj si dhe bashkëpunimin e zgjeruar të filluar në kohët e fundit Ballkani Perëndimor Gjashtë nën Procesin e Stabilizimit dhe Asociimit. Kjo nismë ka shënuar kontakte të rëndësishme kohët e fundit në mes të ministrave të punëve të jashtme dhe të financave nga rajoni për të diskutuar sfidat e përbashkëta, në veçanti në fushën e qeverisjes ekonomike. Bashkëpunimi ka vazhduar edhe në forume të tjera rajonale të tilla si Zona

<sup>4</sup> Kroaci, Serbia, Bosnja dhe Hercegovina dhe Mali i Zi.

<sup>5</sup> Prill 2013 "Marrëveshja e parë e parimeve qeverisëse për normalizimin e marrëdhënieve"

Qendrore Evropiane për Tregti të Lirë (CEFTA), Komuniteti i Energjisë dhe Shkolla Rajonale e Administratës Publike. Është e rëndësishme që këto iniciativa janë komplementare, gjithëpërfshirëse, rajonale dhe të drejtuara në nivelin rajonal. Komisioni ka mirëpritur Samitin e Berlinit të mbajtur në muajin gusht, i cili ka demonstruar mbështetje të fuqishme politike për perspektivën Evropiane të Ballkanit Perëndimor. Janë paraparë samite tjera vjetore, me Austrinë si nikoqire të ardhshme. "Procesi i Berlinit" mund të jetë i dobishëm për nxitjen e reformave dhe dakordimin e prioriteteve reale për investime kryesore ndërlidhëse.

Gjithashtu mund të veprojë si një nxitje për të ndihmuar në zgjidhjen e çështjeve të pazgjedhura bilaterale. Komisioni është i gatshëm për të mbështetur vazhdimin e kësaj nisme.

\*\*\*

#### IV. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

Bazuar në analizën e mësipërme dhe vlerësimet në përmbledhjet e vendeve në Shtojcë, Komisioni paraqet **konkluzionet** dhe **rekomandimet** e mëposhtme:

##### I

1. Gjatë pesë viteve të fundit, Komisioni ka forcuar kredibilitetin e politikës së zgjerimit dhe ka rritur fuqinë e saj transformuese, duke siguruar një fokus më të fuqishëm në adresimin e reformave themelore në fazat e hershme të procesit të zgjerimit. Komisioni u ka vënë theks të veçantë **tri shtyllave e) sundimit të ligjit, ii) qeverisjes ekonomike dhe iii) reformës së administratës publike.**
2. Në vitin 2012 Komisioni ka paraqitur një qasje të re për sundimin e ligjit. Në vitin 2013, Komisioni ka përcaktuar kornizën për forcimin e qeverisjes ekonomike, duke u bazuar në përvojën e Semestrit Evropian. Këtë vit, Komisioni parashtron ide të reja për të mbështetur reformën e administratës publike në vendet në zgjerim. Tre shtyllat e procesit të përditësuar të zgjerimit janë të ndërlidhura dhe progresi në këto fusha do të jetë kyç për të përcaktuar se kur vendet do të jenë plotësisht të gatshme për t'iu bashkuar BE-së.
3. Politika e BE-së për zgjerim vazhdon t'i kontribuojë përfitimeve reciproke të paqes, sigurisë dhe prosperitetit në Evropë. Ajo përforcon fuqinë politike dhe ekonomike të BE-së dhe ka **ndikim të fuqishëm transformues** në vendet e interesuara. Një proces i përgatitur mirë i anëtarësimit siguron se zgjerimi nuk është në kurriz të efikasitetit të Bashkimit.
4. Dhjetë vjetori, në muajin maj, **i anëtarësimit historik të dhjetë Shteteve Anëtare** në vitin 2004, është një kujtesë e progresit të arritur. Me zgjerimin e BE-së, rriten edhe mundësitë për kompanitë tona, investitorët, konsumatorët, turistët, studentët dhe pronarët e pronave. Anëtarësimi ka sjell përfitime për vendet që i janë bashkuar BE-së dhe shtetet anëtare. Tregtia dhe investimet janë rritur. Cilësia e jetës së qytetarëve është përmirësuar pasi që standardet e BE-së për mjedis, konsumatorë dhe standardet e tjera zbatohen më gjerësisht.
5. Për vendet e Ballkanit Perëndimor, **perspektiva e qartë e anëtarësimit në BE** e dhënë nga Shtetet Anëtare të BE-së është një faktor kyç stabilizues. Ajo mbështet progresin drejt përbushjes së kushteve të nevojshme, duke përfshirë edhe ato të Procesit të Stabilizimit dhe Asociimit. Marrëdhëniet e mira fqinjësore dhe bashkëpunimi gjithëpërfshirës rajonal janë thelbësore. Përpjekjet e vazhdueshme për të trajtuar çështjet reciproke dhe për të tejkaluar trashëgiminë e së kaluarës janë vendimtare në pikëpamje të historisë së këtij rajoni të copëtuar së fundmi nga konflikt.

6. Zgjerimi është bërë një instrument i fuqishëm i politikës së jashtme të Bashkimit. Zhvillimet në fqinjësinë e BE-së theksojnë rëndësinë e politikës së zgjerimit, si një mjet për të thelluar më tej bashkëpunimin në **çështjet kyçe të politikës së jashtme**. Politika e jashtme e dialogut bilateral duhet të rritet me secilin nga vendet në zgjerim. Kapitulli 31: Siguria e Jashtme dhe Politika e Mbrojtjes duhet të adresohen në fillim me vendet negociuese. Komisioni thekson rëndësinë e përafrimit progresiv të vendeve në zgjerim me pozicionimin e politikës së jashtme të BE-së. Ai gjithashtu thekson rëndësinë e politikës së përbashkët për siguri dhe mbrojtje, duke përfshirë, për shembull, pjesëmarrjen në programet e Agjencisë Evropiane për Mbrojtje.
7. Procesi i anëtarësimit është rigoroz, i ndërtuar mbi **kushte** strikte por të drejta, kriteret të përcaktuara dhe parimin e meritave. Kjo është thelbësore për kredibilitetin e politikës së zgjerimit, për sigurimin e stimuljeve për vendet në zgjerim për të ndjekur reforma të thella dhe për të siguruar mbështetjen e qytetarëve të BE-së. Nga ana e tyre, shtetet anëtare, së bashku me institucionet e BE-së, duhet të udhëheqin një debat të informuar mbi ndikimin politik, ekonomik dhe social të politikës së zgjerimit.
8. Sa i përket shtyllës së parë, forcimi i **sundimit të ligjit** është thelbësor për procesin e përditësuar të anëtarësimit. Reforma gjyqësore duhet të ndiqet fuqishëm për të siguruar një gjyqësor të pavarur dhe të paanshëm që ndanë drejtësi në mënyrë efektive. Vendet duhet të krijojnë një regjistër të besueshëm të hetimeve, ndjekjeve penale dhe dënimeve në rastet e krimit të organizuar dhe korrupsionit. Dënimet duhet të jenë bindëse, dhe asetet e fituara nëpërmjet mënyrave penale duhet të konfiskohen. Sundimi i ligjit mbështet mjedisin e biznesit dhe të investimeve, duke ofruar siguri ligjore dhe duke kontribuar në konkurrencë, krijimin e vendeve të punës dhe rritjen ekonomike.
9. Komisioni vazhdon të zbatojë qasjen e re për sundimin e ligjit, e miratuar nga Këshilli në dhjetor të vitit 2011. Trajtimi i sundimit të ligjit në fillim të procesit të anëtarësimit rritë kohën të cilën e kanë vendet në dispozicion për të krijuar një regjistër solid të mbi përcjelljen e zbatimit të reformës. Kjo ndihmon për të siguruar se reformat janë rrënjësorë thellë dhe se janë të pakthyeshme. Në përputhje me këtë qasje të re, Komisioni është i vendosur që të sigurojë një balancë të plotë në negociatë. Progresi i arritur sipas kapitujve 23: gjyqësori dhe të drejtat themelore të njeriut dhe 24: liria e gjyqësorit dhe siguria do të duhet të bëhen paralelisht me progresin në negociatat e përgjithshme. Komisioni e rikujton ekzistencën e klauzolës së "balancit të përgjithshëm" të kornizës negociuese dhe mundësinë e ndalimit të negociatave në kapitujt tjerë, nëse progresi në sundimin e ligjit mbetet prapa.
10. **Të drejtat themelore** janë gjerësisht të përfshira në kornizën ligjore të vendeve në zgjerim, por duhet të bëhet më shumë për të siguruar se ato respektohen plotësisht në praktikë. Liria e shprehjes dhe medias mbetet një shqetësim i veçantë. Të drejtat e personave që u përkasin minoriteteve duhet të mbrohen më mirë. Diskriminimi dhe armiqësia ndaj grupeve të cënueshme, duke përfshirë edhe atë në bazë të orientimit seksual, mbetet një shqetësim i rëndësishëm. Punë e mëtutjeshme duhet bërë në promovimin e të drejtave të grave, përfshirë trajtimin e dhunës në familje, si dhe të fëmijëve dhe personave me aftësi të kufizuara. Vendet në zgjerim duhet të integrohen më mirë në kornizat e BE-së dhe të mbështetën në përhapjen e praktikave më të mira. Për këtë qëllim, Komisioni inkurajon fuqimisht vendet candidate për të vazhduar përgatitjet e tyre për pjesëmarrje si vëzhguese në punën e Agjencisë së BE-së për të Drejtat Themelore.
11. Sa i përket shtyllës së dytë, forcimi i **qeverisjes ekonomike dhe konkurrencës** në vendet në zgjerim është e rëndësishme të plotësohen kriteret ekonomike për

anëtarësim në BE. Reformat duhet të intensifikohen për të arritur rritje të qëndrueshme, përmirësim të mjedisit të biznesit dhe rritje të investimeve. Papunësia e lartë duhet të trajtohet, sidomos për të rinjtë. Në mbështetje të zhvillimit ekonomik duhet zbutur presionin migrator për BE-në. Nevoja e mundshme dhe natyra e masave tranzicionale dhe/ose mekanizmit mbrojtës për lëvizjen e lirë të punëtorëve do të trajtohen gjatë rrjedhës së negociatave të anëtarësimit për zgjerim në të ardhmen, duke marrë parasysh vlerësimin e ndikimit në të ardhmen.

12. Duke u bazuar në përvojën e Semestrit Evropian dhe qeverisjen e përforcuar ekonomike në BE, Komisioni ka nisur proceset e përmirësuar të bashkëpunimit me vendet në zgjerim. Për Ballkanin Perëndimor, Komisioni parashikon përgatitjen e Programeve të Reformës së Ekonomisë Kombëtare që përbëhet nga dy pjesë. Pjesa e parë do të përbëhet nga një version i zgjeruar i programeve ekzistuese ekonomike të para-anëtarësimit për vendet candidate dhe programet ekonomike dhe fiskale për kandidatët potencial, për të përfshirë po ashtu Kosovën. Kjo do të përcaktojë një kornizë të politikave afatmesme makroekonomike dhe fiskale, me fokus të shtuar në vlerësimin qëndrueshmërisë së jashtme dhe pengesat strukturore të rritjes. Pjesa e dytë do të mbulojë reformat strukturore të cilat janë sektoriale në natyrë dhe që kryesisht kanë të bëjë me përmirësimin e konkurrencës dhe rritjen ekonomike, duke përfshirë nevojat për investime në infrastrukturë. Me qëllim të forcimit të vëzhgimit, procesi i vlerësimit do të vazhdojë të rezultojë në udhëzime të politikës të destinuar për secilin vend. Për Turqinë, do të themelohet një dialog ekonomik i nivelit të lartë.
13. Sa i përket shtyllës së tretë, **reforma e administratës publike** (RAP) është një prioritet në të gjitha vendet. Shërbimi publik vazhdon të mbetet tepër i politizuar. Transparenca, llogaridhënia, profesionalizmi dhe efikasiteti i administratës publike duhet të rriten. Fokus më i madh kërkohet për trajtimin e nevojave të qytetarëve dhe biznesit. Menaxhimi i financave publike po ashtu ka nevojë për më shumë vëmendje. Komisioni do të integrojë më mirë reformën e administratës publike në procesin e zgjerimit. Janë krijuar "Grupe të veçanta për RAP", ose janë në proces të krijimit në vendet në zgjerim. Këto grupe do të jenë platformat kryesore për të çuar përpara punën në RAP. Në kuadër të Këshillit/Komitetit për Asociim duhet të ketë diskutime më të strukturuar, politike mbi çështjet kyçe. Negociatat për anëtarësim gjithashtu duhet të përdoren për të inkurajuar reformat e nevojshme. Çështjet kyçe duhet të trajtohen nëpërmjet kapitujve përkatës veçanërisht të prokurimit publik, kontrollit financiar, gjyqësorit dhe të drejtave themelore të njeriut, të tatimit dhe politikave ekonomike dhe monetare, dhe në kontekst të konferencave ndër-qeveritare. Grupet e veçanta gjithashtu do të jenë një forum për adresimin e çështjeve horizontale të RAP-it nga kapitujt përkatës negociues, monitorimin e progresit dhe sigurimin e qëndrueshmërisë. Rezultatet do të paraqiten në kapitullin e negociatave.
14. Për të mbështetur procesin e reformave, për vendet në zgjerim është thelbësore forcimi i funksionimit dhe pavarësisë së institucioneve kryesore demokratike. Kjo përfshin sigurimin e dialogut konstruktiv dhe të qëndrueshëm në të gjithë spektrin politik, sidomos në kuadër të parlamentit. Gjithashtu duhet të bëhet më tepër për të mundësuar një mjedis të përshtatshëm për organizatat e shoqërisë civile. Një shoqëri e fortë civile rrit përgjegjshmërinë politike dhe promovon të kuptuar më të thellë të reformave të ndërlydhura me anëtarësimin.
15. **Marrëdhëniet e mira fqinjësore** janë një element thelbësor i Procesit të Stabilizim Asociimit. Nevojiten përpjekje të vazhdueshme për të tejkaluar trashëgiminë e së kaluarës, për të promovuar pajtimin dhe në trajtimin e **çështjeve bilaterale** midis vendeve në zgjerim si dhe me Shtetet Anëtare. Çështjet bilaterale duhet të adresohen

nga palët e përfshira sa më shpejtë që është e mundur dhe nuk duhet ta ngecin procesin e anëtarësimit, i cili duhet të themelohet bazuar në kushte.

- 16. Bashkëpunimi rajonal** është forcuar më tej gjatë vitit të kaluar. Komisioni mbështet plotësisht punën e procesit të Bashkëpunimit të Evropës Jug-Lindore (SEECp) dhe Këshillit për Bashkëpunim Rajonal, duke përfshirë strategjinë Rajonale të 2020. Rritja e përfshirjes së Kosovës në nismat rajonale ka qenë një zhvillim pozitiv. Komisioni mirëpret nismën e bashkëpunimit të zgjeruar Ballkani Perëndimor Gjashtë nën Procesin e Stabilizimit dhe Asociimit. Këto zhvillime kanë forcuar dimensionin multi-lateral të politikës së zgjerimit, mbështetjen e bashkëpunimit inkluziv dhe shkëmbimin e praktikave më të mira të qeverisjes ekonomike dhe promovimin e lidhjes brenda rajonit dhe me BE-në. Komisioni gjithashtu ka mirëpritur Samitin e Berlinit të mbajtur në muajin gusht, i cili ka demonstruar mbështetje të fuqishme politike për perspektivën Evropiane të Ballkanit Perëndimor. Janë paraparë samite tjera vjetore, me Austrinë si nikoqire të ardhshme. "Procesi i Berlinit" mund të jetë i dobishëm për nxitjen e reformave dhe dakordimin e prioriteteve reale për investime kryesore ndër-lidhëse. Gjithashtu mund të veprojë si një nxitje për të ndihmuar në zgjidhjen e çështjeve të pazgjedhura bilaterale. Komisioni është i gatshëm për të mbështetur vazhdimin e kësaj nisme.
- 17.** Viti 2014 ka shënuar fillimin e **Instrumentit të ri të asistencës së para-anëtarësimit**. Përmes IPA II, BE-ja do të ofrojë 11.7 miliard euro për periudhën 2014-2020 për mbështetje të vendeve në zgjerim në përgatitjet e tyre për anëtarësim, si dhe në bashkëpunimin rajonal dhe ndër-kufitar. IPA II shton fokusin mbi prioritetet për anëtarësim në BE në fushat e demokracisë dhe sundimit të ligjit, si dhe konkurrencës dhe rritjes. IPA II gjithashtu paraqet një qasje sektoriale, stimulime për dhënien e rezultateve, rritjen e mbështetjes buxhetore dhe prioritizimin e projekteve. Nevojitet një qasje e koordinuar për investimet e mëdha përgjatë korridoreve kryesore të infrastrukturës. Koordinimi me institucionet financiare ndërkombëtare është duke u forcuar. Korniza e Investimeve të Ballkanit Perëndimor do të vazhdojë të mbështesë investimet për nxitje të vendeve të punës, rritjen ekonomike dhe promovimin e lidhjes në rajon.

## II

- 18. Mali i Zi:** Janë ndërmarrë hapa të mëtejshëm në negociatat për anëtarësim. Ekzaminimi analitik i acquis-it të BE-së (shqyrtimi) ka përfunduar në maj të vitit 2014. Në muajin dhjetor janë hapur negociatat për kapitujt 23 - Gjyqësori dhe të drejtat themelore dhe 24 - Drejtësia, liria dhe siguria. Bazuar në planet e veprimit të miratuara nga Mali i Zi, BE-ja ka themeluar një grup gjithëpërfshirës të 84 standardeve të përkohshme për kapitujt 23 dhe 24. Këto standarde ofrojnë udhëzime të qarta për reformat e ardhshme. Në total, negociatat janë hapur për dymbëdhjetë kapituj dhe përkohësisht janë mbyllur për dy.
- 19.** Ka filluar zbatimi i planeve të veprimit. Pas përafrimit të legjislacionit përkatës me reformat kushtetuese të muajit korrik të vitit 2013, një numër i zyrtarëve kryesorë të gjykatave dhe prokurorive janë zgjedhur dhe emëruar. Pas disa përpjekjeve, parlamenti më në fund emëroi Kryeprokurorin e ri të shtetit, në muajin tetor të vitit 2014. Efikasiteti i gjyqësorit është rritur. Korniza legjislative për mbrojtjen e të drejtave themelore, përfshirë edhe ligjin për Avokatin e Popullit, është forcuar.
- 20.** Megjithatë janë vërejtur vonesa në një numër masash, veçanërisht në reformat

legjislative, sidomos sa i përket anti-korrupsionit. Masat legjislative të miratuara nuk kanë dhënë rezultate në praktikë. Mali i Zi duhet të sigurojë shpejt miratimin e një ligji të përshatshëm për financimin e partive politike. Duhet të zhvillohet një regjistër i besueshëm i hetimeve, ndjekjeve penale dhe dënimeve përfundimtare në rastet e korrupsionit, duke përfshirë korrupsionin e nivelit të lartë. Përdorimi sistematik i instrumenteve të sekuestrimit dhe konfiskimit të aseteve duhet të sigurohet. Liria e shprehjes dhe medias mbesin shqetësime serioze. Duhet të përshpejtohet puna në lidhje me hetimin e rasteve të dhunës ndaj gazetarëve. Dialogu konstruktiv politik duhet themelohet dhe të kthehet besimi në procesin zgjedhor dhe në institucionet shtetërore. Për të ruajtur vrullin në rrugën drejt BE-së, forcimi i kapaciteteve administrative mbi çështjet e BE-së për integrim do të jetë thelbësor. Depolitizimi i shërbimit civil dhe rritja e profesionalizmit janë gjithashtu të nevojshme. Reforma ekonomike duhet të vazhdohet për të trajtuar papunësinë e lartë, si dhe mjedisin e përmirësuar të biznesit. Kërkohet një zgjidhje urgjente e qëndrueshme dhe në përputhje me MSA-në për prodhuesin e aluminit KAP.

21. Angazhimi i fortë politik është thelbësor për reformat e thella dhe të qëndrueshme politike të nevojshme për të forcuar sundimin e ligjit. Mali i Zi është vendi i parë që ka hapur kapitujt 23 dhe 24 sipas metodës së re për sundimin e ligjit në negociatat e anëtarësimit. Komisioni rikujton ekzistencën e klauzolës së "balancit të përgjithshëm" të kornizës negociuese. Progresi në përmbushjen e standardeve të përkohshme të kapitujve për sundimin e ligjit dhe mangësitë relevante të identifikuar më sipër, e të demonstruara me rezultate konkrete, do të ndikojë në ritmin e negociatave për anëtarësim në përgjithësi, duke përfshirë edhe agjendat e KND-ve të ardhshme.
22. **Serbia:** Negociatat për anëtarësim në BE me Serbinë janë në zhvillim e sipër. Vendimi i Këshillit të Evropës për hapjen e negociatave është marrë për shkak të progresit të Serbisë në reformat dhe angazhimin e saj të vazhdueshëm për normalizimin e marrëdhënieve të saj me Kosovën. Konferenca e parë ndër-qeveritare për negociatat është mbajtur në janar të vitit 2014. Ekzaminimi analitik i acquis-it të BE-së (shqyrtimi) po vazhdon sipas planit. Përmbytjet e rënda të cilat e goditën vendin mund të kenë pasur një ndikim të konsiderueshëm socio-ekonomik. BE-ja ka ofruar shpëtim dhe ndihma të menjëhershme dhe të konsiderueshme, si dhe ka organizuar një konferencë donatorësh në muajin korrik. Janë dhënë premtime të rëndësishme nga komuniteti ndërkombëtar për fazën e rimëkëmbjes dhe rindërtimit.
23. Serbia ka bërë progres në reformën e administratës publike. Ajo ka miratuar një strategji gjithëpërfshirëse dhe ka forcuar koordinimin dhe planifikimin. Sa i përket gjyqësorit, është miratuar legjislacioni i rëndësishëm si dhe rregullat për vlerësimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve. Një numër i rëndësishëm i kryetarëve të gjykatave janë emëruar në baza të përhershme. Ekziston një shtytje e fortë politike për të luftuar korrupsionin. Janë kryer disa hetime të rasteve të nivelit të lartë dhe janë bërë përpjekje për të përmirësuar koordinimin. Serbia ka marrë pjesë në mënyrë aktive në bashkëpunimin rajonal të zbatimit të ligjit.
24. Megjithatë, nevojiten përpjekje të vazhdueshme për të siguruar një gjyqësor të pavarur dhe efikas. Pjesët kyçe të legjislacionit mbeten për t'u miratuar, të tilla si ligji për ndihmën juridike pa pagesë, ligji për informatorët, dhe ligji për konfliktin e interesave. Korrupsioni mbetet i përhapur në shumë fusha. Serbia duhet të krijojë një mekanizëm të dhënave konkrete në luftën kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar. Të drejtat themelore duhet të respektohen plotësisht në praktikë, duke përfshirë edhe mbrojtjen e



grupeve të cenueshme. Ka shqetësime rreth përkeqësimit të kushteve për ushtrimin e plotë të lirisë së shprehjes. Dobësitë në administratën publike duhet të adresohen. Gjetjet e organeve të pavarura rregullatore duhet të përcillen më mirë. Reformat ekonomike janë gjithashtu thelbësore për të krijuar rritje dhe për të adresuar papunësinë e lartë.

25. Me mandatin e saj të fortë, qeveria e re duhet ta shfrytëzojë mundësinë për t'i çuar përpara reformat me vull. Serbia përballet me shumë sfida përpara. Serbia duhet të nxisë në mënyrë proaktive gjithëpërfshirjen dhe transparencën e procesit të anëtarësimit. Për të mbështetur procesin e reformës, Serbia duhet të përmirësojë planifikimin, koordinimin dhe monitorimin e zbatimit të legjislacionit të ri dhe politikave. Në përputhje me këtë qasje të re për çështje të sundimit të ligjit, standardet e hapjes janë përcaktuar për kapitujt 23 dhe 24. Ato kërkojnë që Serbia të paraqesë planet e plota të veprimit. Në mënyrë që të sigurohet një balanc i përgjithshëm në negociata, progresi në këta kapituj do të duhet të bëhet paralelisht me përparimin në negociatat në përgjithësi.
26. Serbia duhet të vazhdojë angazhimin e saj për bashkëpunimin rajonal dhe një angazhim aktiv dhe konstruktiv në procesin e normalizimit me Kosovën, që ka shënuar përparim të rëndësishëm. Serbia duhet të vazhdojë të sigurojë zbatimin e marrëveshjeve të arritura përmes dialogut. Komisioni rikujton se, sikurse në rastin e kapitujve për sundimin e ligjit, korniza negociuese kërkon progres në procesin e normalizimit të marrëdhënieve me Kosovën nën kapitullin 35 që duhet të bëhet paralelisht me progresin në negociata në përgjithësi. Kapitulli 35 duhet të hapet në fillim të negociatave. Kjo do të sigurojë një kornizë solide për monitorimin e zbatimit të marrëveshjeve të arritura.
27. **Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë:** Procesi i anëtarësimit në BE për ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë është në një rrugë pa krye. Dështimi për të vepruar sipas rekomandimeve të Komisionit për Këshillin do të thotë se ende nuk janë hapur negociatat për anëtarësim. Në të njëjtën kohë, dështimi i qeverisë për të bërë përpjekje të mjaftueshme për një numër çështjesh të rëndësishme ka dëmtonuar qëndrueshmërinë e reformave, me regres evident në disa fusha.
28. Pak progres është bërë sa i përket reformës së administratës publike, si dhe bashkëpunimit aktiv policor rajonal dhe ndërkombëtar. Vendi mbanë një nivel të lartë të përafrimit me *acquis-in* në lidhje me pozitën e saj në procesin e anëtarësimit. Agjenda e BE-së mbetet prioritet strategjik i vendit.
29. Megjithatë, gjatë vitit të kaluar, ka pasur shqetësime serioze në lidhje me rritjen e politizimit të institucioneve shtetërore dhe të kontrollit të qeverisë mbi mediat, duke përfshirë kontekstin e zgjedhjeve siç raportohet nga OSBE/ZIDDNJ. Besimi në institucionet shtetërore është duke u zbehur në mënyrë të vazhdueshme. Ka shqetësime në rritje rreth drejtësisë selektive. Situata e lirisë së mediave ka vazhduar të përkeqësohet. Kriza e fundit politike në mes të partive qeveritare dhe të opozitës ka treguar se interesat partiake i mbizotërojnë interesat kombëtare. Është përgjegjësi e qeverisë dhe opozitës të sigurojnë se debati politik zhvillohet kryesisht në parlament dhe të kontribuojnë në krijimin e kushteve për funksionimin e duhur të tij. Qeveria duhet të sigurojë që opozita ta ketë mundësinë për të kryer plotësisht funksionin e vet demokratik të kontrollit. Në të njëjtën kohë, opozita gjithashtu duhet të angazhohet në mënyrë konstruktive në proceset demokratike. Asnjë takim i dialogut të nivelit të lartë për anëtarësim nuk është mbajtur gjatë vitit të kaluar. Sa i përket situatës ndër-etnike, besim më i madh në mes të komuniteteve duhet të ndërtohet. Shqyrtimi i Marrëveshjes Kornizë të Ohrit duhet të përfundojë dhe rekomandimet e saj të zbatohen.

30. Mbetet esenciale ndërmarrja e hapave vendimtarë në drejtim të zgjidhjes së "çështjes së emrit" me Greqinë. Dështimi i palëve në këtë mosmarrëveshje për të arritur një kompromis, pas 19 vjet bisedimesh të ndërmjetësuar nga OKB-ja është duke ndikuar drejtpërdrejtë dhe negativisht në aspiratat evropiane të vendit. Nevojiten veprime për gjetje të zgjidhjes, si dhe mbështetje aktive nga udhëheqësit e BE-së. Komisioni rikujton qëndrimin e vetë se, në qoftë se shqyrtimi dhe diskutimet e Këshillit mbi kornizën negociuese do të ishin në zhvillim e sipër, do të mundë të krijohej momenti i duhur i cili do të kishte mbështetur gjetjen e një zgjidhje të negociuar dhe reciprokisht të pranuar për çështjen e emrit edhe para hapjes së kapitujve negociues.
31. Në përgjithësi, duke pasur parasysh progresin e akumuluar që vendi ka arritur, Komisioni konsideron se kriteret politike vazhdojnë të plotësohen në mënyrë të mjaftueshme dhe mbanë rekomandimin e vetë për të hapur negociatat e pranimit, por i vjen keq për hapat e kthimit prapa gjatë vitit të kaluar. Komisioni kërkon nga autoritetet të marrin veprim vendimtar për të adresuar shqetësimet në lidhje me rritjen e politizimit dhe mangësitë në rritje në lidhje me pavarësinë e gjyqësorit dhe lirinë e shprehjes në mënyrë që rekomandimi i tij të mund të jetë i qëndrueshëm në vitet e ardhshme. Komisioni mbetet i përkushtuar për të ndihmuar përpjekjet e vendit, edhe përmes një procesi gjithëpërfshirës të dialogut të nivelit të lartë për anëtarësim, në adresimin e të gjitha reformave të lidhura me BE-në në mënyrë që potenciali i plotë i marrëdhënieve të mund të arrihet.
32. **Shqipëria:** Vendimi i Këshillit Evropian i muajit qershor të vitit 2014 për t'i dhënë Shqipërisë statusin e kandidatit është vlerësim për hapat e ndërmarrja në lidhje me reformën. Po ashtu është një inkurajim për të rritur tempon e reformave. Në nëntor të vitit 2013, Komisioni filloi një dialog të nivelit të lartë me Shqipërinë për të ndihmuar vendin në ruajtjen e fokusit mbi procesin e saj të integrimit në BE dhe për të monitoruar progresin e reformave sipas prioriteteve kyçe të identifikuar për hapjen e negociatave për anëtarësim. Në maj të vitit 2014, Shqipëria miratoi një plan udhërrëfyes ku ka përcaktuar dhe strukturuar reformat e saja të planifikuara mbi prioritetet kyçe.
33. Shqipëria ka bërë progres gjatë vitit të kaluar. Janë ndërmarrë hapa të mëtejshëm në drejtim të reformës së gjyqësorit.

Qeveria ka treguar vullnet politik për të vepruar me vendosmëri në parandalimin dhe luftën kundër korrupsionit. Korniza legjislative është forcuar dhe koordinimi i politikave dhe monitorimi në nivel qendror është përmirësuar. Lufta kundër krimit të organizuar tregon një trend pozitiv në një numër fushash, me një intensifikim të aktiviteteve të zbatimit të ligjit, sidomos për konfiskimin e drogës dhe krimet të lidhura me të, dhe për krimin ekonomik dhe trafikimin e qenieve njerëzore. Janë ndërmarrë disa hapa për të përmirësuar njohjen ligjore të drejtave të komunitetit lezbian, homoseksual, biseksual, transeksual dhe interseksual.

34. Megjithatë, shumë mangësi mbeten, sidomos në fushën e sundimit të ligjit. Shumë punë mbetet të kryhet. Luftimi i korrupsionit dhe krimi i organizuar janë sfida të rëndësishme. Shqipëria do të duhet të bëjë përpjekje të konsiderueshme dhe të qëndrueshme për të adresuar zbatimin e prioriteteve kryesore të identifikuar për hapjen e negociatave për anëtarësim. Shqipëria do të duhet të veprojë me vendosmëri: të vazhdojë reformën e administratës publike me qëllim të rritjes së profesionalizmit dhe depolitizimit të saj; të ndjekë një reformë gjithëpërfshirëse të gjyqësorit për të përforcuar pavarësinë e tij, efikasitetin dhe llogaridhënien përmes një procesi gjithëpërfshirës dhe në konsultim të ngushtë me Komisionin e Venecias; të intensifikojë përpjekjet e saj ndaj anti-korrupsionit dhe të marrë hapa të vendosur në

luftën kundër krimit të organizuar, me qëllim të krijimit të një regjistri solid të hetimeve proaktive, ndjekjeve penale dhe dënimeve në të dyja fushat; dhe të ndërmarrë masa efektive për të përforcuar mbrojtjen e të drejtave të njeriut, përfshirë ato të romëve, politikat anti-diskriminuese, si dhe zbatimin e të drejtave pronësore. Sa i përket lirisë së shprehjes dhe të medias, qeveria ka dështuar të veprojë në prioritetet e identifikuar. Të gjitha funksionet ligjore të Autoritetit të Mediave Audiovizive duhet të rivendosen dhe pavarësia e tij të garantohet në praktikë. Shqipëria duhet t'i vazhdojë reformat ekonomike që synojnë rritjen e konkurrencës dhe trajtimin e papunësinë së lartë, si dhe trajtimin në nivelin e lartë të informalitetit në ekonomi dhe përmirësimin e mjedisit të biznesit.

35. Është e rëndësishme që procesi i reformës të shoqërohet nga një dialog konstruktiv dhe i qëndrueshëm politik ndërmjet qeverisë dhe opozitës. Është përgjegjësi e qeverisë dhe opozitës për të siguruar se debati politik zhvillohet kryesisht në parlament dhe për të kontribuar në krijimin e kushteve për funksionimin e duhur të tij. Qeveria duhet të sigurojë që opozita të ketë mundësi të kryejë plotësisht funksionin e vet demokratik të kontrollit. Në të njëjtën kohë, opozita gjithashtu duhet të angazhohet në mënyrë konstruktive në proceset demokratike. Puna konstruktive dhe e bazuar në kompromis në parlament është jetike për qëndrueshmërinë e reformave. Krijimi i Këshillit Kombëtar për Integrim Evropian, që bashkon të gjithë akterët, do të ndihmojë më tej në rritjen e përfshirjes së procesit të reformës. Ai është gjithashtu çelësi për konsensus mbi reformat përkatëse në tërë shoqërinë shqiptare.
36. **Bosnja dhe Hercegovina:** Vendi vazhdon të mbetet në të njëjtin vend në procesin e integritimeve evropiane. Ende ka mungesë të vullnetit kolektiv politik nga ana e udhëheqësve politik për të trajtuar reformat e nevojshme për përparim në rrugën drejt BE-së. Ka pasur shumë pak përparim në çështjet politike dhe ekonomike dhe në lëvizjen drejt standardeve evropiane. Vërshimet e mëdha që kanë goditur vendin në muajin maj kanë pasur një ndikim të madh socio-ekonomik. BE-ja ka ofruar shpëtim dhe ndihma të menjëhershme dhe të konsiderueshme, si dhe ka organizuar një konferencë donatorësh në muajin korrik. Janë dhënë premtime të rëndësishme nga komuniteti ndërkombëtar për fazën e rimëkëmbjes dhe rindërtimit.
37. Protestat qytetare anembanë vendit në fillim të vitit 2014 kanë vënë në pah gjendjen e brishtë socio-ekonomike. Komisioni ka lansuar tri nisma për ta kthyer përqendrimin drejt reformave dhe çështjeve të brengave të drejtpërdrejta të qytetarëve. Ka zgjeruar edhe Dialogun e Strukturuar BE-Bosnjë dhe Hercegovinë mbi drejtësinë për çështje shtesë të sundimit të ligjit, në veçanti për luftën kundër korrupsionit.

Komisioni ka themeluar një Grup të Përbashkët Pune BE-Bosnjë dhe Hercegovinë për të përshpejtuar zbatimin e fondeve të financuara nga BE-ja. Është përqendruar në fuqizimin e qeverisjes ekonomike. Kjo ka përfshirë zhvillimin e një 'Pako për Rritje dhe Vende Pune' bashkë me akterët kryesorë, përfshirë institucionet financiare ndërkombëtare. Pakoja do të jetë metri për matje të reformës së nevojshme ekonomike gjatë muajve në vijim. Gjithashtu do të jetë bazë për Programin e Reformës Ekonomike Kombëtare të cilën Komisioni pret që vendi ta zhvillojë deri në fund të janarit 2015.

38. Mungesa e një mekanizmi efektiv bashkërendues për çështjet e BE-së vazhdon të ndikojë negativisht bashkëveprimin e vendit me BE-në. Tensionet politike brenda Këshillit të Ministrave lidhur me ndarjen e kompetencave ndërmjet niveleve të ndryshme të pushtetit kanë vazhduar. Kjo është shtuar nga kompleksiteti i aranzhimeve institucionale në vend. Kjo ka parandaluar sjelljen e tri nga gjashtë takimet e fundit të nën-komitetit në kuadër të Marrëveshjes së Përkohshme. Bosnja

dhe Hercegovina gjithashtu ende refuzon të adaptojë këtë Marrëveshje për të marrë parasysh tregtinë e saj tradicionale me Kroacinë para se kjo të hyjë në BE. Komisioni ka ndërmarrë hapat për të pezulluar Bosnjë dhe Hercegovinën nga përfitimet e caktuara tregtare nëse procesi i adaptimit nuk finalizohet deri në fund të vitit 2015. Marrëveshja për Stabilizim dhe Asociim (MSA) e nënshkruar në vitin 2008 dhe e ratifikuar në vitin 2011 ende nuk ka hyrë në fuqi pasi që Bosnja dhe Hercegovina ende nuk i ka përmbushur kushtet.

39. Akterët politik të përfshirë nuk kanë mundur të pajtohen rreth strategjive mbarëkombëtare të kërkuara për instrumentin për asistencë para-anëtarësimit në sektorët siç janë energjia, transporti dhe mjedisi. Kjo ka shkaktuar një zvogëlim domethënës të financimit në këto fusha dhe ri-përqendrim në ndihmën nga e cila qytetarët përfitojnë drejtpërdrejt. Arritja e marrëveshjeve të nevojshme do të hapë rrugën për Bosnjë dhe Hercegovinën që të përfitojë tërësisht nga financimi në dispozicion.
40. Përkundër përpjekjeve intensive për lehtësim nga ana e Komisionit, për të zgjidhur bllokadat e mbetura, vendimi Sejdić-Finci i Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut nuk është zbatuar. Vendimi vazhdon të instrumentalizohet për interesa të ngushta partiake, politike dhe etnike dhe zgjidhja për këtë është e lidhur me çështjet tjera.
41. Që Bosnja dhe Hercegovina të përparojë në rrugën drejt BE-së është me rëndësi që të gjitha nivelet e pushtetit të formohen shpejtë pas zgjedhjeve dhe që hapat konkret të reformës të ndërmerren shpejt. Udhëheqja politike i ka borxh qytetarëve të Bosnjës dhe Hercegovinës që tu ofrojë një drejtim të qartë për vendin. Efikasiteti dhe funksionimi i institucioneve politike në të gjitha nivelet e pushtetit duhet të përmirësohet. Kjo vlen në veçanti për bashkëveprimin ndërmjet niveleve të ndryshme të pushtetit. Kjo kërkon themelimin e një mekanizmi funksional bashkërendues për çështjet e BE-së. Administrata publike gjithashtu ka nevojë për fuqizim gjithëpërfshirës.
42. **Kosova:** Përmbyllja e bisedimeve të Marrëveshjes për Stabilizim dhe Asociim me Kosovën dhe fillimi i saj në muajin korrik është moment i rëndësishëm në rrugën e Kosovës drejt integritimeve evropiane. Kjo do të jetë marrëveshja e parë gjithëpërfshirëse ndërmjet BE-së dhe Kosovës. MSA ofron dialog të avancuar politik, integrim më të afërt tregtar, përfshirë hapjen e tregjeve të BE-së për prodhimet industriale dhe bujqësore të Kosovës, dhe mënyrat e reja të bashkëpunimit. Komisioni tani mirëpret nënshkrimin dhe përmbylljen e saj. Pas zgjedhjeve të qershorit, ka pasur një mjedis gjithnjë e më të polarizuar politik dhe Kosova ka ardhur në një gjendje bllokimi politik, duke i vonuar disa reforma kyçe.
43. Kosova ka shënuar përparim në dialogun e saj për liberalizimin e vizave. Bashkëpunimi i mirë me misionin e BE-së për sundim të ligjit, EULEX, ka vazhduar. Autoritetet Kosovare kanë bërë një zotim domethënës politik për të vazhduar mandatin e misionit duke marrë më shumë përgjegjësi, si dhe janë pajtuar që të ngritin një gjykatë të specializuar për të dëgjuar rastet e hetimeve të udhëhequra nga Taskë Forca e Veçantë për Hetime. Për ta përmbyllur këtë proces, Kosova duhet të bëjë ndryshime të nevojshme legjislative, përfshirë edhe kushtetutën. Kosova duhet të bashkëpunojë me gjykatën e planifikuar dhe të merret me të kaluarën.
44. Kosova ballafaqohet me shumë sfida. Sundimi i ligjit në Kosovë, përfshirë pavarësinë gjyqësore dhe rezultatet e kufizuara në luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit mbetet brengë e madhe. Duhet bërë më shumë për të trajtuar mangësitë e dala në pah gjatë dialogut të vizave, përfshirë zbutjen e rreziqeve të sigurisë dhe

migrimit të liberalizimit potencial të vizave. Nevoja për reforma strukturore ekonomike që trajtojnë nivelin e lartë të papunësisë po bëhet urgjente. Reformat e rëndësishme si reforma zgjedhore dhe reforma e administratës publike duhet të merren si prioritet si dhe duhet trajtuar mbrojtja e pakicave.

45. Kosova duhet të punojë në mënyrë aktive në agjendën e saj të reformës Evropiane dhe prioritetet e theksuara në Studimin e Fizibilitetit 2012 si dhe në Raportet më të fundit të Progresit. Në kuadër të MSA, Kosova është zotuar për reformë gjithëpërfshirëse dhe përafrim të legjislacionit me *acquis*-in e BE-së, përfshirë sektorët si sundimi i ligjit, administrata publike, ekonomia, konkurrenca dhe tregtia. Kosova duhet të përqendrohet në përgatitjen e zbatimit të rrjedhshëm të MSA-së, përfshirë strukturat e nevojshme. Komisioni qëndron i gatshëm që të përkrahë Kosovën në lëvizjen drejtë kësaj faze të rëndësishme në marrëdhëniet e tij me BE-në dhe përshkallëzimit të dialogut të saj me Këshillin Kombëtar për Integritet Evropian.
46. Përparimi i Kosovës drejt së ardhmes së saj Evropiane ka qenë i mundur për shkak të përparimit të bërë nga Kosova në reforma dhe zotimit të saj të vazhdueshëm për normalizimin e marrëdhënieve të saj me Serbinë, që ka shënuar përparim të konsiderueshëm. Në këtë drejtim, qeveria e re e Kosovës do të duhet të vazhdojë përkushtimin për bashkëpunim rajonal dhe një angazhim aktiv dhe konstruktiv në procesin e normalizimit me Serbinë. Kosova duhet të vazhdojë të sigurojë zbatimin e marrëveshjeve të arritura gjatë dialogut.
47. Gjendja në veriun e Kosovës mbetet e tensionuar. Të gjithë akterët duhet të bashkëpunojnë me EULEX-in dhe të përmbahen nga ndërmarrja e hapave të njëanshëm. EULEX-i duhet përkrahur plotësisht për ta kryer mandatin e tij në veriun e Kosovës. Përpjekje të mëtejme duhet bërë për tu mundësuar katër komunave veriore që të funksionojnë në kuadër të kornizës ligjore të Kosovës.
48. **Turqia:** Turqia është vend kandidat dhe partner strategjik i Bashkimit Evropian. Ekonomia e saj dinamike ofron një kontribut të vlefshëm për prosperitetin në kontinentin Evropian. Zhvillimet shumë serioze në rajon, sidomos në Siri dhe në Irak, e bëjnë bashkëpunimin në çështjet e politikës së jashtme edhe më të rëndësishëm. Lokacioni strategjik i Turqisë gjithashtu thekson rëndësinë e bashkëpunimit të mëtejme në fushat e politikës së migrimit dhe sigurisë së energjisë. Vlera e një bashkëpunimi të tillë është edhe më e qartë në kuadër të sfidave të konsiderueshme të paraqitura gjatë zhvillimeve të fundit në fqinjësinë tonë të përbashkët, përfshirë krizën e Ukrainës.
49. Bisedimet aktive dhe të besueshme për anëtarësim ofrojnë kornizën më të përshtatshme për shfrytëzimin e potencialit të plotë të marrëdhënieve BE-Turqi. Marrë parasysh fushëveprimin dhe thellësinë e pakrahasueshme të tij, procesi i anëtarësimit, të cilin asnjë alternativë nuk mund ta zëvendësojë, promovon reformat lidhur me BE-në dhe ofron një bazë të rëndësishme për intensifikimin e dialogut mbi politikën e jashtme dhe çështjet e sigurisë dhe për fuqizimin e aftësisë konkurruese ekonomike dhe mundësive tregtare. Gjithashtu ndihmon shtimin e bashkëpunimit në fushën e energjisë, drejtësisë dhe punëve të brendshme, përfshirë vizat/politikën e migrimit/ripranimit. Bisedimet rreth anëtarësimit për të rikthyer momentumin, duke respektuar përkushtimin e BE-së dhe vendosur kushtet. BE-ja duhet të mbesë një lidhje e rëndësishme për reformat ekonomike dhe politike të Turqisë. Në këtë aspekt, është në interes të Turqisë dhe BE-së që pikat fillestare referuese për kapitullin 23: Gjyqësori dhe të Drejtat Fundamentale dhe 24: Drejtësia, Liria dhe siguria duhet të përcaktohen sa më parë, duke shpjerë në hapjen e bisedimeve në kuadër të këtyre dy kapitujve. Turqia mund të përshpejtojë ritmin e bisedimeve duke avancuar në përmbushjen e standardeve, kushteve të kornizës së bisedimeve dhe respektimin e

obligimeve kontraktuale drejt BE-së. Kjo mund të ofrojë nxitje për procesin e negociatave. Ndërkohë, bashkëpunimi ndërmjet BE-së dhe Turqisë duhet të zhvillohet në të gjitha fushat kryesore, sidomos atyre të identifikuar në agjendën pozitive.

50. Turqia luan një rol të rëndësishëm rajonal dhe në mënyrë aktive është e përfshirë në fqinjësinë e saj të gjerë. Në këtë drejtim, zhvillimi i mëtejshëm i dialogut dhe bashkëpunimi rreth çështjeve të politikës së jashtme me interes të përbashkët është i nevojshëm. Janë mirëpritur pjesëmarrja e vazhdueshme e Turqisë në misionet dhe operacionet e Politikës së Përbashkët për Mbrojtje dhe Siguri (CSDP), dhe oferta e saj e fundit për të kontribuar në EUFOR CAR dhe EUBAM Libi. Roli i Turqisë në Siri, sidomos lidhur me përkrahjen shumë të rëndësishme humanitare ofruar për Sirianët që po ikin nga dhuna përtej kufirit, është rol kyç. BE-ja është betuar që të vazhdojë përkrahjen për qeveritë dhe komunitetet nikoqire në fqinjësinë të Sirisë që ato të mund të merren në mënyrë efektive me shtimin e vazhdueshëm të refugjatëve dhe të ndërtojnë fleksibilitetin e tyre. Turqia ka bërë të qartë gatishmërinë e saj për të luajtur një rol aktiv në koalicionin kundër ISIL-it. Dialogu politik duhet të përdoret për të zhvilluar bashkëpunim më të ngushtë kundër ISIL-it dhe rrjeteve të financimit të tij. Dialogu aktiv kundër-terrorizmit ndërmjet BE-së dhe Turqisë mirëpritet dhe duhet forcuar më tutje, sidomos në fushën e ‘luftëtarëve të huaj’. Ky bashkëpunim do të avancohet më tutje pas miratimit nga Turqia të legjislacionit shtesë relevant kundër-terrorizmit. BE-ja vazhdon të inkurajojë Turqinë në zhvillimin e politikës së saj të jashtme si plotësim i bashkërendimit me BE-në, dhe në mënyrë të vazhdueshme të përafrojë politikat dhe pozitën e saj me BE-në.
51. Zbatimi i reformave të miratuara viteve të fundit, në veçanti i masave të shpallura në shtator të vitit 2013 të pakos së demokratizimit, ka vazhduar. Gjykata Kushtetuese ka nxjerrë një numër vendimesh të rëndësishme që ka ilustruar fleksibilitetin e sistemit kushtetues të vendit. Marrëveshja për ri-pranim BE-Turqi është nënshkruar në dhjetor të vitit 2013, paralelisht me fillimin e dialogut për liberalizimin e vizave, dhe ka hyrë në fuqi më 1 tetor 2014, duke krijuar një momentum të ri në marrëdhëniet BE-Turqi. Ka pasur përpjekje të vazhdueshme drejt një zgjidhjeje paqësore të çështjes kurde, sidomos miratimit të legjislacionit që synon ‘sjelljen e një baze më të fortë ligjore për procesin’. Ky proces ka rëndësi historike për Turqinë dhe duhet ndjekur me besim të mirë në të gjitha palët.
52. Reagimi i qeverisë pas akuzave për korrupsion në dhjetor të vitit 2013 ka ndikuar në rritjen e shqetësimeve serioze lidhur me pavarësinë e gjyqësorit dhe ndarjen e kompetencave. Riemërimet e shumta dhe shkarkimi i zyrtarëve policor, gjyqtarëve dhe prokurorëve, përkundër pohimeve të qeverisë që këto raste nuk ishin të lidhura me rastin kundër-korrupsionit, kanë ndikuar në funksionimin efikas të institucioneve relevante, dhe kanë ngritur pyetje rreth mënyrës së përdorimit të procedurave që janë përdorur për t’i formalizuar këto. Me rëndësi vendimtare është që hetimet e dyshimeve për korrupsion të bëhen siç duhet në transparencë të plotë dhe të sigurohen mundësitë operative të gjyqësorit dhe policisë. Përpjekjet për të ndaluar mediat sociale, më vonë të refuzuara nga Gjykata Kushtetuese, dhe presionet mbi shtypin që kanë shpjerë në përhapje të vetë-censurës, pasqyrojnë një qasje kufizuese për lirinë e shprehjes. Qasja e përdorur në fushën e lirisë së tubimit mbetet kufizuese. Legjislacioni turk dhe zbatimi i tij lidhur me të drejtën për tu tubuar dhe ndërhyrja nga oficerët për zbatimin e ligjit do të duhet të sillen në vijë me standardet Evropiane.
53. Në këtë kontekst, prioritetet për Turqinë do të jenë promovimi i dialogut ndërmjet spektrit politik dhe shoqërisë së gjerë, për t’i ngjallur përpjekjet e saj për reformë në sundimin e ligjit dhe për të kushtuar vëmendje të veçantë respektimit të të drejtave themelore në ligj dhe në praktikë. Hapja e bisedimeve për kapitujt 23 dhe 24 do të

siguronte për Turqinë një udhërrëfyes gjithëpërfshirës për reformën në këtë fushë thelbësore. Turqia ftohet që të angazhohet në mënyrë më sistematike me Komisionin dhe organet tjera relevante si Këshilli i Evropës, përfshirë Komisionin e Venecias. Në përgjithësi, më shumë vëmendje duhet dhënë zbatimit efektiv të legjislacionit ekzistues. Ministria për Çështje Evropiane ka një rol jetik për të luajtur në sigurimin e përkujdesjes dhe përputhshmërisë së legjislacionit të ri me ligjet e BE-së. Komisioni e mirëpret vazhdimin konkret të Turqisë me strategjinë e saj evropiane, të miratuar kohën e fundit, e cila synon të ngjallë procesin e anëtarësimit të Turqisë.

54. Agjenda Pozitive, e filluar në vitin 2012, vazhdon të përkrahë dhe plotësojë bisedimet rreth anëtarësimit me Turqinë nëpërmjet bashkëpunimit të shtuar në një numër fushash me interes të përbashkët. Më shumë kontakte të nivelit të lartë ndërmjet Turqisë, BE-së dhe Shteteve të saj Anëtare do të forconin bashkëpunimin e mëtejshëm. Sfidat në fushën e drejtësisë dhe punët e brendshme, sidomos në fushën e migrimit, duhet të adresohen përmes përpjekjeve të shtuara të përbashkëta. BE-ja pret zbatim të plotë dhe efikas të obligimeve të Turqisë në kuadër të marrëveshjes për ripanim ndaj të gjitha shteteve anëtare.
55. Me ekonominë e saj të madhe dhe dinamike, Turqia është gjithashtu partner i rëndësishëm tregtar për BE-në dhe komponent i vlefshëm i aftësisë konkurruese të BE-së nëpërmjet Bashkimit Doganor. Tani është koha për të punuar drejt lirim të potencialit të plotë të Bashkimit Doganor. BE-ja bashkë me Turqinë duhet të angazhohet rreth zgjerimit dhe modernizimit të marrëdhënieve të tregtisë së ndërsjellë për të mirë të të dyja palëve. Një numër çështjesh lidhur me funksionimin e Bashkimit Doganor, në bazë të vlerësimit të bërë në vitin 2014, duhet trajtuar gjithashtu. Është gjithashtu shumë me rëndësi që të zhvillojë një dialog aktiv dhe të gjerë ekonomik. Forcimi i mëtejshëm i bashkëpunimit për energji BE-Turqi dhe përparimi në negociatat rreth anëtarësimit do të ndihmonte ndërlidhjen dhe integrimin e tregjeve të energjisë. Bashkëpunimi ekonomik do të zgjerohej përmes hapjes së negociatave për Kapitullin 5 (prokurimi publik), Kapitullin 8 (Konkurrenca) dhe Kapitullin 19 (Punësimi dhe politikat sociale), posa Turqia të arrin standardet e nevojshme.
56. Komisioni thekson të gjitha të drejtat sovrane të shteteve anëtare të BE-së. Kjo përfshin, mes tjerash, të drejtën për të hyrë në marrëveshje bilaterale dhe për të hulumtuar dhe shfrytëzuar pasuritë natyrore në pajtim me *acquis*-in e BE-së dhe ligjin ndërkombëtar, përfshirë Konventën e OKB-së mbi Ligjin për Detin. Në pajtim me pozicionet e përsëritura të Këshillit dhe Komisionit nga vitet e mëhershme, tani është urgjente që Turqia të përmbushë obligimin e saj për zbatim të plotë të Protokollit Shtesë dhe të bëjë përparim drejt normalizimit të marrëdhënieve me Republikën e Qipros. Kjo do të mund të siguronte momentum të ri në procesin e anëtarësimit, në veçanti duke lejuar një përafrim të caktuar në tetë kapitujt e mbuluar nga përfundimet e Këshillit në dhjetor të vitit 2006. Komisioni gjithashtu kërkon shmangien e çdo lloj rreziku, burimi mosmarrëveshjeje apo veprimi provokativ që do të mund të dëmtonte marrëdhëniet e mira fqinjësore dhe zgjidhjen paqësore të mosmarrëveshjeve. Komisioni mirëpret përkrahjen e Turqisë për vazhdimin e bisedimeve të plota për zgjidhje në Qipro. Tani është me rëndësi që një përkrahje e tillë të pasohet me deklarata konstruktive dhe veprime konkrete.
57. Sa i përket **çështjes së Qipros**, Komisioni mirëpret vazhdimin e bisedimeve për zgjidhje në mes të udhëheqësve të komunitetit të Qipriotëve Grekë dhe Qipriotëve Turq, si dhe emërimin e Z. Espen Barth Eide si Këshilltar Special i Sekretarit të përgjithshëm të OKB-së për Qipron. Komisioni pret që të dyja palët së shpejti të hyjnë në bisedime përmbajtësore të strukturuar që do të hapur rrugën për një marrëveshje për zgjidhje gjithëpërfshirëse të problemit të Qipros për të mirë të

gjithëve. Komisioni inkurajon hapat që kontribuojnë drejt një klime pozitive ndërmjet komuniteteve dhe të cilat janë në dobi të Qipriotëve në përditshmërinë e tyre dhe mirëpret nismat e shoqërisë civile për këtë qëllim. BE-ja ka deklaruar gatishmërinë e saj për të akomoduar kushtet e një zgjidhjeje në pajtim me parimet mbi të cilat është themeluar Bashkimi Evropian. Deklaratat që nuk ndihmojnë në krijimin e një atmosfere pozitive në kontekst të bisedimeve të vazhdueshme për zgjidhje duhet shmangur.

- 58. Islanda:** pas një vendimi nga qeveria e Islandës, bisedimet rreth anëtarësimit janë pezulluar që nga maji i vitit 2013. Duke marrë parasysh qëndrimin e qeverisë, Komisioni ka vazhduar me përmbylljen e IPA-së për Islandën. Islanda mbetet partner i rëndësishëm për BE-në nëpërmjet pjesëmarrjes së saj në marrëveshjen për Zonën Ekonomike Evropiane, anëtarësisë së saj në zonën e Schengenit si dhe nëpërmjet bashkëpunimit në çështjet e Arktikut.



## SHTOJCË

### **Përmbledhje e gjetjeve të raportit të progresit mbi Malin e Zi, Serbinë, ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë, Shqipërinë, Bosnjë dhe Hercegovinën, Kosovën dhe Turqinë**

#### **Mali i Zi**

Mali i Zi vazhdon të përmbushë **kriteret politike** në masë të mjaftueshme. Qeveria ka mbetur e përqendruar në Integrimin Evropian. Strukturat për bisedimet rreth anëtarësimit janë forcuar edhe më tutje. Miratimi i Planit të Veprimit 2014-15 për zbatimin e strategjisë për reformë të administratës publike dhe themelimi i grupit të ri të veçantë për reformë të administratës publike në kuadër të kornizës së Marrëveshjes për Stabilizim dhe Asociim (MSA), duhet të përkrahë përparimin në këtë fushë. Administrata publike duhet të racionalizohet edhe më tutje, transparenca të shtohet për të kufizuar fushëveprimin për korrupsion dhe sigurimin e forcimit të kapacitetit administrativ në fushën e integritimit Evropian. Nevojiten përpjekje serioze për të trajtuar nivelin e lartë të politizimit në shërbimit civil dhe siguruar rekrutimin në bazë të meritave dhe promovimin. Rritja e profesionalizmit dhe efikasitetit është e rëndësishme, sidomos për të pajisur administratën për sfidat e bisedimeve rreth anëtarësimit dhe zbatimit të *acquis*. Për menaxhimin e financave publike, kapaciteti për parashikim financiar duhet forcuar dhe përmbushja me standardet Evropiane duhet zbatuar.

Akuzat për shkelje kanë prishur raundet zgjedhore të mbajtura në një numër komunash në fillim të vitit 2014. Ato duhet të hetohen sipas rastit dhe, nëse është e nevojshme, të ndiqen nga autoritetet kompetente. Për shkak të klimës së polarizuar politike, formimi i administratave të reja në disa komuna pas zgjedhjeve ka qenë proces i vështirë. Legjislacioni i ri zgjedhor është miratuar në muajt shkurt dhe mars. Legjislacioni përmbushë disa rekomandime të veçanta të OSBE/ZIDDNJ, ndërsa disa çështje mbesin për tu trajtuar në pajtim me standardet dhe praktikën më të mira Evropiane. Miratimi i plotësim/ndryshimeve të ligjit mbi financimin e partive politike është shënuar me kundërthënie, ku pala kryesore qeverisëse ka votuar kundër. Pas vendimit të gjykatës kushtetuese në qershor, një pjesë e konsiderueshme e plotësim/ndryshimeve në ligjin mbi financimin e partive politike janë parë si jo-kushtetuese. Mali i Zi ka nevojë që shumë shpejt të vendosë kornizën e tij legjislative në këtë fushë në pajtim të plotë me standardet Evropiane dhe praktikën më të mirë, si dhe të ofrojë një regjistër fillestar mbi zbatimin e saktë të ligjit, përfshirë aplikimin e sanksioneve parandaluese kur kërkohet. Hetimi gjyqësor i keqpërdorimit të dyshuar për fonde publike për qëllime të partive politike mbetet të përfundohet dhe të sigurohet përgjegjësia politike.

Në fushën e reformës gjyqësore, zbatimi i masave në përputhje me afatet kohore të parapara në Planin e Veprimit është duke vazhduar. Pas përafrimit të legjislacionit relevant me reformën kushtetuese të korrikut të vitit 2013, janë zgjedhur disa zyrtarë gjyqësor dhe prokurorial. Pas disa përpjekjesh, kuvendi përfundimisht emëroi Kryeprokurorin e ri të Shtetit në tetor të vitit 2014. Reformat që prezantojnë sistemin unik rekrutues mbarëkombëtar për gjyqtarë dhe prokurorë, sistemi objektiv dhe i bazuar në meritë për promovim si edhe sistemi i përmirësuar disiplinor, duhet përfunduar. Ndërsa efikasiteti i gjykatave është rritur përgjithësisht, si dhe përpjekjet për avancim të mëtejshëm të efikasitetit të gjyqësorit duhet të vazhdojnë.

Ndikimi i masave kundër-korrupsion deri më tani ka qenë i kufizuar. Qysh para fillimit të operacionit të agjencisë kundër-korrupsion, institucionet ekzistuese në fushën e parandalimit të korrupsionit duhet të forcohen për të pasur një qasje më proaktive. Korrupsioni vazhdon të mbizotërojë në shumë fusha dhe vazhdon të jetë problem serioz. Një regjistër i besueshëm i hetimeve, ndjekjeve dhe dënimeve përfundimtare në rastet e korrupsionit, përfshirë korrupsionin e nivelit të lartë, duhet të zhvillohet. Përdorimi sistematik i instrumenteve të

konfiskimit dhe sekuestrimit të pasurive duhet të sigurohet. Ndërsa ka vazhduar të zhvillohet regjistri në fushën e luftës kundër drogës dhe rasteve të reja për trafikim të migrantëve, vazhdojnë edhe vështirësitë në trajtimin e mënyrave tjera të krimit të organizuar, përfshirë trafikimin e qenieve njerëzore, krimet kibernetike dhe shpëlarjen e parave. Numri i dënimeve përfundimtare, për korrupsion dhe krim të organizuar, është i kufizuar, me raste që shpesh dërgohen për rigjykim në bazë të shkeljeve procedurale. Lufta kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit është thelbësore për luftimin e infiltrimit kriminal të sistemit politik, ligjor dhe ekonomik.

Korniza ligjore dhe institucionale për respektimin e të drejtave të njeriut është e vendosur ndërsa elementet kryesore të së drejtës ndërkombëtare për të drejtat e njeriut janë përfshirë në sistemin ligjor. Kapaciteti i institucioneve përgjegjëse për mbrojtjen dhe zbatimin e të drejtave të njeriut kërkon forcim, përfshirë edhe gjyqësorin dhe policinë. Grupet e cenushme si romët dhe personat me aftësi të kufizuara më së shumti preken nga mangësitë në këtë fushë.

Shqetësime serioze mbesin lidhur me lirinë e shprehjes, që është ndikuar nga rastet e dhunës ndaj gazetarëve dhe sulmet mbi pronat e mediave. Rastet e vjetra dhe të reja të kërcënimeve dhe dhunës kundër gazetarëve mbesin për tu hetuar dhe ndjekur me kujdes, për të identifikuar jo vetëm kryesit material të veprave por edhe ata që qëndrojnë prapa sulmeve. Rastet më të vjetra në veçanti duhet trajtuar si çështje urgjente për të parandaluar vjetërsimin e tyre. Një Komision për monitorimin e aktiviteteve të autoriteteve kompetente në hetime të rasteve të vjetra dhe të reja dhe dhunës ndaj gazetarëve është themeluar në dhjetor. Rekomandimet e tij duhet të përcillen tërësisht nga autoritetet. Qeveria duhet të vazhdojë që publikisht të promovojë dhe përkrahë lirinë e mediave, duke shmangur çfarëdo deklarate që mund të kuptohet si frikësim. Organet vetë-rregullatore përgjegjëse për mirëmbajtjen dhe promovimin e standardeve profesionale dhe etike janë të dobëta.

Autoritetet Malazeze kanë ndërmarrë hapa të mëtejshëm për të forcuar mbrojtjen e të drejtave të komunitetit lezbian, homoseksual, biseksual, transgjinorë dhe transeksual (LGBTI). Parada e parë e krenarisë në Podgoricë është mbajtur në tetor të vitit 2013, me përkrahje adekuate nga autoritetet. Megjithatë, sulmet ndaj personave të komunitetit LGBTI kanë vazhduar dhe dënimet penale ligjore mbesin të pakta. Armiqësia ndaj tyre mbetet e përhapur në shoqëri.

Është bërë progres lidhur me gjendjen e romëve, sidomos në lidhje me vijimin e shkollës; megjithatë, përqindja e braktisjes së shkollimit dhe pjesëmarrja e ulët e vajzave rome në mesin e popullsisë rome është për tu shqetësuar. Diskriminimi ndaj romëve dhe nën-përfaqësimi i tyre politik duhet trajtuar.

Mali i Zi vazhdon të mbajë marrëdhënie të mira bilaterale me shtetet tjera në zgjerim dhe shtetet fqinje anëtare të BE-së dhe është fuqishëm e përfshirë në zhvillimin e bashkëpunimit rajonal. Është nënshkruar një marrëveshje kufitare me Bosnjë dhe Hercegovinën.

Mali i Zi ende e mban marrëveshjen për imunitet bilateral 2007 me Shtetet e Bashkuara, duke bërë përjashtime nga juridiksioni i Gjykatës Ndërkombëtare të Krimeve. Mali i Zi duhet të përafrohet me pozitën e BE-së në kuadër të bisedimeve rreth anëtarësimin.

Sa i përket **kritereve ekonomike**, Mali i Zi ka ndërmarrë disa hapa të mëtejshëm drejt funksionimit të ekonomisë së tregut. Shteti duhet të jetë i aftë të përballojë presionet e konkurrencës dhe forcat e tregut brenda Bashkimit në plan afatgjatë, duke qenë se vazhdon të trajtojë dobësitë aktuale nëpërmjet reformave të përshtatshme strukturore.

Ekonomia është përmirësuar në vitin 2013 nga një recesion i dyfishtë, por prapë është e brishtë për shkak të kërkesës së dobët vendore, bazës së ngushtë prodhuese, dhe varësisë së lartë nga mjedisi i jashtëm. Deficiti i llogarisë rrjedhëse disi është ngushtuar por prishja e ekuilibrit të

jashtëm mbetet e lartë. Deficitet e konsiderueshme dhe të vazhdueshme buxhetore tregojnë për masa të konsolidimit fiskal për të siguruar ulje të borxhit publik. Përkundër përmirësimeve margjinale, kushtet e tregut të punës mbeten të pasigurta në pikëpamje të normave shumë të larta të papunësisë, sidomos në mesin e të rinjve dhe të papunëve afatgjatë.

Mali i Zi duhet të rrisë lëvizshmërinë e punëtorëve dhe të forcojë efikasitetin e politikave aktive të tregut të punës, si dhe të rrisë cilësinë e arsimit, duke përfshirë arsimin dhe aftësimin profesional. Për të mbështetur zhvillimin e sektorit privat, duhet të merren masa për të lehtësuar më tej mjedisin rregullator dhe ligjor, duke përfshirë forcimin e zbatimit të kontratës, duke ulur kostot administrative dhe pengesat, dhe lehtësuar procedurat e privatizimit. Situata e pazgjidhur e kompanisë së aluminit KAP bën thirrje për një zgjidhje të qëndrueshme, të zbatuar në pajtim me rregullat e MSA, për të shmangur një raund të ri të detyrimeve kontingjente.

Sa i përket **aftësisë për të marrë përsipër obligimet e anëtarësimit**, Mali i Zi është në shkallë të ndryshme të përafrimit. Si rezultat i procesit të shqyrtimit, Komisioni ka vlerësuar se, në njëzet kapituj, Mali i Zi ka përparuar dukshëm në negociatat në hapjen pa përcaktimin e standardeve të hapjes për këta kapituj. Nga këta kapituj, dhjetë tashmë janë hapur, me standarde të përkohshëm ose përmbyllës e vendosur dhe dy janë mbyllur përkohësisht. Përveç kapitujve për sundimin e ligjit, standardet hapëse janë vendosur në njëmbëdhjetë kapituj<sup>6</sup>. Përmbyllja e standardeve të hapjes si dhe standardeve të përkohshme të përcaktuara për kapitujt e sundimit të ligjit dhe standardet e përmbylljes, të përcaktuara për tetë kapituj,<sup>7</sup> duhet të udhëzojnë Malin e Zi në rrugën e tij drejt integritimit.

Në përgjithësi, Mali i Zi është duke përparuar me përafrimin e tij në disa kapituj të *acquis*-it, duke përfshirë edhe të drejtën e pronës intelektuale, shkencën dhe hulumtimin, arsimin dhe kulturën, mbrojtjen e konsumatorit dhe shëndetit, dhe politikën e jashtme, të sigurisë dhe mbrojtjes. Mali i Zi në përgjithësi është përafër me, dhe ka zbatuar masat shtrënguese të paraqitura nga vendimet e Këshillit, duke përfshirë masat kufizuese të BE-së në kontekstin e aneksimit të paligjshëm të Krimesë nga Rusia dhe ngjarjeve në Ukrainën lindore.

Bashkë me *acquis*-in dhe forcimi i kapacitetit të nevojshëm administrativ mbetet një sfidë domethënëse për Malin e Zi. Administrata Malazeze do të duhet të përqendrohet në trajtimin e standardeve të mbetura të hapjes. Prioritet i veçantë duhet t'i kushtohet sigurimit të pajtueshmërisë me rregullat e ndihmës shtetërore MSA në rastin e KAP. Kapacitetet administrative në të gjitha fushat e mjedisit dhe ndryshimeve klimatike duhet forcuar në nivel qendror dhe lokal për të siguruar harmonizimin me dhe zbatimin e *acquis* për mjedisin dhe klimën.

## Serbia

Serbia vazhdon të përmbushë **kriteret politike** në masë të mjaftueshme. Zgjedhjet parlamentare në fillim të marsit konfirmuan aspiratat e vendit për Integrim Evropian. Pranimit në BE mbetet qëllimi kryesor i qeverisë së re. Ajo mund të mbështetet në një shumicë të paparë prej dy të tretash në kuvend për të kryer reformat kyçe prioritare të nevojshme për të drejtuar vendin në rrugën e saj Evropiane. Qeveria Serbe i ka përcaktuar qëllimet ambicioze në këtë drejtim. Reformat kushtetuese në fazën e hershme të legjislaturës së re do të paraqisnin progres vendimtar në negociatat për anëtarësim. Vëmendje duhet t'i kushtohet vazhdimin të përmirësimit të përfshirjes dhe transparencës së procesit të reformës. Procedura parlamentare

<sup>6</sup> Lëvizja e lirë e mallrave; e drejta e ngritjes dhe liria për të ofruar shërbime (Mali i Zi ka përmbushur Standardin e Hapjes së këtij Kapitulli dhe, si rrjedhojë, është ftuar që të paraqesë qëndrimin e tij negociues); politikat konkurruese; bujqësia dhe zhvillimi rural; siguria e ushqimit, fitosanitarisë dhe veterinarisë; peshkimi; energjia; politika ekonomike dhe monetare; politika sociale dhe punësimi; politika rajonale dhe koordinimi i instrumenteve strukturore; mjedisi dhe ndryshimet klimatike.

<sup>7</sup> Qarkullimi i lirë i kapitalit; prokurimi publik; Ligji mbi ndërmarrjet; Ligji i pronësisë intelektuale; Shoqëria e informacionit dhe media; politika për ndërmarrje dhe atë industriale; politika e jashtme, e sigurisë dhe e mbrojtjes; kontrolli financiar.

urgjente duhet të kufizohet në rastet kur është shumë e domosdoshme. Roli i organeve të pavarura rregullative duhet të njihet në mënyrë të vazhdueshme dhe rekomandimet e tyre duhet respektuar. Një Konventë Kombëtare për Bashkimin Evropian është krijuar si platformë për bashkëpunim me shoqërinë civile në procesin e negociatave rreth anëtarësimit në qershor, e cila duhet të materializohet në konsultim të shtuar me tërë shoqërinë civile, sidomos në kohën e sfidave të veçanta ekonomike dhe sociale për qytetarët serbë.

Serbia po përparon në reformimin e administratës së saj publike. Ajo ka miratuar një strategji gjithëpërfshirëse dhe të forcuar për bashkërendimin dhe planifikimin e politikave publike, me themelimin e një Sekretariati të ri për politikën publike. Një reformë e shëndoshë dhe gjithëpërfshirëse, e mbështetur nga analizat dhe mjetet e duhura të menaxhimit të performancës, megjithatë është ende e nevojshme.

Janë ndërmarrë hapat e parë për zbatimin e strategjive kombëtare për reformën gjyqësore dhe në luftën kundër korrupsionit të miratuar vitin e kaluar. Serbia ka shqyrtuar me kujdes sfidat me të cilat është duke u përballur gjyqësori i saj. Janë zhvilluar aktivitetet intensive legislative. Janë miratuar rregullat e vlerësimit për gjyqtarët dhe prokurorët. Një numër i konsiderueshëm i kryetarëve të gjykatave janë emëruar me bazë të përhershme. Brezi i parë i noterëve publik ka marrë detyrën. Pjesa kryesore e legjislacionit megjithatë mbetet për t'u miratuar, si ligji për ndihmë juridike falas. Vlerësimi i zbatimit të ligjeve të miratuar kohët e fundit është në pritje. Progresi është i nevojshëm për të siguruar një gjyqësor efikas të pavarur. Rekrutimi dhe emërimi i gjyqtarëve mbeten të udhëhiqen nga kriteret e paqarta. Përgjithësimi i sistemit sfidues dhe modifikimi i rrjeteve gjyqësore ende nuk kanë pasur një ndikim të dukshëm në efikasitetin dhe cilësinë e gjyqësorit.

Ekziston një shtytje e fortë politike për të luftuar korrupsionin. Disa hetime të rasteve të nivelit të lartë janë kryer dhe janë bërë përpjekje për të përmirësuar bashkërendimin dhe udhëheqjen institucionale në këtë fushë. Megjithatë, korrupsioni mbetet i përhapur në shumë fusha dhe mbetet një problem serioz. Raporti i dënimeve me paditë është i ulët. Mekanizmat për mbrojtjen e informatorëve ende nuk janë vendosur. Mekanizmat efikas për parandalimin ende mbeten për tu ndërtuar. Roli i Agjencisë Kundër-Korrupsionit dhe i Këshillit duhet të mbështetet në nivelin më të lartë dhe rekomandimet dhe propozimet e tyre duhet të respektohen. Duhet të gjenden alternativa efikase për numrin e tepruar të fajësimeve nën veprën e shpërdorimit të pozitës në sektorin privat.

Serbia në mënyrë aktive ka marrë pjesë në bashkëpunimin rajonal për zbatimin e ligjit, të cilat kanë dhënë rezultate konkrete në luftën kundër krimit të organizuar, duke shpjerë në veçanti drejt një arrestimi të profilit të lartë në lidhje me grupet e krimit të organizuar. Vlerësimi strategjik i kërcënimit ndaj krimit të organizuar është i nevojshëm, me qëllim të zhvillimit të planifikimit strategjik dhe analizës dhe pastaj reagimeve të duhura për zbatimin e ligjit, duke përfshirë edhe konceptin e punës policore të bazuar në inteligjencë. Regjistrat e besueshëm për hetimet, ndjekjet penale dhe dënimet përfundimtare duhet të zhvillohen në rastet e korrupsionit dhe krimit të organizuar, duke përfshirë edhe ato të nivelit të lartë. Luftimi i krimit të organizuar dhe korrupsionit është thelbësor për luftën kundër infiltrimit kriminal të sistemeve politike, juridike dhe ekonomike.

Në të ardhmen, miratimi i besueshëm dhe gjithëpërfshirës i Planeve të Veprimit për kapitujt 23 dhe 24, në përputhje me qasjen e re, do të jetë një moment historik i rëndësishëm për Serbinë.

Korniza ligjore për mbrojtjen e pakicave është gjerësisht e vendosur, por duhet të sigurohet zbatimi i saj në të gjithë vendin, veçanërisht në fushat e arsimit, përdorimit të gjuhëve, dhe qasjes në media dhe në shërbime fetare në gjuhët e pakicave. Masat pozitive të ndërmarra për përmirësimin e gjendjes së romëve duhet të përshejtohen, sidomos kur është fjala për arsimin, strehimin dhe punësimin. Nevojiten përpjekje të mëtejshme të qëndrueshme për të

përmirësuar situatën e refugjatëve dhe personave të zhvendosur.

Parada e Krenarisë, e cila u zhvillua në Beograd më 28 shtator pa incidente të mëdha, është një hap i rëndësishëm drejt ushtrimit efektiv të të drejtave të njeriut në përgjithësi, dhe në veçanti të drejtave të komunitetit lezbian, homoseksual, biseksual, transgjinorë dhe interseksual (LGBTI). Serbia ka bërë një hap të rëndësishëm drejt zbatimit të strategjisë për media 2011 duke miratuar një pako të legjislacionit të medias, në muajin gusht, e cila është projektuar për të rritur transparencën dhe të financimin e pronësisë së mediave dhe për përafrimin e një legjislacioni dhe praktikës me kornizën e BE-së. Megjithatë, ka shqetësime rreth përqesimit të kushteve për ushtrimin e plotë të lirisë së shprehjes. Autoritetet mbajnë një përgjegjësi të rëndësishme që në mënyrë aktive kontribuojnë në ushtrimin e papenguar të lirisë së shprehjes, duke përfshirë edhe duke treguar mbështetjen e duhur të organeve të pavarura, mbrojtësve të të drejtave të njeriut dhe gazetarëve të pavarur. Promovimi i të gjitha të drejtave themelore dhe zbatimi i strategjisë kundër-diskriminimit do të kërkojë një qasje më të përkushtuar dhe proaktive.

Serbia ka vazhduar të miratojë një qasje konstruktive në bashkëpunimin rajonal dhe ka bërë përmirësime të rëndësishme kur është fjala për marrëdhëniet me disa nga fqinjët e saj.

Sa i përket **normalizimit të marrëdhënieve me Kosovën**, Serbia ka vazhduar të jetë e angazhuar në dialog dhe në përgjithësi e angazhuar për zbatimin e marrëveshjes së parë, prill 2013, rreth parimeve që rregullojnë normalizimin e marrëdhënieve dhe marrëveshjeve të tjera të arritura në dialog. Kjo ka shpjerë në një numër të ndryshimeve të pakthyeshme në terren, me zgjedhjet lokale dhe parlamentare të mbajtura në mbarë Kosovën për herë të parë dhe shkarkimin e policisë serbe dhe strukturave të drejtësisë, që kanë qenë mjaft të avancuara. Një zgjidhje e përhershme për përfshirjen e Kosovës në Procesin e Bashkëpunimit të Evropës Jug-Lindore (SEECF), është miratuar. Ndërsa nuk ka pasur takime të nivelit të lartë që prej zgjedhjeve të parakohshme që janë mbajtur në Kosovë, puna ka vazhduar në nivel teknik, duke shpjerë në progres në fushat e grumbullimit doganor, MIK-së, energjisë dhe telekomeve.

Megjithatë, progresi në zbatimin e dialogut në përgjithësi është ngadalësuar. Zgjedhjet e parakohshme të përgjithshme janë mbajtur në Serbi dhe Kosovë. Është e rëndësishme që dialogu i nivelit të lartë të rifillojë. Është gjithashtu e rëndësishme që të dy palët të vazhdojnë të angazhohen plotësisht në zbatimin në mirëbesim të të gjitha marrëveshjeve ekzistuese. Progresi i mëtejshëm duhet gradualisht të shpie drejt normalizimit të plotë të marrëdhënieve midis Serbisë dhe Kosovës, në formën e një marrëveshje ligjërish të detyrueshme deri në fund të negociatave të Serbisë rreth anëtarësimit, me perspektivën e të dyjave, Serbisë dhe Kosovës, duke qenë në gjendje që të ushtrojnë plotësisht të drejtat e tyre dhe të përmbushin përgjegjësitë e tyre.

Sa i përket **kritereve ekonomike**, Serbia ka bërë progres të kufizuar drejt krijimit të një ekonomie funksionale të tregut. Një varg i gjerë i reformave strukturore duhet të zbatohen në mënyrë që të përballen në periudhën afatmesme me presionet konkurruese dhe forcat e tregut brenda Bashkimit.

Ekonomia edhe ashtu e tkurrur në gjysmën e parë të vitit, gjithashtu është ndikuar nga përmbytjet e rënda. Qeveria ka bërë një fillim serioz për programin e saj ambicioz të reformave ekonomike dhe strukturore me miratimin e një pakoje të parë të ligjeve të rëndësishme të punës, privatizimit dhe falimentimit. Pavarësisht një sërë masash të reja, zbalancimet fiskale mbeten shumë të larta dhe borxhi qeveritar ka vazhduar të rritet. Megjithatë, eksportet në rritje kanë kontribuar në ngushtimin e zbalancimeve të jashtme. Inflacioni ka arritur nivele historikisht të ulëta, sipas objektivit të bankës qendrore. Papunësia ende mbetet shumë e lartë.

Nevojiten përpjekje të konsiderueshme për të zvogëluar shpenzimet e qeverisë dhe zbatuar

reformat strukturore të miratuara, për të rivendosur qëndrueshmërinë fiskale dhe në fund për të mbështetur rritjen ekonomike. Zvogëlimi i ndikimit të rëndë shtetëror në ekonomi kërkon trajtimin e joefikasitetit në sektorin e gjerë publik, avancimin e privatizimit në përputhje me planin, riorganizimin me ndihmën e shtetit dhe përmirësimin e qeverisjes së korporatave të kompanive publike. Mbledhja e tatimit duhet të përmirësohet edhe duke trajtuar sektorin e gjerë joformal. Mjedisi i biznesit vuan nga burokracia e tepruar dhe dalja e ngadaltë në treg, shumë pengesa për investime si sistemi i dobët ligjor dhe zbatimi i ngadalshëm i kontratave. Përqindja e lartë e kredive joperformuese duhet trajtuar në mënyrë efikase për të përmirësuar kredi dhënie bankare. Përmirësimi i infrastrukturës fizike, sidomos pas dëmit të shkaktuar nga përmbytjet, kërkon përpjekje të vazhdueshme dhe krijimin e hapësirës shtesë fiskale. Sistemi arsimor duhet të bëhet më efikas në funksion të numrit në rënie të nxënësve dhe mospërputhjes së aftësive të tyre me tregun e punës.

Sa i përket **aftësisë së saj për të marrë përsipër obligimet e anëtarësimit**, Serbia ka vazhduar përafrimin e legjislacionit të saj me kërkesat e legjislacionit të BE-së në shumë fusha. Ajo ka vazhduar të zbatojë obligimet e veta sipas Marrëveshjes për Stabilizim Asociim (MSA) pa probleme. Progres i mirë mund të raportohet në shoqërinë e informacionit dhe medias me miratimin e pakos së tri ligjeve zbatuese të strategjisë për mediat, të vitit 2011, duke e përafuar kështu edhe më tutje kornizën legjislative të Serbisë me *acquis*-in. Legjislacioni për transportin hekurudhor, ajror dhe rrugor është përafuar edhe më tutje. Njoftimi për rezultatet e regjistrimit të popullsisë dhe të bujqësisë ka vazhduar. Strategjia e re për reformën e administratës publike nga janari i vitit 2014 përfshin kontrollin financiar publik të brendshëm në mesin e prioriteteve të reformës.

Në fushën e politikës së jashtme dhe të sigurisë, përafrimi i Serbisë me deklaratat e BE-së dhe vendimet e Këshillit duhet të përmirësohet në mënyrë që Serbia t'i përmbush kërkesat sipas kornizës së bisedimeve për të përafuar gradualisht politikat dhe vendimet e saj në këtë fushë me ato të miratuara nga Bashkimi Evropian dhe shtetet anëtare në periudhën deri në anëtarësim. Serbia urgjentisht duhet të shtjellojë dhe zbatojë mekanizma të besueshëm dhe të fuqishëm të monitorimit dhe mbikëqyrjes për përafrim të plotë me *acquis*-in. Përpjekje të konsiderueshme nevojiten gjithashtu jo vetëm për të rritur dhe zbatuar kornizën e përgjithshme ligjore, por gjithashtu, e që është edhe më e rëndësishmja, të mbështeten këto reforma me resurse të përshtatshme financiare dhe njerëzore. Ekziston edhe një mungesë e bashkërendimit dhe lidhshimit institucional në disa fusha kyçe të *acquis*-it dhe nevojës për të mbrojtur pavarësinë e organeve rregullatore. Legjislacioni për kontrollin e ndihmës shtetërore duhet të jetë më përputhje me *acquis*-in dhe në mënyrë efikase të zbatohet për të gjitha ndërmarrjet, duke përfshirë ato në procesin e ristrukturimit dhe privatizimit. Përpjekjet e mëtejshme janë të nevojshme për të rregulluar procedurën e azilit në përputhje me standardet e BE-së si dhe duhet të përmirësuar urgjentisht objektet e përhershme akomoduese. Serbia duhet të rritë përpjekjet e veta drejt përafrimit në fushën e energjisë, duke përfshirë edhe gazsjellësin 'South Stream'. Ajo ka nevojë të bëjë një ndarje në sektorin e gazit dhe ristrukturimin e kompanisë publike të gazit 'Srbijagas', si çështje prioritare. Gjithashtu nevojitet përputhshmëri e mëtutjeshme në fushën e tatimit, mjedisit, ndryshimit të klimës, organizmave të modifikuar gjenetikisht, së bashku me forcimin thelbësor të sistemit të përgjithshëm shëndetësor dhe mbrojtjes sociale.

### **Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë**

Në përgjithësi, shteti po i plotëson mjaftueshëm kriteret politike. Ky shtet ka kompletuar një mori reformash sa i përket sistemit gjyqësor dhe në administratë publike ka shënuar progres që nga marrja e statusit kandidat në vitin 2005. Niveli i përafrimit të legjislacionit është i lartë në

raport me pozitën e shtetit karshi procesit të anëtarësimit. Megjithatë, ka ende sfida serioze, kurse ato në disa fusha vetëm se janë shtuar. Këto, në veçanti, kanë të bëjnë me kulturën politike gjithnjë e më shumë përçarëse, shqetësime serioze rreth rritjes së politizimit dhe kontrollit qeveritar ndaj institucioneve dhe mediave, si dhe situatës ende të brishtë ndër-etnike. Zgjedhjet presidenciale dhe ato të parakohshme parlamentare të muajit prill të vitit 2014 janë vlerësuar nga OSBE-ja të kenë qenë të administruara në mënyrë efikase, por të ndikuara nga mungesa e ndarjes në mes të aktiviteteve shtetërore dhe partiake dhe raportimeve të njëanshme të mediave. Shqetësimet rreth përzierjes së shtetit me partitë qeverisëse po e zvogëlojnë besimin në institucionet publike. Mungesa e dialogut dhe ndasitë e vazhdueshme midis partive rikthyen krizën politike, e cila u shfaqë nga akuzat që lidheshin me zgjedhjet me ç'rast partia kryesore opozitare u largua nga parlamenti. Partitë kryesore politike kanë bërë përpjekje të mangëta për t'u përfshirë në politika konstruktive në interes të tërë elektoratit dhe vendit në përgjithësi. Qeveria dhe opozita duhet të ndër marrin hapa të duhur për ta restauruar dialogun politik në parlament. Qeveria duhet të siguroj që opozita të ketë mundësi për ta kryer në tërësi funksionin e saj të kontrollit demokratik. Në të njëjtën kohë, opozita duhet të angazhohet në mënyrë konstruktive në proceset demokratike.

Politizimi i administratës publike, si në nivel lokal ashtu edhe në atë qendror, mbetet një shqetësim serioz. Parimet e transparencës, llogaridhënies dhe meritave ende nuk aplikohen plotësisht. OSBE/ZIDDNJ veç tjerash raportuan edhe rreth trysnisë që u ushtrua mbi punonjësit e sektorit publik gjatë zgjedhjeve të mbajtura në prill të vitit 2014. Këto probleme duhet adresuar nëpërmjet kornizës së re legjislativë.

Pavarësia dhe kompetencat e gjykatave duhet përmirësuar edhe më tej dhe duhet t'i vihet më tepër fokus kualitetit të drejtësisë së ndarë për qytetarët. Përparimi i lartë i shtetit në nivel legjislativ dhe atë teknik po errësohet nga shqetësimet e shtuara në lidhje me drejtësinë selektive. Regjistrat janë duke u zhvilluar, mirëpo korrupsioni ende mbizotëron në shumë fusha dhe vazhdon të jetë një problem serioz. Korniza anti-korrupsion duhet të zbatohet në mënyrë më efikase.

Janë bërë përmirësime në fushën e bashkëpunimit me policinë dhe në luftimin e krimit të organizuar dhe trafikimit të qenieve njerëzore. Duhet vazhduar përpjekjet për krijimin e regjistrave të hetimeve, ndjekjeve penale dhe dënimeve në rastet e krimit të organizuar dhe korrupsionit. Luftimi i krimit të organizuar dhe korrupsionit është themel i kundërvënies ndaj infiltrimit kriminal të sistemeve politike, ligjore dhe ekonomike.

Është vendosur korniza e përgjithshme për mbrojtjen e të drejtave themelore mirëpo duhet të vihet më tepër fokus mbi zbatimin e saj efikas. Përpjekjet e vazhdueshme janë të nevojshme për t'i adresuar shqetësimet lidhur me paragjykimet dhe diskriminimet ndaj popullatës romë dhe për t'iu kundërvënë mostolerancës ndaj komunitetit lezbian, homoseksual, biseksual, transgjinnor dhe interseksual (LGBTI).

Sa i përket lirisë së mediave aty kemi një përkeqësim. Ndikimi i qeverisë mbi informacionet e dala nga mediat ushtrohet nëpërmjet, *ndër të tjera*, reklamave të financuara nga shteti. Rrallë vërehet ndonjë raportim i pavarur, mungojnë informatat objektive dhe të sakta nga mediat kryesore për publikun, siç mungojnë edhe debatet e informuara publike.

Sa i përket marrëdhënieve ndër-etnike, Marrëveshja e Ohrit, e cila i dha fund konfliktit të vitit 2001, siguron një kornizë që garanton karakterin multi-etnik të shoqërisë. Megjithatë, ende ka mosbesim midis komuniteteve. Tensionet mund të ndizen fare lehtë nga ndonjë ngjarje a incident. Nevojitet një qasje më proaktive dhe më e përbashkët për ta promovuar shoqërinë multi-etnike. Rishqyrtimi i Marrëveshjes së Ohrit duhet akoma të kompletohet dhe rekomandimet e saj të zbatohen.

Vendi në përgjithësi ka marrëdhënie të mira me vendet tjera në zgjerim dhe luan një rol aktiv në bashkëpunimin regional. Mbetet ende e rëndësishme qasja konstruktive në raport me shtetet fqinje anëtare të BE-së. Duhet shmangur veprimet dhe deklaratat të cilat ndikojnë negativisht në marrëdhëniet e mira ndër-fqinjësore.

Sa i përket **kritereve ekonomike**, ish Republika Jugosllave e Maqedonisë ka përparuar mirë

dhe, në disa fusha, ka bërë progres të mëtejshëm në krijimin e ekonomisë funksionale të tregut. Për t'i bërë ballë presioneve konkurruese dhe forcave afat-mesme të tregut të Bashkimit Evropian, ky shtet duhet të adresoj sfidat e rëndësishme nëpërmjet zbatimit të palëkundshëm të reformave strukturore.

Rimëkëmbja ekonomike ka vazhduar të përparoj, por mbetet e bazuar ngushtësisht në sektorin e jashtëm, dhe ka ndikuar pak edhe në papunësi e cila mbetet e lartë, sidomos tek të rinjtë. Reformat të cilat adresojnë ngurtësitë strukturore të tregut të punës kanë përparuar ngadalë. Qëndrueshmëria financiare është ruajtur kurse janë rritur hyrjet nga IHD. Disiplina fiskale si dhe transparenca dhe cilësia e shpenzimeve të qeverisjes është përkeqësuar.

Prospektet për zhvillim dhe punësim varen në masë të madhe nga mjedisi i biznesit të sektorit të brendshëm privat. Për ta mbështetur këtë, duhet lehtësuar edhe më procedurat e licencimit, duke pasur parasysh nxitjen e marrëdhënieve të prapambetura ndërmjet firmave vendase dhe të huaja, duhet përsheptuar procedurat e daljes nga tregu dhe në përgjithësi të sigurohet një fushë aktive për të gjitha kompanitë gjatë zbatimit të rregulloreve të bizneseve. Qasja në financa duhet përmirësuar, përfshirë rregullimin e kanalit të huadhënieve bankare. Duhet bërë një harmonizim i aftësive të punëtorëve dhe kërkesave të punës nëpërmjet reformave dhe sistemit arsimor, përfshirë dhe zbatimin e strategjisë së aftësimit profesional. Sa i përket financave publike, përkeqësimi i disiplinës fiskale në vitin 2013 dhe 2014 kërkon përmirësim të procedurave të planifikimit buxhetor dhe një përputhje më të mirë të ekzekutimit buxhetor vjetor me strategjinë fiskale afat-mesme. Cilësia e shpenzimeve publike duhet përmirësuar duke zhvendosur përbërjen e shpenzimeve kapitale drejt investimeve të rritjes.

Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë ka bërë progres të mëtejshëm në përmirësimin e **aftësive për të marrë përsipër obligimet e anëtarësimit**. Shteti vazhdon përfshirjen e tij në Procesin e Stabilizim Asociimit dhe në përmbushjen e zotimeve nën Marrëveshjen Stabilizim-Asocim.

Ky shtet ka një bashkëpunim të gjerë me BE-në nëpër të gjitha fushat e *acquis*-it dhe ndodhet në nivel të avancuar të përafrimit të legjislacionit, qoftë në nivel strategjik apo në atë institucional. Niveli i përafrimit të këtij shteti është i mjaftueshëm për të kaluar në fazën tjetër të procesit të anëtarësimit. Tani fokusi duhet të vihet në kapacitetet administrative dhe në zbatimin efikas.

Në fushën e tregut të brendshëm, është arritur një nivel i mirë i përafrimit të legjislacionit për lëvizjet e kapitalit, shërbimet postare dhe ligjit mbi kompanitë. Në fushën e gjyqësisë dhe punëve të brendshme, ish Republika Jugosllave e Maqedonisë ka bërë një përparim të dukshëm në përgatitjen e politikave të vizave, kufijve të jashtëm dhe Schengenit, si dhe bashkëpunimit policor. Në anën tjetër, nevojiten përpjekje shtesë për politikën regjionale, mjedisore dhe ndryshimet klimatike, politikën sociale dhe arsim. Kontrolli publik financiar i brendshëm duhet të fuqizohet edhe më tej dhe të zhvillohet përgjatë administratës publike.

Këshilli ende nuk ka vendosur rreth propozimit të vitit 2009 nga Komisioni mbi kalimin në fazën e dytë të Asociimit, sipas nenit 5 të Marrëveshjes të Stabilizim-Asociimit.

### **Shqipëria**

Shqipëria ka bërë progres drejt përmbushjes së **kritereve politike**. Ka filluar dialogu i nivelit të lartë mbi Prioritetet Kryesore dhe janë themeluar grupet e përbashkëta punuese për strukturimin e punës mbi reformat e kërkuara. Pritet të themelohet Këshilli Kombëtar për Integrim Evropian për ta promovuar gjithëpërfshirjen dhe për bashkimin e të gjitha palëve të interesit rreth procesit të reformës. Dialogu konstruktiv dhe i qëndrueshëm politik mes qeverisë dhe opozitës është jetik për qëndrueshmërinë e reformave.

Parlamenti ka miratuar njëzëri Rezolutën për Integrim Evropian. Ka nënshkruar gjithashtu një numër të masave legjislative që janë relevante për integrim në BE, kryesisht në fushat e luftimit të korrupsionit dhe krimit të organizuar dhe ka emëruar përmes votimit zyrtarët e gjyqësorit. Transparenca e procedurave legjislative është përmirësuar. Megjithatë, klima e tensionuar politike ka cenuar punimet parlamentare dhe ka bërë që opozita jo rrallë t'i bojkotojë ato. Qeveria duhet të siguroj që opozita të ketë mundësi ta kryej në tërësi funksionin e saj të



kontrollit demokratik. Në të njëjtën kohë, opozita duhet të angazhohet në mënyrë konstruktive në proceset demokratike.

Reforma e administratës publike ka shënuar përparim, duke spikatur këtu ardhjen në fuqi të Ligjit mbi Shërbimet Civile, miratimin e zbatimit relevant të legjislacionit dhe hapat drejt përmirësimit të procedurave të rekrutimit. Zbatimi duhet ndjekur me qëllim të fuqizimit të depolitizimit, llogaridhënies dhe standardeve të administratës publike. Kodi i Procedurave Administrative duhet të finalizohet dhe të miratohet në përputhje me standardet e BE-së. Duhet ndërmarrë gjithashtu hapa për ta përforcuar pavarësinë dhe performancën e institucioneve të pavarura.

Shqipëria ka ndërmarrë hapa të mëtutjeshëm drejt reformës gjyqësore duke u angazhuar me Komisionin e Venecias në ngritjen e pavarësisë, llogaridhënies dhe profesionalizimit të sistemit gjyqësor dhe fillimin e hartimit të strategjisë së reformës gjyqësore 2014-2020. Janë bërë disa hapa në përmirësimin e llogaridhënies dhe transparencës së gjyqësorit nëpërmjet ndryshimeve legjislative që rregullojnë imunitetin e gjyqtarëve dhe prokurorëve. Procedurat disiplinore kundër gjykatësve kanë rezultuar në një numër sanksionimesh. Gjykatat administrative kanë filluar të funksionojnë, ndonëse ende kanë nevojë të bëhen plotësisht funksionale. Janë futur ndryshimet në Ligjin mbi Këshillin e Lartë të Drejtësisë me qëllim të përmirësimit të funksionimit të tij. Megjithatë, janë shprehur shqetësime rreth shpejtësisë së të aprovuarit pa përfshirjen dhe konsultimin e të gjithë akterëve relevant. Kanë mbetur edhe shumë mangësi ndërsa dhe ka një vetëdije se reformat e thella të sistemit gjyqësor nevojiten urgjentisht. Duhet bërë gjithashtu përpjekje të qëndrueshme për të siguruar pavarësinë, efikasitetin dhe llogaridhënien e gjyqësorit, duke përfshirë edhe ndryshimet kushtetuese. Shqipëria duhet që në mënyrë rigorozë ta ndjek këtë proces me një bashkëpunim konstruktiv të të gjitha palëve të interesit, përfshirë dhe bashkëpunimin e vazhdueshëm me Komisionin e Venecias. Veprimet e paluhatshme duhet të përforcojnë sistemet disiplinore për gjykatësit, prokurorët dhe avokatët, dhe ta përmirësojnë efikasitetin e gjykatave.

Qeveria ka treguar vullnet politik për të vepruar vendosmërisht në parandalimin dhe luftimin e korrupsionit. Korniza legjislative është fuqizuar kurse politikat e bashkëpunimit dhe monitorimit në nivel qendror kanë shënuar përmirësime. Koordinatorin Kombëtar të Anti-Korrupsionit është emëruar kurse rrjeti i pikave qendrore të anti-korrupsionit është formuar në të gjitha ministrinë. Megjithatë, korrupsioni është i pranishëm në shumë fusha, përfshirë forcat e rendit dhe gjyqësorin, dhe mbetet akoma një shqetësim serioz. Shqipëria duhet të ndërmarrë masa për ta vënë kornizën legjislative dhe ta miratojë strategjinë anti-korrupsion 2014-20 si dhe planet e veprimit. Bashkëpunimi ndër-institucional duhet avancuar kurse pengesat ekzistuese ndaj hetimeve proaktive duhet eliminuar. Shqipëria duhet gjithashtu të zhvillojë më tej regjistrat e hetimeve, ndjekjeve penale dhe dënimeve për rastet e korrupsionit, veçanërisht në nivel të lartë.

Lufta kundër krimit të organizuar ka treguar një trend pozitiv në shumë fusha, me intensifikimin e aktiviteteve të forcave të rendit, përfshirë këtu konfiskimin e drogave dhe luftën kundër krimeve që ndërlidhen me drogat, krimet ekonomike dhe trafikimin e qenieve njerëzore. Në veçanti, autoritetet kanë ndërmarrë hapa të duhur për ta luftuar mbjelljen dhe trafikimin e kanabisit, i cili mbetet një shqetësim serioz, këtu duhet veçuar operacionin në fshatin Lazarat dhe në veri të vendit. Bashkëpunimi ndërkombëtar është forcuar. Duhet intensifikuar gjithashtu hapat në luftën kundër krimit të organizuar. Bashkëpunimi mes institucioneve të forcave të rendit duhet të përmirësohet edhe më tej kurse barrierat legjislative që ndikojnë në efikasitetin e hetimeve duhet hequr. Shqipërisë i duhen përpjekje të qëndrueshme, të kombinuara me hetime sistematike dhe proaktive financiare dhe përforcim të qëndrueshëm të legjislacionit për t'iu kundërvënë të gjitha aktiviteteve kriminale, përfshirë shpëlarjen e parave, trafikimin e qenieve njerëzore dhe drogave. Shqipëria duhet vazhduar së vepruari vendosmërisht kundër kultivimit të kanabisit. Luftimi i krimit të organizuar dhe korrupsionit është themel i kundërvënies ndaj infiltrimit kriminal të sistemeve politike, ligjore dhe ekonomike.

Kurse të drejtat themelore, liria e tubimeve dhe themelimit të shoqatave si dhe liria e mendimit, vetëdijes dhe religjionit, janë respektuar në përgjithësi. Bashkëpunimi mes autoriteteve shtetërore dhe organizatave të shoqërisë civile përkitazi me të drejtat e komunitetit lezbian, homoseksual, biseksual, transgjinnor dhe interseksual (LGBTI) është përmirësuar. Është rishikuar korniza ligjore për personat me aftësi të kufizuara; zbatimi i saj duhet të sigurohet. Dispozitat që i përkasin diskriminimit gjinor duhet të hiqen, kapacitetet institucionale për mbrojtjen e fëmijëve duhet të fuqizohen, si dhe duhet të adresohet edhe detyrimi i fëmijëve për të punuar. Është miratuar plani i veprimit për të drejtat e fëmijëve. Shqipëria duhet të fokusohet në zbatimin e masave për rritjen e përfshirjen e romëve dhe mbrojtjen e grupeve të cënueshme. Mbrojtja e të drejtave të pronës duhet fuqizuar edhe më, duke përfshirë rishqyrtimin e strategjisë së reformës për pronën 2012 dhe të fuqizohet siguria e pronësisë ligjore.

Sa i përket lirisë së shprehjes dhe medias, qeveria ka dështuar të veprojë në prioritetet e identifikuar. Të gjitha funksionet ligjore të Autoritetit i Mediave Audiovizuale duhet të rivendoset dhe pavarësia e saj të garantohet në praktikë. Përdorimi i paautorizuar i frekuencave nga disa transmetues mbetet një problem.

Angazhimi pozitiv i Shqipërisë në bashkëpunimin rajonal dhe marrëdhëniet e mira fqinjësore mbeten thelbësore.

Sa i përket **kritereve ekonomike**, Shqipëria ka bërë disa përparime drejt shndërrimit në një ekonomi funksionale të tregut. Shqipëria duhet të jetë në gjendje të përballet me presionet konkurruese dhe forcat e tregut brenda Bashkimit Evropian në një afat të mesëm, me kusht që të përshpejtoj më tej reformat strukturore.

Shqipëria ka ruajtur stabilitetin makroekonomik, dhe ka vazhduar me shlyerjen e borxheve dhe ka ndërmarrë disa hapa për të përmirësuar administrimin dhe vjeljen e taksave. Megjithatë, rritja ekonomike u ngadalësua më tej dhe deficiti i llogarisë së tashme mbetet i lartë, gjë që reflekton konkurrencën e dobët. Deficiti buxhetor ka tejkaluar objektivin e vitit 2013 dhe niveli i lartë i borxhit publik është rritur duke kufizuar më tej hapësirën fiskale për manovrim. Inflacioni ka mbetur i ulët, që mundëson vazhdimin e lehtësimit monetar, por kjo nuk u shndërrua në rritje të kredive për shkak të nivelit të lartë të kredive jo-performuese në bankat komerciale. Papunësia është e lartë dhe ekonomia informale mbetet e përhapur.

Shqipëria duhet të vazhdojë përpjekjet e konsolidimit fiskal me qëllim të reduktimit të borxhit publik, duke ruajtur në të njëjtën kohë hapësirë për shpenzime të përshtatshme. Sektori i energjisë duhet të reformohet dhe reformat e pensioneve dhe të administratës tatimore duhet zbatuar më tej për të ulur rrezikun që paraqet për financat publike. Huadhënia bankare dhe rritja e kreditimit kanë nevojë të mbështeten nga pagesa e vazhdueshme e borxheve të shtetit ndaj kompanive duke adresuar kreditë jo-performuese. Pengesat për zhvillimin e sektorit privat duhet të hiqen duke përmirësuar mjedisin e biznesit, i cili karakterizohet nga mangësitë në sundimin e ligjit, dobësitë në kuadrin rregullativ dhe pasigurinë rreth pronësisë së pronës. Krijimi i kushteve të favorshme për investimet private, dhe në veçanti investimet e huaja direkte, është thelbësor për të diversifikuar bazën e ngushtë të prodhimit. Arsimimi dhe aftësimi duhet të përmirësohen edhe më tej për të adresuar aftësitë që nuk përkojnë me tregun e punës dhe rritjen e punësimit.

Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit (MSA), e cila ka hyr në fuqi në prill të vitit 2009, ka vazhduar të zbatohet në përgjithësi pa probleme. Shqipëria vazhdoi përafrimin e legjislacionit të saj me kërkesat e BE-së në një numër fushash, duke rritur **aftësinë e saj për të marrë përsipër obligimet e anëtarësimit**. Është miratuar Plani i ri Kombëtar për Integrim Evropian 2014-2020. Megjithatë, përmirësimet konkrete kanë qenë të moderuara në shumicën e fushave. Shqipëria do të duhet të bëjë përpjekje të konsiderueshme për të përmirësuar përgatitjet e saja për zbatimin e *acquis*-it të BE-së. Më shumë përpjekje janë të nevojshme për të siguruar mbrojtjen e të drejtave të pronësisë intelektuale. Zgjidhja e mosmarrëveshjes në mes të qeverisë dhe kompanisë së distribuimit të energjisë CEZ ka kontribuar në hapjen e rrugës për reformat e mëtejme në sektorin e energjisë. Intensifikimi i përpjekjeve në këtë fushë, përfshirë edhe diversifikimin e burimeve të energjisë dhe funksionimin e tregut të energjisë elektrike, është me

rëndësi jetike për zhvillimin ekonomik. Shqipëria do të duhet të forcojë mbrojtjen e mjedisit, si dhe adresimin e mangësive të vëna re në fushat e transportit, sigurisë ushqimore, si dhe mbrojtjen e konsumatorit dhe shëndetit. Duhet forcuar kapaciteti administrativ dhe standardet profesionale të organeve të ngarkuara me zbatimin e *acquis*-it dhe të mbrohet pavarësia e organeve rregullatore. Rritja e transparencës dhe llogaridhënies, për sa i përket, në veçanti, prokurimit publik dhe menaxhimit të financave publike, mbetet thelbësore.

### **Bosnja dhe Hercegovina**

Vendi përsëri ka shënuar progres të kufizuar në adresimin e **kritereve politike**. Nuk ka pasur progres të dukshëm në krijimin e institucioneve funksionale dhe të qëndrueshme. Gjithashtu, Asambleja Parlamentare e Bosnje dhe Hercegovinës ka bërë progres tejet të kufizuar në miratimin e legjislacionit të lidhur me BE-në. Mosmarrëveshjet përgjatë linjave politike dhe etnike kanë pasur një efekt të madh negativ mbi punën e kuvendeve në nivel shtetëror dhe në Federatë.

Bashkëpunimi me shoqërinë civile në nivel shtetëror, të entiteteve dhe nivel kantonal mbetet i dobët. Siç tregohet në protestat sociale në fillim të vitit 2014, të gjitha qeveritë duhet, për shkak të prioritetit, të përqendrohen në adresimin e nevojave socio-ekonomike të qytetarëve, në veçanti në luftimin e papunësisë shumë të lartë tek të rinjtë dhe t'u ndihmoj atyre që kanë nevojë pas përmbajtjeve të mëdha në muajin maj.

Duke pasur parasysh klimën politike, është arritur një progres shumë i kufizuar në reformimin e administratës publike dhe përmirësimin e kapaciteteve të saja për të përmbushur kërkesat e integritetit në BE. Fragmentarizmi i kornizës ligjore administrative në nivele të ndryshme të qeverisjes mbetet një shqetësim serioz, pasi ajo ndikon shumë në funksionalitetin e sistemit të shërbimeve publike. Duhet zhvilluar një strategji të re për reforma të administratës publike pas vitit 2014. Reformat e nevojshme në menaxhimin e financave publike duhet të adresohen në mënyrë gjithëpërfshirëse.

Fusha e reformës së sistemit gjyqësor ka shënuar pak përparim. Dialogu i strukturuar për drejtësi mbetet një platformë e rëndësishme për të arritur një konsensus mbi reformat gjyqësore dhe është zgjeruar më tej tek çështjet tjera të sundimit të ligjit. Reforma e gjyqësorit në nivel shtetëror duhet të kryhet si një çështje prioritare. Mungesa e burimeve njerëzore në të gjitha nivelet për të trajtuar ngarkesën e rasteve të krimeve të luftës ka qenë pjesërisht e adresuar, por qëndrueshmëria duhet ende të sigurohet me planifikimin e duhur dhe alokimet përkatëse nga organet kompetente vendase. Gjyqësori kërkon përforsim të mëtejshëm të mjeteve disiplinore dhe rregullave adekuate të konfliktit të interesit.

Ka pasur pak progres në avancimin e reformave për të zvogëluar korrupsionin, i cili vazhdon të ndikojë në të gjithë sektorin publik dhe mbetet më akute në fushën e ofrimit të shërbimeve dhe qasjes në punësim. Rrjetet politike të patronazhit janë të përhapura dhe ndikojnë në të gjitha nivelet e qeverisjes. Hetimi dhe ndjekja penale në rastet e profilit të lartë mbeten të pamjaftueshme dhe niveli i përgjithshëm i hetimeve efikase, ndjekjes penale dhe dënimeve është i ulët. Ka fare pak vullnet politik për të lëvizur përtej retorikës dhe të goditet korrupsioni, përfshirë hetimet dhe dënimet në rastet e profilit të lartë. Nuk ka pasur në përgjithësi përparim në luftimin e krimit të organizuar, i cili mbetet një shqetësim serioz, pavarësisht disa operacioneve të suksesshme të përbashkëta, duke përfshirë koordinim të ngushtë me shtetet fqinje. Luftimi i krimit të organizuar dhe korrupsionit është thelbësor për luftën kundër infiltrimit kriminal të sistemeve politike, juridike dhe ekonomike.

Është vendosur korniza ligjore dhe institucionale për respektimin e të drejtave të njeriut dhe elementet kryesore të ligjeve ndërkombëtare për të drejtat e njeriut kanë qenë të përfshira në sistemin juridik. Megjithatë, rritja e presionit politik dhe financiar në media dhe kërcënimet ndaj gazetarëve dhe redaktorëve mbeten shqetësim serioz. Nevojiten më shumë përpjekje për t'i bërë shkollat më përfshirëse dhe për të adresuar ekzistimin e vazhdueshëm të "dy shkollave nën një çati" në Federatë. Duhet siguruar parandalimin efikas dhe hetimin e rasteve të gjuhës së urrejtjes, dhunës dhe diskriminimit ndaj komunitetit lezbian, homoseksual, biseksual,

transgjinatorë dhe interseksual (LGBTI). Ndërsa është bërë një progres shumë i mirë në adresimin e nevojave të strehimit të romëve, përpjekjet në fushat e arsimit, shëndetësisë, kurse nevoja e punësimit duhet të forcohet edhe më. Sa i përket refugjatëve dhe personave të zhvendosur brenda vendit, duhet të sigurohet zbatimi efikas i strategjisë së rishikuar, në veçanti aspektet e saja socio-ekonomike. Bosnja dhe Hercegovina ka vazhduar të marrë pjesë aktivisht në bashkëpunimin rajonal, duke ruajtur marrëdhëniet e mira fqinjësore.

Sa i përket **kritereve ekonomike**, Bosnja dhe Hercegovina ka bërë pak përparim drejt shndërrimit në një ekonomi funksionale të tregut. Hapa të konsiderueshëm do të jenë të nevojshëm për të trajtuar dobësitë e vazhdueshme strukturore për të qenë në gjendje për t'i bërë ballë presioneve konkurruese dhe forcave të tregut brenda Bashkimit Evropian për një afat të gjatë.

Rritja ekonomike ka vazhduar në mënyrë modeste kurse deficitit i llogarisë së tashme është ngushtuar mu në kohën e disbalancimeve të vazhdueshme të jashtme. Rimëkëmbja mbetet e brishtë për shkak të kërkesës së brendshme të dobët dhe një baze të ngushtë të prodhimit. Përmbytjet e mëdha në pranverë pritet të përkeqësojnë situatën ekonomike dhe fiskale afatshkurte. Janë bërë përpjekje për të përmirësuar koordinimin fiskal në Federatë, si dhe vjeljen e taksave indirekte.

Bosnja dhe Hercegovina duhet të ndjek masat e mëtejshme urgjente për të ruajtur disiplinën fiskale. Përveç kësaj, janë të nevojshme përpjekjet për ta adresuar praninë e rëndësishme shtetërore në ekonomi, për të reduktuar nivelin dhe për të përmirësuar përbërjen dhe shpenzimet e targetuara publike. Për më tepër, mos-efikasiteti i ndërmarrjeve publike duhet të trajtohet në mënyrë adekuate. Koordinimi më i mirë mes dhe brenda subjekteve do ta lehtësonte dukshëm dhe do ta përmirësonte hartimin e politikave ekonomike. Pabarazitë e larta të tregut të punës, siç pasqyrohen nga papunësia vazhdimisht e lartë, sidomos në mesin e të rinjve, si dhe shkalla shumë e ulët e pjesëmarrjes, kërkon hapa vendimtar në heqjen e pengesave për të punuar dhe për të përmirësuar cilësinë e arsimit. Mangësitë në mjedisin ligjor dhe të biznesit, sidomos zbatimi i gjatë i kontratës dhe procedurat e kushtueshme dhe komplekse të hyrjes dhe daljes së biznesit si dhe infrastruktura e pazhvilluar duhet të adresohen për të mbështetur zhvillimin e sektorit privat dhe tërheqjen e investimeve, sidomos investimet e huaja. Në këtë kontekst, sektori joformal mbetet një sfidë e rëndësishme. Përveç kësaj, duhet të adresuar edhe nivelin e lartë të kredive joperformuese .

Ngjashëm me vitin e kaluar, mungesa e mbështetjes së vërtetë politike për agjendën e BE-së, mungesa e një mekanizmi funksional të koordinimit për çështjet e BE-së dhe mosmarrëveshjet e brendshme rreth kompetencave kanë rezultuar në progres të kufizuar sa i përket **përafrimit me ligjet dhe standardet e BE-së**. Kjo ka të bëjë në veçanti me zonat e lëvizjes së personave dhe të fuqisë punëtore, me lirinë për të ofruar shërbime dhe të drejtën e themelimit, lëvizjen e lirë të mallrave, mbrojtjen e konsumatorit, punësimit dhe politikave sociale, arsimin, kulturën dhe hulumtimet, zonën e industrisë dhe NVM-ve, fushat e mjedisit dhe të klimës, si dhe atë të transportit. Në një numër të fushave progresi i mëtejshëm pengohet nga mungesa e strategjive në mbarë vendin.

Ka pasur pak progres në fushën e bujqësisë dhe të zhvillimit rural, sigurisë ushqimore, veterinarisë, fitosanitarisë dhe peshkimit. Mungesa e përafrimit me kërkesat e BE-së në këtë fushë vazhdon të parandalojë eksportet e mallrave me origjinë shtazore në BE, një situatë për keqardhje që kërkon përpjekje serioze dhe të koordinuara mirë për t'u tejkaluar. Në fushën e tatimeve, Bosnja dhe Hercegovina ka miratuar një skemë tatimore të vogël të birrarisë e që nuk është në përputhje me detyrimet e dala sipas Marrëveshjes së Përkohshme përderisa ajo diskriminon importet e birrës. Nuk është arritur shumë progres në sektorin e energjisë për shkak të kompleksitetit të strukturës administrative, kontesteve rreth kompetencave ndërmjet nivelit shtetëror dhe subjekteve dhe mungesës së vullnetit politik. Kjo, ndër të tjera, ka çuar në një shkelje të rëndë dhe të vazhdueshme të detyrimeve të vendit sipas Traktatit të Komunitetit të Energjisë në fushën e gazit, të cilat duhet të adresohen urgjentisht. Mund të raportohet progres, *ndër të tjera*, në fushën e tregut të brendshëm me miratimin e ligjit për prokurimin

publik, i cili i mundëson vendit të harmonizohet me Direktivat e BE-së të vitit 2004. Bashkëpunimi ndërmjet organeve statistikore në nivel entiteti dhe në atë shtetëror është përmirësuar, veçanërisht në kontekstin regjistrimit të popullsisë dhe banimeve.

### Kosova

Sa i përket **kriteret politike**, vitin e kaluar, agjenda politike të Kosovës shënoi mbajtjen e zgjedhjeve lokale dhe të përgjithshme, si dhe pasojat e tyre. Zgjedhjet e përgjithshme të qershorit ishin transparente dhe të organizuara mirë. Dita e zgjedhjeve kaloi pa ndonjë incident të madh dhe votuesit i hodhën votat e tyre lirshëm në tërë Kosovën, duke përfshirë këtë edhe në katër komunat veriore. Zgjedhjet e konsoliduan progresin e arritur në zgjedhjet lokale në fund të vitit 2013. Në të dyja rastet, procesi zgjedhor është përmirësuar. Ka pasur më pak raste të mashtrimit se në zgjedhjet e vitit 2010, dhe se ato raste ishin trajtuar në mënyrë efikase. Një numër i konsiderueshëm i rasteve të vitit 2010 janë ende në pritje në gjykata. Kosova ka ende nevojë të adresojë rekomandimet e misioneve dhe ekspertëve vëzhgues të zgjedhjeve. Këto përfshijnë miratimin e një kodi gjithëpërfshirës zgjedhor dhe rritjen e saktësisë së listave të votuesve. Reforma zgjedhore ka nevojë të sigurojë që korniza ligjore për zgjedhjet pasqyron praktikën më të mirë në BE. Anëtarësimi i fundit i Kosovës në Komisionin e Venecias mund të ndihmoj në këtë drejtim.

Dështimi në formimin e legjislaturës së re pa ndonjë problem dhe në kohën e duhur ka qenë një pengesë. Qeveria e re dhe Kuvendi do të duhej ta ri-aktivizojnë agjendën reformuese të Kosovës. Të dyja institucionet kanë nevojë të ndërtohen në koncenzusin ekzistues politik në Kosovë për integrim në BE. Qeveria e Kosovës ka demonstruar kapacitetin e saj për të koordinuar agjendën e saj të integritimit në BE, në veçanti në lidhje me negociatat e MSA-së. Duke u bazuar në ekspertizën nëpër departamente dhe institucione të ndryshme, negociatorët e Kosovës kanë bërë përpjekje të konsiderueshme në shqyrtimin e tekstit të propozuar dhe në analizimin e ndikimit të tij të mundshëm. Kjo pasqyron një zotërim të mirë të ndikimit të angazhimeve të bëra.

Për të zbatuar dhe për t'i përmbushur detyrimet sipas MSA-së në të ardhmen, ekzekutivi i Kosovës dhe Kuvendi duhet të përqendrohen në zbatimin e legjislativës dhe të politikave. Planet legjislativë dhe politike duhet realisht të reflektojnë resurset e nevojshme. Legjislativa e re ofron një mundësi të mirë për të përmirësuar mbikëqyrjen e procesit legjislativ dhe ekzekutiv. Roli i Kuvendit në mbikëqyrjen e institucioneve të pavarura dhe autoriteteve rregullatore duhet të forcohet. Pavarësia e këtyre organeve duhet mbështetur dhe emërimet për këto organe duhet të vazhdojnë pa vonesë dhe do të bazohen në një proces të drejtë dhe të depolitizuar të përzgjedhjes me kriterë objektive.

Ka vazhduar bashkëpunimi i mirë me misionin e BE-së për sundimin e ligjit, EULEX. Autoritetet e Kosovës kanë bërë një angazhim të konsiderueshëm politik për zgjatjen e mandatit të misionit dhe kanë rënë dakord për të krijuar një gjykatë të specializuar për të gjykuar rezultatet e Task Forcës Speciale për Hetime. Për të përfunduar këtë proces, Kosova duhet të miratojë ndryshimet e nevojshme legjislativë, duke përfshirë edhe të kushtetutës së saj. Autoritetet gjyqësore janë përballuar mirë edhe me sfidat strukturore të tilla si reforma e përgjithshme gjyqësore e miratuar në vitin 2013 dhe me procesin e transferimit të disa funksioneve të EULEX-it tek autoritetet vendore. Dialogu i strukturuar për Sundimin e Ligjit ka vazhduar mbështetjen e këtij procesi. Grumbullimi i rasteve dhe sigurimi i drejtësisë së paanshme, të pavarur mbetet një sfidë. Autoritetet gjyqësore të Kosovës duhet që në mënyrë proaktive t'i hulumtojnë paditë në bazë të dëshmive të pranueshme, dhe të lëshojnë aktgjykime të arsyetuara mirë dhe në kohë, pavarësisht opinioneve mbizotëruese publike apo politik.

Në lidhje me luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, numri i hetimeve të krimeve të lidhura me drogën është rritur dhe disa grupe të trafikut me qenie njerëzore janë shpërbërë. Megjithatë, me një numër të ulët të dënimeve aktuale dhe konfiskimet e drogës, Kosova është në një fazë të hershme në luftën e saj kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit. Agjencitë e zbatimit të ligjit hezitojnë të iniciojnë hetime financiare dhe numri i rasteve të ngrirjes dhe konfiskimit të pasurisë, të urdhëruara nga gjyqësori dhe të ekzekutuara nga policia, vazhdon të jetë i ulët. Frikësimi i dëshmitarëve ende është një shqetësim i madh. Qeveria e re dhe kuvendi duhet të tregojnë zero tolerancë ndaj korrupsionit dhe krimit të organizuar dhe një vullnet të qartë politik për luftë efikase kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar. Klasa politike e Kosovës duhet të tregojë gatishmërinë e saj për të pranuar rezultatin e proceseve të pavarura gjyqësore. Luftimi i krimit të organizuar dhe korrupsionit është thelbësor për luftën kundër infiltrimit kriminal të sistemeve politike, juridike dhe ekonomike.

Zbatimi i strategjisë (2010-13) dhe planit të veprimit (2012-14) për reformën e administratës publike ka qenë një sfidë e madhe për Kosovën, duke dhënë rezultate shumë të kufizuara. E përkrahur nga një angazhim serioz politik, Kosova duhet të krijojë një kuadër realist strategjik për hartimin e politikave, planifikimin legjislativ dhe zbatimin praktik të reformave. Kompletimi i kornizës legjislative për shërbimin civil, duke siguruar se është e depolitizuar dhe kryerja e vlerësimeve të performancës të shërbimit civil janë prioritet. Kosova gjithashtu duhet të miratojë një ligj mbi procedurat e përgjithshme administrative, të cilat janë vendimtare për zhvillimin e një mjedisi miqësor për biznesin. Ndërsa, janë hartuar disa rregulla dhe rregullore të menaxhimit të financave publike, Kosova duhet të sigurojë një qasje më gjithëpërfshirëse për reformat në këtë fushë. Kosova duhet të sigurojë zbatimin e tyre si dhe të përmirësojë përputhshmërinë me raportet e Auditorit të Përgjithshëm.

Të drejtat themelore dhe të njeriut vazhdojnë të jenë gjerësisht të garantuara me ligj në Kosovë. Komisioni i Pavarur për Media është përsëri funksional. Autorët e dhunës ndaj revistës 2.0 të Kosovës kanë marrë dënim me kusht. Kërcënimet dhe sulmet ndaj aktivistëve të komunitetit lezbian, homoseksual, biseksual, transgjitorë dhe interseksual (LGBTI) dhe ndaj gazetarëve kanë vazhduar, gjë që mbetet një shqetësim serioz. Kushtet për lirinë e shprehjes dhe të medias duhet të vendosen. Të drejtat pronësore duhet të zbatohen në mënyrë efikase, duke përfshirë qasjen e grave në pronën e trashëguar. Kosova ka ende nevojë të përmirësojë sistemin e saj institucional që ka të bëjë me mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Përgjegjësitë përkatëse nuk janë të qarta, gjë që pengon zbatimin e legjislacionit dhe monitorimin.

Disa familjeve të zhvendosur brenda vendit nga komuniteti Romë, me banim në një kamp në Mal të Zi, i'u janë ndarë parcela toke. Ndërtesa kryesore e kampit të Romëve në Leposaviq është mbyllur. Këshilli për Zbatim dhe Monitorim ka lehtësuar mbrojtjen e përmirësuar të trashëgimisë kulturore dhe fetare. Megjithatë, Kosova ka nevojë të shtoj përpjekjet e saj për të siguruar zbatimin e legjislacionit dhe të kornizave të politikave, duke përfshirë planin e veprimit për integrimin e komuniteteve Romë, Ashkali dhe Egjiptas. Incidentet e sigurisë dhe krimet me synim ndaj personave që u përkasin pakicave si dhe pronës së tyre duhet të hetohen dhe të ndiqen penalisht menjëherë dhe plotësisht. Duhet të zbatohen ligjet për qendrën historike të Prizrenit dhe në Hoçën e Madhe. Ligji për Hoçën e Madhe është një shqetësim i veçantë pasi që nuk është bërë asnjë përparim në zbatimin e tij, pavarësisht një vendimi komunal në shkurt të vitit 2013 për ta quar përpara dhe pavarësisht dispozitës së udhëzimeve administrative nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor. Për të parandaluar ndërtime të paligjshme si dhe rrënimin e vendeve të trashëgimisë kulturore, është i nevojshëm një veprim i fuqishëm.

Në bashkëpunimin rajonal, Kosova ka bërë përparim të mëtejshëm, dhe ka nënshkruar marrëveshje të mëtejshme të bashkëpunimit bilateral me disa nga fqinjët e saj.

Sa i përket **normalizimit të marrëdhënieve me Serbinë**, Kosova ka mbetur e angazhuar në dialog dhe në përgjithësi e angazhuar për zbatimin marrëveshjes së parë të prillit të vitit 2013 mbi parimet që rregullojnë normalizimin e marrëdhënieve dhe marrëveshjeve të tjera të arritura në dialog. Kjo ka çuar në një numër të ndryshimeve të pakthyeshme në terren, me zgjedhjet lokale dhe parlamentare të mbajtura në tërë Kosovën për herë të parë dhe demilitarizimin e policisë Serbe dhe strukturave të drejtësisë të avancuara ndjeshëm. U miratua një zgjidhje e përhershme për përfshirjen e Kosovës në Procesin e Bashkëpunimit të Evropës Jug-Lindore (SEECP). Ndërsa, nuk ka pasur takime të nivelit të lartë që prej zgjedhjeve të parakohshme që u mbajtën në Kosovë, puna ka vazhduar në nivel teknik, duke çuar ka progresi në fushat e grumbullimit doganor, MIK, energjisë dhe telekomit.

Megjithatë, progresi në zbatimin e dialogut në përgjithësi është ngadalësuar. Zgjedhjet e parakohshme të përgjithshme janë mbajtur në të dy vendet, në Serbi dhe Kosovë. Është e rëndësishme që dialogu i nivelit të lartë të rifillojë. Gjithashtu është e rëndësishme që të dy palët të vazhdojnë të angazhohen plotësisht në zbatimin me mirëbesim të të gjitha marrëveshjeve ekzistuese. Progresi i mëtejshëm duhet gradualisht të çojë në normalizimin e plotë të marrëdhënieve midis Serbisë dhe Kosovës, në formë të një marrëveshje ligjërish të detyrueshme deri në fund të negociatave për anëtarësim të Serbisë, me perspektivën e të dyja vendeve, në mënyrë që të jenë në gjendje të ushtrojnë plotësisht të drejtat dhe të përmbushin përgjegjësitë e tyre.

Sa i përket **kritereve ekonomike**, Kosova ka bërë progres të kufizuar në rrugën e saj për t'u bërë një ekonomi funksionale e tregut. Duhet të bëhen përpjekje të konsiderueshme për të trajtuar dobësitë strukturore për të përballuar presionet konkurruese dhe forcat e tregut brenda Bashkimit Evropian për një afat të gjatë.

Rritja ekonomike ka mbetur pozitive në 3.4%, por nuk është bërë ndonjë përmirësim në kushtet e tregut të punës. Vazhdojnë disbalancimet e larta të jashtme, përkundër disa ngushtimeve të deficitit tregtar. Stabiliteti makroekonomik u ruajt gjerësisht përkundër rritjeve të konsiderueshme parazgjedhore *ad hoc* në shpenzimet aktuale, në veçanti për pagat dhe pensionet. Një praktikë e tillë e shkatërron transparencën, parashikueshmërinë dhe kredibilitetin e politikës fiskale, e komplikon planifikimin fiskal dhe i drejton shpenzimet drejt shpenzimeve më pak përkrahëse të zhvillimit.

Forcimi i planifikimit fiskal dhe zbatimi me efikasitet i rregullit fiskal është me rëndësi jetike. Për më tepër, vendimet për projekte të mëdha infrastrukturore, si në sektorin e transportit, duhet të bazohen në vlerësimet e duhura të kosto-përfitimit për të maksimizuar përfitimet ekonomike. Në pikëpamje të papunësisë së vazhdueshme dhe shumë të lartë, përpjekjet duhet të ndërmerren për të lehtësuar zhvillimin e sektorit privat nëpërmjet përmirësimeve në mjedisin e biznesit. Për këtë qëllim, pengesat që dalin nga kapacitetet e dobëta administrative, qasjeve të vështirë në financa dhe procedurave të gjata dhe komplekse të privatizimit duhet të adresohen shpejt. Kosova duhet të sigurojë një sistem ligjor dhe gjyqësor i cili funksionon siç duhet, për të rritur zbatimin e kontratave dhe të zvogëlojë në mënyrë efikase vonesat në gjykata. Statistikat ekonomike duhet të përmirësohen.

Lidhur me **përafrimin me ligjet dhe standardet e BE-së**, institucionet e Kosovës kanë demonstruar aftësinë e tyre për të ofruar për prioritetet politike, siç janë negociatat e MSA-së, dialogu për liberalizimin e vizave dhe dialogu me Serbinë. Ky ishte rezultat i angazhimeve të forta politike. Dhënia e rezultateve në fushat e tjera të reformave prioritare ka qenë më i pabarabartë. Korniza ligjore bazë për të lejuar lëvizjen e kapitalit mbetet në fuqi, por pengesat

për blerjet e pasurive të patundshme nga të huajt vazhdojnë. Sa i përket konkurrencës, regjistri i Kosovës është i kufizuar, dhe kjo ndodh për shkak të mbikëqyrjes shumë të dobët të praktikës anti-konkurrese dhe ndihmës shtetërore. Kosova ka nevojë të sigurojë që autoritetet e konkurrencës janë efikase dhe të pavarura. Ligji për prokurimin publik u ndryshua për të futur preferencat për prodhuesit vendor. Këto preferenca do të duhet të hiqen brenda pesë viteve nga data e hyrjes në fuqi e MSA-së.

Ka pasur një përmirësim të qëndrueshëm në furnizimin me energji elektrike të Kosovës dhe rezultati është që ndërprerjet e energjisë elektrike tani janë të rralla. Një shpërthim në termocentralin Kosova A ka theksuar brishtësinë e sistemit. Kosova duhet të përgatitet në mënyrë më aktive të çmontojë këtë termocentral. Ka pasur zhvillime të qëndrueshme në bujqësi dhe sigurinë ushqimore, pavarësisht burimeve të pakta. Transferimi i inspektorëve në agjencinë qendrore duhet të plotësohet urgjentisht. Kjo është esenciale për të zbatuar standardet e Ushqimit dhe Veterinarisë, të cilat janë të rëndësishme për tregtinë në kuadër të MSA-së. Mungesa e interesimit në mjedis është bërë një çështje serioze për shëndetin publik dhe cilësinë e jetës në Kosovë.

## **Turqia**

Sa i përket **kritereve politike**, viti u shënuar përsëri me kontraste të mprehta.

Nga njëra anë, zbatimi i reformave të miratuara në vitet e mëparshme vazhdoi. Janë miratuar dhe zbatuar disa masa nën pakot 3 dhe 4 të reformës gjyqësore, si dhe janë adaptuar dhe zbatuar masat e shpallura në pakon e demokratizimit, të paraqitura në shtator të vitit 2013. Këto masa, ndër të tjera, e kanë ulur pragun për mbështetjen e buxhetit për partitë politike, kanë lejuar zhvillimin e veprimtarisë politike në gjuhë dhe dialekte të tjera nga ajo Turke, dhe kanë siguruar arsimimin privat në gjuhë dhe dialekte të tjera përveç asaj Turke. Miratimi i Planit të Veprimit për parandalimin e shkeljeve të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ) në muajin mars, ishte një hap i rëndësishëm që synon përafrimin e kornizës ligjore Turke dhe praktikës me jurisprudencën e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ). Gjykata Kushtetuese ka vazhduar zbatimin individual të procedurave. Ajo ka nxjerrë një sërë vendimesh të rëndësishme në forcimin e mbrojtjes së të drejtave themelore në vend dhe ilustrimin e elasticitetit të sistemit kushtetues të vendit.

Në muajin qershor, parlamenti Turk miratoi një ligj për të "vendosur një bazë më të fuqishme ligjore për procesin e zgjidhjes" me qëllim të zgjidhjes së çështjes së Kurdëve. Ligji u miratua me mbështetjen e gjerë të të gjitha partive politike. Ajo përfshin masat për eliminimin e terrorizmit, forcimin e përfshirjes sociale, ri-integrimin e atyre që largohen nga Partia e Punëtorëve të Kurdistanit (PKK) dhe që dorëzojnë armët e tyre, si dhe përgatitjen e opinionit publik për kthimin e ish-luftëtarëve. Ligji forcon bazat për procesin e zgjidhjes dhe jep kontribut pozitiv për stabilitetin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut në Turqi.

Në muajin shtator, Ministria e Çështjeve të BE-së paraqiti një "Strategji të Bashkimit Evropian" me qëllim të ripërtëritjes së procesit të anëtarësimit të Turqisë. Strategjia bazohet në tri shtylla: reformat politike, transformimin socio-ekonomik në procesin e anëtarësimit dhe në strategjinë për komunikim. Ajo pritet të pasohet nga planet e veprimit me veprime dhe afate kohore konkrete.

Nga ana tjetër, reagimi i qeverisë ndaj akuzave për korrupsion që synojnë personalitete të nivelit të lartë, përfshirë anëtarët e qeverisë dhe të familjeve të tyre, ngriti shqetësime serioze lidhur me pavarësinë e gjyqësorit dhe të zbatimit të ligjit. Kjo përgjigje konsiston në veçanti në ndryshimet e Ligjit për Këshillin e Lartë të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve dhe në riangazhimet e shumta pasuese dhe shkarkimet e gjyqtarëve dhe prokurorëve, si dhe ri-



angazhimin dhe largimin nga puna, ose edhe arrestimin, e një numri të madh të oficerëve të policisë. Kjo ka ngritur shqetësime në lidhje me aftësitë operationale të gjyqësorit dhe policisë dhe ka hedhur dyshime serioze mbi aftësinë e tyre për të kryer hetimet mbi akuzat për korrupsion në një mënyrë jo-diskriminuese, transparente dhe të paanshme. Gjykata Kushtetuese gjeti antikushtetues një numër të dispozitave të Ligjit për Këshillin e Lartë të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, në vijim të të cilave parlamenti ndryshoi legjislacionin duke kthyer dispozitat e mëparshme.

Këto zhvillime gjithashtu kanë rezultuar në një polarizim në rritje brenda spektrit politik. Disa pjesë të legjislacionit të propozuar nga shumica qeverisëse, duke përfshirë çështjet themelore për demokracinë Turke, janë miratuar pa debat të duhur parlamentar apo konsultim adekuat të grupeve të interesit dhe shoqërisë civile. Procesi i përgjithshëm i vendim-marrjes, si në nivel kombëtar dhe në nivel lokal, duhet të përfshijë konsultimin më të strukturuar dhe sistematik të shoqërisë civile. Është thelbësore reformimi i mjedisit ekzistues ligjor dhe bërja e tij më favorizues për zhvillimin e organizatave të shoqërisë civile në përgjithësi.

Sa i përket lirisë së shprehjes, debat i gjerë publik ka vazhduar në tema të konsideruara më parë si të ndjeshme, duke përfshirë çështjet Kurde dhe Armene. Megjithatë, një numër i dispozitave të kornizës ligjore Turke dhe interpretimi i tyre nga anëtarët e gjyqësorit vazhdojnë të pengojnë lirinë e shprehjes, duke përfshirë lirinë e medias. Ndryshimet në Ligjin e internetit e kanë kufizuar lirinë e shprehjes në internet. Ndalimet e plota në YouTube dhe Twitter kanë ngritur shqetësime serioze. Këto ndalime janë gjetur si jo-kushtetuese nga Gjykata Kushtetuese. Zyrtarët shtetërorë vazhduan të bëjnë deklarata me efekt frikësues mbi median. Kjo, së bashku me strukturën e pronësisë së sektorit Turk të medias, ka qar në përhapjen e vetë-censurës në shtyp, si dhe në dorëheqjen dhe shkarkimin nga puna të gazetarëve.

Legjislacioni Turk lidhur me të drejtën për tubim duke u fokusuar më shumë në ligjshmërinë se sa në karakterin paqësor të demonstratës, dhe zbatimin e tij nga ana e zyrtarëve të zbatimit të ligjit, duhet të sillen në përputhje me standardet evropiane. Legjislacioni mbi themelimin e komisionit të monitorimit të zbatimit të ligjit, si një organ i pavarur mbikëqyrës për vepra të policisë duhet të miratohet.

Përkufizimi i paqartë në legjislacionin penal të anëtarësimit të një organizate të armatosur vazhdon të jetë burim i një numri të madh të arrestimeve dhe ndjekjeve penale. Një kornizë ligjore në pajtim me KNDNJ-në duhet të themelohet në çështjet e besimit dhe të kundërshtimit të ndërgjegjshëm. Për të garantuar në mënyrë efikase të drejtat e grave, fëmijëve, dhe komunitetit lezbian, homoseksual, biseksual, transgjimorë dhe interseksual (LGBTI), janë të nevojshme përpjekjet thelbësore. Dhuna në familje, vrasjet e herëpashershme për shkak të 'nderit' dhe çështja e martesave të hershme dhe të detyruara mbeten një shqetësim serioz. Turqia duhet të sigurojë respektimin e plotë të të gjitha të drejtave të pronësisë, duke përfshirë edhe ato të komuniteteve fetare jo-myslimane.

Këto mangësi duhet të adresohen dhe autoritetet duhet të shtojnë përpjekjet për të mbrojtur të drejtat dhe liritë e tjera themelore në mënyrë që të gjithë qytetarët mund të ushtrojnë të drejtat e tyre pa pengesa.

Nënshkrimi i marrëveshjes së ri-pranimit BE-Turqi, më 16 dhjetor 2013, në mënyrë paralele me fillimin e dialogut për liberalizimin e vizave ka krijuar një moment të ri për marrëdhëniet BE-Turqi. Marrëveshja për ri-pranim ka hyrë në fuqi më 1 tetor 2014, ndërsa raporti i parë mbi përparimin e Turqisë në kuadër të udhërrëfyesit për liberalizimin e vizave do të publikohet më 20 tetor 2014. Është me rëndësi që këto dy procese të ecin përpara. Zbatimi i plotë dhe efikas kundrejt të gjitha shteteve anëtare është vendimtar.

Lidhur me luftën kundër krimit të organizuar, Turqia e ka përmirësuar programin e saj për të kundërshtuar financimin e terrorizmit, duke e konsoliduar rrjetin e njërive për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe në riorganizimin e përgjegjësive në luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore. Megjithatë, ka ndodhur largim në shkallë të gjerë i oficerëve të policorë, gjë që ka ngritur shqetësim rreth ndikimit të tyre në aftësitë operative të shërbimeve kryesore policore të përfshirë në luftën kundër krimit të organizuar. Luftimi i krimit të organizuar dhe korrupsionit është qenësor për t'iu kundërvënë ndikimit të paligjshëm të grupeve kriminale në sistemet politike, juridike dhe ekonomike.

Në politikën e jashtme, Turqia ka vazhduar të luajë një rol të rëndësishëm në fqinjësinë e gjerë. Ajo ka luajtur një rol veçanërisht të rëndësishëm në Siri, duke dënuar në mënyrë të fuqishme dhe të vazhdueshme dhunën e regjimit Sirian ndaj civilëve, duke mbështetur zhvillimin e një opozite më të unifikuar dhe ofrimin e ndihmës jetike humanitare për më tepër se 1 milion Sirianë të larguar nga vendi i tyre. Ajo ka vazhduar edhe ofrimin e mbështetjes praktike për bisedimet E3 + 3 me Iranin. Themelet solide u vendosën për siguri më të madhe evropiane të energjisë me miratimin e vendimeve përfundimtare për investime për realizimin e tri projekteve të Korridorit Jugor të Gazit. Dialogu i rregullt politik ndërmjet BE-së dhe Turqisë ka vazhduar, duke mbuluar të dyja çështjet ndërkombëtare me interes të përbashkët, të tilla si Lindja e Mesme dhe Azia Qendrore, si dhe çështjet globale, të tilla si kundër-terrorizmit, luftëtarët e huaj dhe frenimin e përhapjes. Turqia ka vazhduar politikën e saj të angazhimit në Ballkanin Perëndimor, duke përfshirë pjesëmarrjen e saj aktive në Procesin e Bashkëpunimit të Evropës Jug-Lindore dhe kontributin e saj në misionet ushtarake, të policisë dhe të misioneve sundimit të ligjit, të udhëhequra nga BE-ja. Në vazhden e sfidave serioze që dalin në fqinjësinë e menjëhershme të Turqisë, dialogu me BE-në duhet të intensifikohet më tej dhe shtrirja me pozicionet e BE-së duhet të përmirësohet.

Turqia e ka mbështetur rifillimin e bisedimeve të drejta dhe të plota të zgjidhjes midis krerëve të të dy komuniteteve në Qipro, duke organizuar nën zyrat ndërmjetësuese të Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së. Turqia dhe Greqia kanë promovuar vizita të ndërsjella nga dy kryenegociatorët e Ankarasë dhe Athinës në kontekstin e negociatave në vazhdim.

Megjithatë, Turqia ka vazhduar të lëshojë deklarata duke sfiduar të drejtën e Republikës së Qipros për të shfrytëzuar burimet e hidrokarbonit në Zonën Ekskluzive Ekonomike të Qipros për të mirën e të gjithë Qipriotëve. Turqia pritet të mbështesë aktivisht bisedimet drejtë një zgjidhjeje të drejtë, të plotë dhe të qëndrueshme të çështjes së Qipros në kuadër të OKB-së, në pajtim me rezolutat përkatëse të Këshillit të Sigurimit të OKB-së dhe në përputhje me parimet mbi të cilat BE-ja është themeluar. Angazhimi i Turqisë në terma konkrete të një zgjidhjeje të tillë gjithëpërfshirëse mbetet vendimtar. Pavarësisht thirrjeve të përsëritura nga ana e Këshillit dhe Komisionit, Turqia ende nuk e ka përmbushur obligimin e saj për të siguruar zbatimin e plotë dhe jo-diskriminues të Protokollit Shtesë të Marrëveshjes së Asociimit dhe nuk i ka hequr të gjitha pengesat për lëvizjen e lirë të mallrave, duke përfshirë kufizimet mbi lidhjet e drejtpërdrejta të transportit me Qipron. Në normalizimin e marrëdhënieve bilaterale me Republikën e Qipros, nuk ka pasur përparim.

Turqia pa mëdyshje duhet të angazhohet për marrëdhënie të mira fqinjësore dhe për zgjidhjen paqësore të konflikteve, në përputhje me Kartën e Kombeve të Bashkuara, duke pasur resurse, nëse është e nevojshme, në Gjykatën Ndërkombëtare të Drejtësisë. Në këtë kontekst, BE-ja ka shprehur edhe një herë shqetësim serioz dhe i ka kërkuar Turqisë të shmangë çdo lloj kërcënimi apo veprimi të drejtuar kundër ndonjë shteti anëtar, ose burim i fërkimit apo veprimeve, të cilat do të mund të dëmtonin marrëdhëniet e mira fqinjësore dhe zgjidhjen paqësore të kontesteve.

BE-ja ka përshëndetur faktin se iniciativat e bashkëpunimit midis Greqisë dhe Turqisë për të përmirësuar marrëdhëniet bilaterale janë duke vazhduar. Në raundin e fundit, 58-të, të bisedimeve paraprake u zhvillua për caktimin e kufijve kontinental - nën-ujor. Greqia dhe Qiproja kanë bërë ankesa formale për shkeljet e përsëritura dhe të shtuara të territorit ujor të tyre dhe hapësirës ajrore nga Turqia, duke përfshirë fluturimet mbi ishujt Grekë.

Sa i përket **kritereve ekonomike**, Turqia është konsideruar si një ekonomi funksionale e tregut. Ajo duhet të jetë në gjendje t'i përballojë presionet dhe forcat e tregut konkurrues brenda Bashkimit Evropian në një afat të mesëm, me kusht që ajo të përshpejtojë zbatimin e reformave të gjithanshme strukturore.

Pas ngadalësimit në vitin 2012, prodhimi dhe punësimi janë rritur me një ritëm të lartë të moderuar. Megjithatë, papunësia është rritur si rezultat i një force punëtore fuqimisht në rritje. Deficiti i llogarisë rrjedhëse, që disi u ngushtua në vitin 2014, ndërkohë ka mbetur në një nivel të ngritur. Mbështetja për flukset hyrëse të kapitalit të qëndrueshëm e bënë Turqinë të ndjeshme ndaj ndryshimeve në ndjenjën e rrezikut global, duke rezultuar në luhatjet e mëdha të kursit të këmbimit.

Edhe pse deficiti fiskal dhe borxhi publik kanë mbetur në nivele të moderuara, tejkallimet e vazhdueshme buxhetore të shpenzimeve kërkojnë forcimin e kornizës fiskale. Politika fiskale duhet të ndihmojë në rritjen e kursimit të përgjithshëm kombëtar në funksion të nevojës për të reduktuar deficitin e jashtëm. Duke pasur parasysh se inflacioni ka shënuar rritje, në devijim të objektivit të bankës qendrore, politika monetare duhet të ndjekë një kurs të kufizuar dhe të fokusuar qartë në stabilitetin e çmimeve. Pavarësisht përparimit në lidhje me privatizimet dhe liberalizimin e tregut të energjisë elektrike, është thelbësore që reformat strukturore janë përshpejtuar në një bazë të gjerë për përmirësimin e funksionimit të tregjeve për mallra, shërbime dhe punë. Këto reforma duhet të përfshijnë përmirësime të mëtejshme në sistemin gjyqësor dhe në kapacitetin administrativ, rritjen e transparencës së ndihmave shtetërore, si dhe një sistem të hapur, të drejtë dhe konkurrues të prokurimit publik.

Sa i përket **aftësisë për të marrë përsipër obligimet e anëtarësimit**, Turqia ka vazhduar të përafroj legjislacionin me *acquis*-in. Në vitin 2013, u hap një tjetër kapitull negociues (22 - Politika rajonale dhe koordinimi i instrumenteve strukturore). Në rrjetet trans-evropiane ka pasur progres të mirë. Turqia ka ndërmarrë gjithashtu hapa të rëndësishëm në fushat kyçe në kapitullin 24, në veçanti sa i përket migracionit dhe politikave të azilit, edhe përkundër ngarkesës së konsiderueshme të paraqitur nga kriza e vazhdueshme e refugjatëve. Është arritur progres në energji, sidomos në sigurinë e furnizimit dhe të tregut të brendshëm për energji elektrike, në ligjin për kompani, politikën për ndërmarrje dhe atë industriale, statistika, shkencë dhe hulumtim, për lëvizjen e lirë të kapitalit lidhur me luftën kundër shpëlarjes së parave dhe financimit të terrorizmit, dhe në zbatimin e programit për zhvillim rural të para-anëtarësimit.

Në përgjithësi, Turqia ka përparuar në përafrimin e disa kapitujve *acquis*-it, duke përfshirë lirinë e lëvizjes së mallrave, ligjin për kompanitë, të drejtën e pronësisë intelektuale, shërbimet financiare, energjinë, politikën ekonomike dhe monetare, statistikat, politikën për ndërmarrje dhe atë industriale, rrjetet trans-evropiane, shkencën dhe hulumtimin, unionin doganor dhe marrëdhëniet e jashtme.

Në të gjitha fushat, më shumë vëmendje duhet t'i kushtohet zbatimit të legjislacionit. Përpjekjet gjithëpërfshirëse duhet të vazhdojnë në fushën e drejtësisë, lirisë dhe sigurisë, sigurisë së ushqimit, politikave veterinare dhe fitosanitare dhe të mjedisit dhe ndryshimeve

klimatike. Nevojitet progres i mëtejshëm i konsiderueshëm për gjyqësorin dhe të drejtat themelore, politikat sociale dhe punësim, veçanërisht në fushat e ligjit të punës dhe të shëndetit dhe sigurisë në punë. Përafrimi i legjislacionit duhet të vazhdohet veçanërisht në prokurimin publik, politikën e konkurrencës, veçanërisht në ndihmën shtetërore, të shoqërisë informative dhe medias.